Shaban Çupi

RRËFIMET E ELEZ HANXHIUT
Tregime

2019

Në vend të parathënies

Po të vijë pushtuesi te ju, në qytet
Ta bëni t`i duket që s`e ka pushtuar vërtetë.
Askush ndër ju atij të mos i japë çelës,
Se ai s`vjen si mik, se ai vjen si shkelës.
Mos i nxirrni për të ngrënë dhe sofër mos i shtroni,
Karrige e shtrat për të të shkoni t`i coptoni...
Edhe sikur të lutet, as gjellë - as mëshirë,
Që s`ka qytet për të, ta marr vesh fort mirë...
Ta bëni të klithë: Ndihmë! Ta quani: Barbar!
Ta bëni të haj dhe, të rroj përmbi zjarr...

Bertolt Brecht, shkrimtar gjerman

Molla zullumqare

Kur Sulltan Murati i Parë kishte shkelur këtyre anëve, kujtesa nëpër breza thotë, se një pushim me asqerinë e tij e kishte bërë në këtë fushë ku jemi ne, në këtë fushë të rrethuar me kodra, këtu ku edhe fillon Gryka e Kaçanikut,- i thoshte Elezi të birit të tij. Gojëdhëna flet se rreth 12 mijë asqerë të mbretit, para se të futeshin në Grykë, një ditë e një natë e kishin kaluar këtu, këtu afër lumit, këtu ku po e ngrisim ne Hanin tonë. Gurgullimat e lumit Lypenë, jo vetëm që sjellnin freski për asqerinë e lodhur në luftëra, por edhe kuajtë shuanin etjen e tyre. Thuhet se abdesin, asqeria e sulltanit e kishin marrë në këtë lumë, por edhe namazet i kishin kryer pikërisht në këtë fushë ku jemi ne sot. Madje edhe një asqer i sulltanit, pikërisht këtu kishte marrë atë mollën zullumqare, pasojat e së cilës i kishin përjetuar një ditë më vonë, aty dikund rreth Gurit të sotëm të Shpum:

Në Kaçanik ushtria paska mbrri,
Luftë e madhe aty ish kanë ba,
Hiç përpara nuk po mujn me shkue...

Nga kjo gjendje e krijuar, rrëfente Elezi para të birit të tij, Sulltani kishte mbledhur asqerinë dhe kishte kërkuar sqarim se mos vallë ndonjë asqer kishte marrë gjatë udhëtimit ndonjë mall të huaj, haram.

Tanë asqeri janë kanë turbullue,
Na hak të huaj babë nuk kemi marrë,
Tana vaktet na i kemi falë,
Ni asqer anash ish kanë nda,
Ni mollë n`lum une e kam gjetë,
N`ujë ish kanë, mollën e kam marrë,
Veç ni here un` e kam kafshue,
Ktu me veti un` mollen e kam.

Pasi asqeri tregon për mollën që ka gjetur në ujë, vazhdonte rrëfimin e tij Elezi, sulltani detyron një pjesë të ushtrisë që nga Guri i Shpum të nisen drejt lumit që ta gjejnë të zotin e mollës.

T`zotin e mollës ju me gjetë,
Ju hallallin me ja lypë,
Ai hallallin mos jau dhashtë
Epni grosh sa ka me lypë.
Teposhtë lumit kokan lshue,
Edhe pemën e kanë gjetë,
T`zotin e mollës e kanë takue,
Ni asqer iu ka drejtue
Na ni mollë ta kemi marrë,
Ti hallall a po na e ban?
Hallall mollën i zoti nuk jau ban,
Lyp sa t` dush grosh kemi me t`dhanë!
Ti me pare me na shitë
Hiq me pare mollën nuk e shes
Veç m`baftë mbreti mue Sadrazem.
Shkojnë asqert mbretit i kanë kallxue
Kqyr Sulltani shka ka punue,
Shkoni t`zotin ktu me ma prue
E te mbreti asqert e kanë que
Sadrazem mbreti e ka emnue,
Edhe nishanat ja ka dhanë
Para evlad! Ju ka thanë...

Pas pastrimit të haramit, se me hak t`huj lufta marë nuk shkon,- i rrëfente Elezi birit të tij, -ushtria e Sulltanit kishte thyer Grykën, duke lënë të vrarë shumë venali dhe kishte marshuar Fushës së Kosovës dhe që nga atëherë ne kemi mbetur nën këmbët e osmanlinjëve.

- Me interes qenka kjo ngjarje, nuk e paskam dëgjuar ndonjëherë më parë,- ndërhyri i biri i Elezit.
-Po, po, ashtu është,- iu përgjigj Elezi, -por më interesante është veprimi i Sadrazemit tonë, ai pranoi vasalitetin e sulltanit për nishana, por jo edhe Musa Arbanasi apo siç njihet ndryshe edhe si Teodor Muzaka dhe me çekan drejtoi një gur në murin e Hanit i cili po ngritej me shpejtësi.
Dielli kishte kaluar Kodrën e Bajrakut dhe me shpejtësi po shuhej andej Lypetenit. Me perëndimin e tij, dalëngadal po afrohej edhe nata; natë e cila më shumë i ngjasonte një mërzie të gjatë sa vetë shekulli nëpër të cilin po kalonte edhe Elez Hanxhiu.

Të pathënat e Elez Hanxhiut

Kishte disa vite që malet e katër vilajeteve të Shqipërisë, pothuajse i sundonin kaçakët. Ato ishin mbushur me plaçkitës të tillë dhe sapo merrje ndonjë vendim për të udhëtuar nga një kasaba në tjetrën, s`kishte se si të mos shkonte mendja se si do t`ia dilje mban me ata. Këtë e dinte edhe Udhëtari i cili nga autoritetet turke ishte dëbuar nga Prizreni pas shembjes së kryengritjes shqiptare të Prizrenit.

Udhëtari deri në Hanin e Ferizit erdhi me një pajtanxhi të Prizrenit dhe një natë e kaloi te një mik i tij. Pjesën më të madhe të natës e kaluan në kuvendime me mikun rreth ngjarjeve që po ndodhnin.

-A ka fund kjo katrahurë?- pyeti Udhëtari mikun e tij dhe sikur deshi t`ia vente kapakun bisedës që zhvilluan dhe ranë për të fjetur.

Me diell agoi e martja e javës së tretë e nëntorit të atij viti. Një diell i cili me rrezet e tij sikur dëshironte t`i shpallte luftë dimrit. Pasi e falënderoi mikun për pritjen që i bëri, mori udhë në drejtim të kasabasë së Kaçanikut. Me të arritur në Kaçanik u ndal para kalasë së vjetër të këtij vendbanimi e cila ishte e mbushur me askerë të mbretit, ndërsa përballë kalasë ishte xhamia e ngritur që në vitin 1594. Në jug të kalasë, aty mbi Gurë të Shpum, vështroi kalanë e Tophanes, brenda së cilës ishin vendosur një sërë topash që kontrollonin Grykën. Nga malet që shtriheshin për rreth kalasë, dëgjoheshin këmbanat e bagëtive dhe një zë bariu i cili herë i biente fyellit e herë këndonte:

Moj Tophane të dalt flaka
Sa djem t` ri ke marrë n`ahiret
U shkrumofsh me gurë e thepa
Kun nishani mos t`u gjetë!

Në mesditë u nda nga Kaçaniku, pasiqë Grykën e tij duhej ta kalonte në këmbë, pikërisht nga rreziku i kaçakëve plaçkitës. E dinte se në këtë Grykë kishin pësuar shumë udhëtarë, kadilerë e udhëpërshkrues të ndryshëm. Pasi ishin nxënë prej kaçakëve, ishin lidhur për drunj dhe pasi ua kishin marrë të gjitha gjërat që kishin pasur me veti, me fat kishin qenë nëse kishin shpëtuar kokën.
Gjithnjë duke udhëtuar në këmbë, herë djathtas e herë majtas lumit Lypenë, pas disa orëve arriti që me sukses të kalojë Grykën e këtyre maleve. Ndjeu gëzim të madh që nuk u takua me kaçakët se po ta zinin, si anëtar i Shoqërisë që ishte, për kokën e tij, kaçakët do të kërkonin para të majme nga Qendra e Shoqërisë, ashtu siç u kishte ndodhur edhe shumë misionarëve të tjerë, Grykave dhe maleve të vilajetit.
Ishte lodhur aq shumë nga udhëtimi dhe ndjeu një gëzim kur në Fushëgropën e sapo dalë nga Gryka, vërejti një tym që dilte nga oxhaku i një shtëpie të vetmuar rreth 100 metra, në të majtë të lumit Lypenë. Iu ofrua ngadalë shtëpisë dhe të lehurat e një qeni, nga shtëpia nxorën një plisbardhë i cili pasi e qetësoi qenin, i uroi mirëseardhje mysafirit.
-Bujrum aga, bujrum!-tha plisbardhi dhe me buzëqeshjen që i ofroi mysafirit, sikur donte t`i shfaqte sigurinë njeriut të panjohur.
-Han është kjo shtëpi? -pyeti Udhëtari i ndrojtur.
-Po, Han është,- ia ktheu hanxhiu dhe i ndihmoi mysafirit që të shkarkonte hejbet nga krahët.
Udhëtari i prirë nga hanxhiu, u fut në katin përdheses të këtij Hani dhe sapo vërejti një krah drunj që po ndizeshin në oxhak, u ofrua pranë zjarrit dhe u ulë në postajën që ia ofroi hanxhiu.

-Mirë se të ka pru Zoti! - foli hanxhiu,-këtu do të jesh si në shtëpinë tënde dhe nga brezi nxori kutinë e duhanit.
-Nuk e pi, -tha Udhëtari dhe pasi e falënderoi për mikpritjen, e pyeti hanxhiun për emrin e tij.
-Elez ma thonë,- tha ai.
-Keni mysafirë të shpeshtë në këtë Han?- pyeti Udhëtari.
-Po, pothuajse çdo ditë, ashtu siç i nxë nata, pasi kanë frikë të kalojnë natën Grykën prej kaçakëve. Buajnë në Hanin tim e kur të shkrepin rrezet e para të diellit, nisen në udhëtimin e tyre për matanë Grykës.
- Vijnë kaçakët në Hanin tënd?-pyeti Udhëtari.
-Vijnë, por i njoh krerët e këtyre grupeve dhe pasi ju jap ndonjë metelik, nuk m`i shqetësojnë mysafirët.
-Ëhë,- ia bëri Udhëtari dhe i shtriu këmbët në postajën prej leshit të ogiçit.
Perëndimi i diellit, solli natën, skëterrën e saj dhe vetëm të lehurat e qenit në oborrin e hanit sikur zhdavaritnin errësirën e Fushëgropës. Pasi kishte nevojë fiziologjike, Udhëtari kërkoi ndihmën e hanxhiut dhe me të dalë jashtë, dëgjoi gurgullimat e lumit jo larg hanit. Një zë hutini që këndonte a vajtonte në malin përbri, sikur e bënte edhe më misterioze natën e atij muaji. Me bisht të syrit, Udhëtari, përcjellte lëvizjet e shpejta të hanxhiut i cili nga pusi nxori një kovë me ujë. Disa të lehura qensh u dëgjuan nga kodrat për rreth dhe pas disa etheve të lehta që përjetoi në trup, Udhëtari sërish u fut në dhomën e hanit.
-Jetojnë njerëz të tjerë në këto kodrat për rreth?- pyeti Udhëtari
-Po. - ia ktheu hanxhiu.- Kemi rreth dhjetë fshatra të gjalla. Të lehurat e qenve që po dëgjohen, të këtyre fshatrave janë, tha hanxhiu.-Me të lehurat e tyre i trembin ujqit.

-Po ju nga jeni dhe çfarë e mire ju ka sjellur këtyre anëve?- pyeti hanxhiu.
-Vijë nga Prizreni dhe shkoj për në Manastir,-tha Udhëtari.
Pasi hanxhiu rrotulloi disa drunj në oxhak dhe pasi ngriti fitilin e llambës së vajgurit, shtroi sofrën me bukë dhe bashkë me mysafirin po hante darkë edhe ai.
-Bukën, tuajën e keni?- pyeti Udhëtari.
-Timen e kam, -tha hanxhiu, -rreth hanit kam arat me grurë e misër dhe jo vetëm që mbaj familjen time, por e mbaj edhe Hanin.
-Qe sa kohë që e keni Hanin?- pyeti Udhëtari.
-Ka njëzet e ca vite. Njëherë ma patën djegur orditë, por e ngrita përsëri
-Po pse ta dogjën orditë?-pyeti ai.
-Po ku di unë, - u përgjigj hanxhiu, - s`kisha cilit t` ia kërkoja llogarinë, fajtor do të mbetja sido që të ishte. Nga një zapti shqiptar, pata mësuar se në hanin tim një natë kishin buajtur tre udhëtarë e që të nesërmen udhëtuan për Prizren. Ishte viti 1881 dhe ky ishte sebepi i djegies. Më shumë nuk më tregoi zaptiu. Me shumë mund e ngrita përsëri, sepse siç të thashë, me këtë han rroj.
-Merr kos, merr!- ia ofroi kupën e drunjtë mysafirit dhe me thikën që nxori nga brezi, hanxhiu preu djathin dhe qepën.
,,O Elez'', u dëgjua zëri i një njeriu në oborrin e hanit. Udhëtari i shqetësuar, pyeti hanxhiun:- Kush është ky zë ?!
-Ndonjë nevojtar, - u gjegj ai dhe pasi shkundi shuplakat e duarve, doli nga dhoma.
Udhëtari picërroi veshët që të kuptonte hallin e njeriut që erdhi në atë natë të errët dhe me të dëgjuar fjalën ,, kripë'' sikur mori zemër. ,,Po kam'', u dëgjua zëri i hanxhiut dhe pa e ftuar, me gjithë nevojtarin u futën brenda në dhomën e hanit.

-O mysafirë, paskeni?! -pyeti nevojtari, dhe u drejtua kah i panjohuri ulur rreth sofrës. Pasi u falën me të panjohurin u ulë skaj sofrës prej së cilës mori edhe ai një copë djathë.
-Nga të kemi?- e pyeti Musai, mysafirin.
-Jam një udhëtar, vijë nga Prizreni dhe udhëtoj për në Manastir dhe meqë më zuri nata, thash ta kaloj një natë në Hanin e Elezit. -I kësaj ane jeni ju?- pyeti Udhëtari, sikur donte të dinte më shumë për nevojtarin që erdhi.
-Po, i kësaj ane jam. Në shtëpi ishte harxhuar kripa dhe erdha të blej në hanin e Elezit.
-Po kripën nga e merrni?- e pyeti Udhëtari, hanxhiun.
-Nga tregtarët e Shkupit, ia ktheu Elezi dhe në sofër e vendosi qesen me krip për Musain të cilin hanxhiu e njihte mirë.
Pasi Udhëtari shoi urinë dhe e falënderoi hanxhiun për pritjen që i bëri, edhepse nuk e pinte duhanin, mori një cigare që e mbështolli Musai. Elezi, në oxhak solli një krah drunj dushku, flaka e të cilëve e ndriçonte edhe më shumë dhomën e hanit. Nga dollapi mori tri xhezve dhe në prushin e oxhakut pjeku tri kafe elbi.
-Në këto kodrina për rreth nesh, shqiptarë jetojnë?- pyeti Udhëtari.
-Po, - u gjegjën njëzëri Elezi dhe Musai.
-Po ju shqiptar jeni?- pyeti Musai.
-Shqiptar jam, në Manastir jetoj, Gjergj ma thonë emrin,- tha udhëtari gjithnjë duke krijuar një siguri më të madhe në vetvete në hanin ku po e kalonte natën e nëntorit të atij viti.
-Me fe, latin jeni?-pyeti Musai.
-Nga emri, latin dukem, por nga mileti shqiptar jam, u përgjigj Gjergji.-Po ju mysliman jeni?
-Po, u përgjigj Musai, ka kohë që e kemi pranuar fenë myslimane, falemi dhe lutemi në xhami. Nga gjyshi im

Ibrahimi, kam mësuar se stërgjyshi im, Gjurkë Arbanasi kishte pasur emrin, falej në kishë e lutej me Bibël.
-Ëhë, - foli nën zë Gjergji, dhe vazhdoi, - paj kahdo që të jemi, një rrënjë kemi, të krishterë e mysliman, trung e rrënjë ilir i kemi, madje siç thotë Sami Frashnjeti, pellazgë jemi.- Keni dëgjuar ju për Sami Beun këndej?
-Jo, - u përgjigjën njëzëri Musai dhe Elezi.-Po kush është ai?
-Është vëllai i Abdylit, ai që e udhëhoqi Lidhjen në Prizren.
-Po ku marrim vesh ne nga këto punë , foli si në faj Musai.
-Ju shqip flisni, po a dini të shkruani gjuhën tuaj?- pyeti më drejtpërdrejt Gjergji.
-Jo aga, nuk dimë. Pse, a mund të shkruhet gjuha jonë?!- pyeti Elezi përplot habi e kureshtje.
-Posi,- ia ktheu Gjergji. Madje në Korçë, para tre vjetëve, është hapur edhe Mësonjëtorja shqipe, keni dëgjuar për këtë shkollë ju?
-Këndej veç zëra kukuvajkash dëgjohen Gjergj, ku të dimë ne se ç`dodhë në arnautllëk?!
-Në Shqipëri e jo në arnautllëk, ndërhyri Gjergji me të butë. Shqipëri quhet vendi ynë ku rrojmë ne, ndërsa ne, shqiptar jemi. Shqip flasim, por që ta shkruajmë atë nuk e dimë.-Keni dëshirë ta shkruani gjuhën tuaj, pyeti Gjergji të pranishmit?
-Si, ka mundësi të shkruajmë në gjuhën tonë?!-pyetën Musai dhe Elezi.
-Si jo,- ndërhyri Gjergji,- në shkollën e Korçës ka tri vite që nxënësit leqisin shqip, po bëjmë përpjekje që të hapim edhe Shkollën e Vashave.
-Po turku, ç`thotë për këtë punë?- pyeti Musai.
-Lere turkun, po të dini ju sa i zemëruar që është greku? E tërë Mitroplia është zbuar në këmbë, ata po i ndjekin mësuesit tanë, dhe në vazhdim ju shpjegoi për Pandeli Sotirin, Petro Nini Luarasin, veprimtarinë e vëllezërve

Frashëri në Stamboll për të cilët Musai dhe Elezi po i dëgjonin për herë të parë. –Përkundër këtij terrori, vazhdoi Gjergji, Mësonjëtorja shqipe po e vazhdon veprimtarinë e saj. Për këtë punë isha edhe në Prizren, por Kajmekami i këtij shehri më largoi pa dëshirën time nga ky vend dhe tani po kthehem në Manastir.
Gjergji brofi në këmbë dhe para dy të pranishmëve, filloi me zë të lartë të recitonte një vjershë të Naimit e cila tanimë mësohej edhe nga nxënësit e Mësonjëtores së Korçës:

O vëllezër shqiptarë,
Gëzohuni që erdhi kjo ditë
Kaq e mirë e kaq e mbarë,
Na sjell të gjithë mirësitë.

Vargun e fundit ,, Na i sjellë të gjithë mirësitë'' Gjergji e përsëriti disa herë sikur donte t`ua ngulite sa më thellë porosinë e Naimit dhe vazhdoi me një vjershë tjetër të Gjerasimit:

Do punoj për mëmëdhenë,
Gjithë jetën sa të rronj,
Do të zgjonj dhe ata që flenë,
Kështu jetën do mbaronj.

O vëllezër shqipëtarë,
Merrni sot udhën e mbarë,
Punën tuaj mos harroni,
Koha shkon dhe prapë s`vjen.

Pas deklamimit të këtyre vjershave, të cilat Gjergji i donte shumë, nga fundi i hejbeve, nxori tri libra: E para quhej ,,Abetare'', e dyta quhej ,,Shkronjëtorja'' ndërsa e treta,, Këndonjëtorja''.

-Ja, -foli Gjergji, - këto janë librat shqip, shkronjat shqipe, shkronjat e gjuhës së mëmës. Për këto libra, Kajmekami më zboi nga Prizreni. – Keni dëshirë të mësoni se si shkruhet emri juaj në gjuhën tonë?-pyeti Gjergji.
-Po, si jo -thanë të pranishmit dhe pasi Gjergji mori një copë thëngjilli në oxhak, në sofrën e Elez hanxhiut, shkroi:
E L E Z e pak më larg, shkroi emrin M U S A, ndërsa në rreshtin e dytë të sofrës, me shkronja të mëdha, shkroi:
A B E T A R E
-Provojeni edhe ju!- foli tërë gëzim Gjergji dhe pa një pa dy, Musai dhe Elezi u kërrusën mbi sofër dhe për herë të parë shkruanin emrin e tyre në gjuhën e nënës, në gjuhën e bukur shqipe.
-Njeriu sa të rrojë mëson,-tha Elezi.- Kurrë s`më ka shkuar mendja që unë me dorën time shqip ta shkruaj emrin tim dhe e shikoi me kënaqësi emrin e tij të shkruar në sofër.-Kur po ndërtohej hekurudha rreth dy dekada më parë,vazhdoi Elezi, një francez që udhëheqte punimet në hekurudhë më patë pyetur se a kanë shqiptarët alfabet shqip dhe unë i pata krisur: a , be, xhe, fe, jumushake....., por ai qeshi dhe më ndërpreu, më tha se ky është alfabeti turk, ndërsa unë heshta sepse s`dija ç`ti thoja.Po që të mos mbetja keq, ia thashë francezit disa fjalë që i kisha mësuar nga të tjetërt që vinin në hanin tim si:,, Umut fakirin ekmeğidir''(shpresa është buka e fukarenjve) dhe ,,Dikensiz gül olmaz'' (S'ka trendafil pa gjemba).
Po,po, shpresa është buka e fukarenjëve, përsëriti Gjergji fjalët e Elezit,- ne jetojmë me shpresa dhe në fund të fundit, mirë që kemi shpresa dhe vazhdoi. Historia jonë dallon prej shumë popujve të tjerë. Ne jemi populli më i vjetër në këtë

Gadishull, por kemi kaluar dhe po kalojmë nëpër shumë pushtues. Dora e askujtë s`ka qenë e mirë për ne. Ne jemi dëshmitar se sa keq u shtyp Lidhja Shqiptare në Prizren në vitin 1881. Kësaj Gryke ku po bisedojmë ne, kanë kaluar ordi të tëra për të shtypur këtë kryengritje dhe mbetëm si mbetëm, por shpresa duhet të ringjallet përsëri. Për këtë shpresë ne po hapim shkollat shqipe, po e përhapim alfabetin shqip, gjuhën shqipe. Para pesë viteve, kah vitit 1885, më ka rënë në dorë një libër, por inglisht dhe në atë libër përmendej edhe hani ku po llafosemi ne, Elez-Hani. Në atë libër të Arthur Jon Evensit thuhej se, rreth 150 hapa nga lumi, janë gjetur pllaka përkujtimore të legjionarëve romak, saktësishtë të Legjionit të VII të tyre.

-Si, hani im përmendet në atë libër që paskeni lexuar ju?!-ndërhyri Elezi.

-Po, pikërisht ky han ku po qëndrojmë ne sonte.

-Po kush paska qenë ai njeri që paska shkruar për hanin tim?-pyeti përsëri Elezi.

-Një arkeolog nga inglizi, Arthur Jon Evens, sqaroi Gjergji.

-E çka paska gjetur këtyre anëve ai inglizi?-pyeti Musai me shumë kurreshtje.

-Arkeologu Evens ka shkruar për artefakte të ndryshme në Iliri. Në kuadër të këtyre ka shkruar edhe për këtë vend ku janë gjetur pllaka përkujtimore të romakëve të vjetër e të cilët paskan qëndruar edhe në këtë vend ku jemi ne, dikund 150 hapa nga lumi që ju e keni afër.

Nga këto që ua tha dhe ua mësoi Gjergji, Musai dhe Elezi ishin strukur në vetveten e tyre dhe ku ta dimë se

ç`mendonin në mendjet e tyre. Kënga e gjelit nga koteci i Hanit, paralajmëronte agun e ditës së re.
-Të biem!- foli Elez Hanxhiu, - Të biem se doli drita!
Që të tre u shtrinë në hastrën e Hanit dhe trupin e tyre e mbuluan me gunat prej leshit të deleve të këtyre bjeshkëve. Që në gjumin e parë, Musanë e pushtuan ëndrrat të ndërthura edhe me jermi, andaj disa herë Elezi e zgjoi nga gjumi.

Lufta e Plevnes dhe letrat e shpuara

Në odën plotë tym e blozë ishte mbledhur pothuajse i tërë fshati. Secili dëshironte që të merrte pjesë në përcjelljen e Arifit për nizam të mbretit. Teskerja kërkonte ushtarë për në Jemen, andaj fatzeza. kësaj radhe kishtë rënë mbi Arifin i cili sapo i kishte mbushur të njëzetat.

Bashkëfshatarët e tij, Arifin e përcollën deri në qosh të katunit, deri te Dardha e Rexhepit. Kështu kishin vepruar edhe me nizamët e tjerë. Dhembja dhe mërzia, kur nizamet shkonin në hapsirën e perandorisë, nuk shafitej as me muaj e as me vjet. E tillë ishte edhe ajo ditë kur e përcollën Arifin.

Kur kaloi katundin e tij dhe arriti në tjetrin, sytë e Arifit u ngulitën në shtëpinë ku ishte Ajkuna, e fejuara e tij. Në këndin e dritares së shtëpisë, Arifi pa duke u valvitur një copë shamie. Meqë ngjyra e kuqe shifej largë, Arifi e kuptoi se ishte e dashura e tij, por që zakoni nuk e lejonte që të përshëndetej me atë. Ngriti dorën e djathtë dhe preku plisin e bardhë në kokë, dhe me këtë ngritje dore, sikur deshi t`ia linte lamtumirën të dashurës së tij. Ashtu me zemër plasur, si nëpër dhëmbë, Arifi nisi vajin e burrit, që s`kishte shtëpi që nuk e dinte:

Kah po shkojnë tanë këta djem
Shkojnë asqer në atë Jemen
Kuku nanë vatani i jem
Kaj, moj nanë, kaj...

Pas udhëtimit me ditë e netë të tëra, Arifi arriti në Jemen ku si thuhej gjezvja vlonte në rërë nga nxehtësia. Sa e padurueshme ishte kjo nxehtësi për Arifin, i mësuar ndryshe ahishteve të atdheut të tij! Pas pesë muaje talim që bëri në Jemen, një ditë atij dhe shumë nizamëve të tjerë u erdhi teskerja që të riktheheshin në vendet e Ballkanit, në Rumeli.

Sa shumë që u gëzua Arifi, po aq edhe Limani, Selmani, Hetemi dhe tri toborre nizamësh me shqiptarë. Po ktheheshin më afër ,,memleqetit '' të tyre, por ata nuk e dinin se po shkonin në Bullgari, më saktësisht në Plevne ku edhe ishte kufiri luftarak ndërmjet Perandorisë Osmane dhe Rusisë apo Miskovit siç i thonin. Korriku i vitit 1877, Arifin dhe shumë shqiptarë rreth tij, i gjeti në kodrinat dhe istikamet e qytetit të Plevnes, nën komandën e Osman Pashës.

Korriku, gushti, shtatori, tetori, nëntori dhe dhjetori i vitit 1877 ishin muajë nën zjarr, ishin ditë e muajë në istikame, ishin ditë dhe netë të vështira ku 40 mijë ushtarë të Perandorisë, ku bënte pjesë Arifi, përballë kishin një front të gjërë rusësh me mbi 180 mijë ushtarë të Carit. Bëhej një luftë e pabarabartë, ballë për ballë e dhëmbë për dhëmbë. Në këto istikame po qëndronte edhe i riu Arif dhe shumë nizam të tjerë shqiptarë.

Vera e atij viti në Vilajet të Kosovës ishte tepër e thatë. Shi nuk ra gjatë tërë verës. Lumenjët dhe përrenjët ranë shumë nga niveli i tyre. Kronet e pakësuan ujin. Bereqetet po veniteshin në ara. Kriza e bukës po dukej në derë. Ato pak drithëra që fshatarët arritën t`i mbledhnin, pasi i bluanin në mokrën e varfërisë u shtonin edhe hithra e fletë lakrash kahdo që mund t`i gjenin. Kështu kalonte e mbijetonte edhe familja e Arifit.

Kalonin ditë e kalonin netë, kaluan muajë e kaluan vjet. Askush nuk sjellte ndonjë haberë për nizamët. Në fakt, familja e Arifit e dinte se ai ishte në Jemen, dhe nuk e dinin se Arifin e kishin dërguar në Plevne të Bullgarisë, edhe më keq në luftën turko-ruse.

11 shtatori i atij viti ishte ditëlindja e carit rus, Aleksandrit të Dytë. Në vend të dhuratës dhe uratës, ai kishte kërkuar

nga ushtarët, fitoren mbi Plevne me synim që mandej të marshonte drejt Stambollit. Sa e tmerrshme ishte ajo luftë! Sa shumë koka njerëzish ranë në tokën e Plevnes!Sa shumë gjak shqiptari ra edhe këtu! Kështu kishte ndodhur edhe gjatë muajve korrik e gusht, kështu po ndodhte edhe në shtatorin e atij viti, për të mos u ndalur as në muajtë pasues.
Se sa e rëndë ishte kjo luftë, bëhej e ditur nga kronistët perëndimor që raportonin nga frontet e luftës: ,, Krahët dhe këmbët e ushtarëve këputeshin, zorrët notonin si krimba të gjallë, në secilën anë kishte të vdekur, fundja e llogorit nga piksja e gjakut ishte shndërruar në vend rrëshqitës, edhe shiu nuk ka mundur t`i pastrojë këto piksje, në fushën e luftimit kishte aq shumë të vdekur saqë nuk mundën as t`i varrosin, ato i bartinin korbat, shpendët grabitqarë, qentë dhe krimbat...''
Përkundër dëshirës së carit rus, qëndresa osmane në fillim ishte e fortë. Edhe në luftën e tretë gjatë atyre mujave, nuk mundën që rusët të merrnin Plevnen, por muajtë që vinin, për nizamët e Osman Pashës, bashkë me ditët e javët e tyre, sollën edhe një rrethim edhe më të madh, sollën vrasje, plagosje, sollën edhe urinë. Krahas këtyre vështirësive, fjalën e kishte edhe tradhëtia. Furnizimet vështirësoheshin. Bëhej luftë për jetë a vdekje, u pushtuan edhe shumë burime uji. Kuajtë s`kishin as ushqim të mjaftueshëm. Bora dhe acari erdhën më herët se herave të tjera. Përballë topave rus dhe acarit dimëror, po përballeshin edhe nizamët shqiptarë, e në mesin e tyre edhe Arifi, Limani, Hetemi e Selmani që ishin të një nahije. Me topin e tij, përballë forcave rusëve, përballej edhe Halit Gjilani. Në këto istikame u vranë më mijëra njerzë, këtu u vranë edhe…
Një vit më vonë, pas kësaj lufte, në katundin e Arifit erdhi një tatar. Barazani i tij sillte lajme, sillte kob. Katundarët, me

shpejtësi lan punët e tyre dhe dolën Te Lama. E rrethuan tatarin që të dëgjojnë lajmin. Aty erdhën edhe babai dhe nëna e Arifit. Zemra u rrihte fortë e trupi iu dridhej.
Më në fund, nga çanta e tij, tatari nxori katër letra të shpuara, të djegura me cigare në mes dhe të pranishëmve ua dha kumtin:
,,Arifi, Limani, Selmani e Hetemi kanë rënë shehid në Plevne…'' Vajtimi shpërtheu në të gjitha anët, lotë nxori edhe Ajkuna e re.
Nata me shpejtësi po e mbulonte ditën. Kjo natë e mbuloi edhe Hanin, aty buzë hekurudhës dhe lumit Lypenë, që me gurgullimat e tij sikur dëshironte të gjallëronte jetën. Elezi, atë natë, mysafir kishte një udhëtar që nuk këndonte, por që e vajtonte këngën. Aty ballë oxhakut, rreth drujve që po ndezeshin flakë, ulur këmbëkryq mbi një lëkurë dashi, udhëtari ia mori këngës, ndërsa brij tij e dëgjonte Elezi:

Osman Pasha dul nat kodër,
Qet dy topa Plevne te vogël.
Plevne të vogël i qet dy topa,
Qet Miskovi 600 topa.
Qet Miskovi 600 topa,
N`Plevne të vogël po dridhet toka.
Dridhet toka tuj bubullue,
Pushktë prej dore u paskan pshtue.
Bajke Pasha ku ku për mue,
Barut mreti tuj m`kish pas que,
Për 7 vjet Plevnen s`pata me lshue.
Osman Pasha çka paska thanë,
Ja se mretin ment e kanë lanë,
Ja murtat kokan ba te tanë.
Osman Pasha po kan si thmi,
Po i fshin lotë me shami,

Mjer i mjeri evladt e mi,
Bukë pa hangër, ujë pa pi,
Armet në dorë na u kanë ngri.
Po vjen rusi si bjeshka zi,
Kta po e pritshin, sall me singi,
Jau kanë que fishekt me hi,
N`ujë te vlum ua kanë zi.

Muhaxherët

Duke e vërjetur nga largë qerren e cila po tërhiqej nga një penë qe të lodhur, Elezi doli nga Hani i tij që t`u qante hallin këtyre fatmjerëve që vinin nga largë. Me të arritur qerrja me qe, në vendin ku qëndronte Elezi dhe pasi i përshëndeti me një të ngritur dore, u tha:

-O njerzë të mirë, ejani në Hanin tim, është borë e madhe dhe nuk udhëtohet në këtë natë që po vjen! Qetë qenkan lodhur shumë e Shkupi është shumë largë nga këtu. Një konak, në këtë acar, njeriu e kërkon edhe te armiku.

-Të lumtë goja hanxhi, por ne jemi hallegjinjë saqë as të ecim nuk dimë se ku shkojmë, e as të rrimë nuk dim se ku të rrimë,-u përgjigj plaku i cili po dridhej nga të ftohtit.

Elezi kapi kapistrën e qeve e lidhur nyje njëra me tjetrën dhe i drejtoi në drejtim të Hanit. Ua hoqi zhegrat nga qafa dhe qetë i drejtoi në ahur. Pos plakut dhe gruasë së tij e cila ishte e zbehur e tëra, nga qerrja zbritën edhe katër fëmijët. Derisa Elezi po mbushte një krah barë për qetë, nga qerrja, hallegjinjët morën edhe plaqkat e tyre; disa jorganë, një thes me miell, një kusi, një shtambë uji dhe në fund morën edhe cergën me të cilën ishin mbuluar ata dhe një pjesë e qerres.

-Futuni brenda, futuni!- tha Elezi dhe në vend që të hynte në odën e oxhakut, u nisë nga turra e drunjëve.-Mirë se keni ardhur!- foli Elezi dhe krahun plotë me drunjë e shkarkoi në oxhak.

-Tu rritë ndera, hangji për këtë të mirë që po na e bëni, por ardhja jonë nuk sjell të mira!

Drunjët morën flakën dhe nga flaka e tyre ndriçohej edhe oda. Rreth zjarrit u ulën plaku e gruaja e tij dhe katër fëmijët, më i madhi prej të cilëve nuk i kalonte të pesëmbëdhjetat. Të nxehtit depërtonte ngadal në trupin e këtyre njerzëve të mbushur me halle dhe që kishin marrë

botën në sy. Nuk vonoi shumë dhe Elezi në sofër u shtroi edhe një bukë misri dhe një kupë me kos.
-Afrohuni, afrohuni! - tha Elezi, të ham çka na ka qëlluar! Thonë se kur je i uritur, gjithçka mjaltë të duket.
-Zoti të nderoftë, hanxhi!
Si ju, ka ditë që përcjellë shumë njerëz në drejtim të Shkupit. Disa ndalen e disa jo, varësisht prej kohës se kur arrijnë te Hani im. Muhaxherë janë, si ju. Edhe ata me qerre vijnë e me qerre shkojnë. Zemra të lëkundet kur i sheh njeriu. Po ju nga vini?- pyeti Elezi, derisa shtambën me ujë e vendosi në sofër.
-Vijmë nga rrethi i Toplicës. Vijmë nga kiameti, tymi e zjarri. Ikim nga zullumi e hanxhari dhe ku shkojmë as vet nuk e dimë,- foli Hasani i cili nga lodhja e tepërt dukej sikur t`i kishte mbi 70 vjet. Kjo është gruaja ime e këta janë tre nipërit e mi dhe mbesa ime. Dy djem që kisha, serbët mi vranë në oborr me gjithë gratë e tyre. Mezi arrita t`i marrë këto që po i sheh dhe nga sytë këmbët, mik.
-E ç`bëhët me hallin tonë, hanxhi?- foli për të parën herë gruaja e Hasanit.- Ju jeni hanxhi, këtu vijnë udhëtarë të ndryshëm e nga ata mëson edhe ti. Ç`bëhet me hallin tonë?
-E bën Zoti mirë! - u gjegj Elezi dhe hodhi vështrimin nga fëmijët të cilët pasi ngrënën bukë, sërish iu ofruan zjarrit në oxhak dhe po ngroheshin.
Të lehurat e qenit, bënë që Elezi të dilte përsëri jashtë. Bora binte pandërprerë. Nga i ftohti, siç thuhej, dora të ngjitej në rezë të derës. Pasi vërejti se s`kishte njeri, Elezi u fut sërish në odën e oxhakut. Shtriu cergën afër zjarrit dhe fëmijët u shtrinë njëri pranë tjetrit. Nuk vonoi shumë, nga lodhja dhe i ftohtit që kishin përjetuar në trupin e tyre të njomë, gjumi i mori menjëherë.

Pasi ndërruan nga një cigare duhan nga kutitë e tyre, Hasani filloi të tregoj gjerë e gjat gjithë atë që kishin përjetuar mbi 600 katunde të Sanxhakut të Nishit. Tregoi se si orditë serbe i sulmuan natën, se si i vranë dy djemtë dhe gratë e tyre dhe se si arritën t`i merr këta jetimë dhe të marrin ikën. Është e 27 ditë e udhëtimit, hanxhi. Kemi buajtur aty ku na ka zënë nata. Nëpër katunde jemi ndalur t`i ushqejmë qetë se nuk mundnin të ecnin. Kemi mbetur gjallë me qullë dhe nga mielli që e kishim në qerre, e zienim në këtë kazan që po e sheh. Para dhe pas nesh kanë udhëtuar dhe po udhëtojnë edhe shumë të tjerë.Vargu i muhaxherëve është i gjatë. Mbi 600 katunde kanë marrë ikën, kemi lënë plangë e shtëpi, kemi lënë lopë, dhen e dhi. Të gjitha na i mori kaurri dhe jo vetëm këto, Toplica me rrethinë është e larë në gjak. Kështu kanë pësuar edhe vendet tjera si Prokupja, Vraja, Leskovci e fshatrat për rreth deri në Nish...

-E nga do të shkoni tani?-pyeti Elezi.

-Për në Shkup, e nga Shkupi për në Turqi,-tha Hasani dhe ashtu i kredhur në mendime, nuk foli më. Edhe Elezi nuk e zgjati më tepër. U shtroi në odën e oxhakut që të flejnë.

Bora që binte, kërcnonte për një dimër të fortë e të gjatë. Pasi në oxhak, vendosi edhe një krah drunjë që të nxeheshin udhëtarët muhaxhirë, Elezi doli në dhomën tjetër të Hanit dhe u mbështet për një sy gjumë.

Kënga e Rrapo Hekalit

S`kishte natë që në Hanin e Elezit të mos vinte ndonjë udhëtar. Fundmaji i ati viti, solli dy udhëtarë që vinin nga krahinat jugore të atdheut e që udhëtonin për në Prizren.

Pasi Elezi i rahatoi kuajtë dhe shtroi darkën për mysafirët, i erdhi radha edhe mësimit të ndërsjellë.

-Keni dëgjuar ju për Rrapo Hekalin?- pyeti mysafiri, Elezin.

-Jo,-u përgjigj Elezi, - po kush na qenka ky Rrapoja?-pyeti ai me plotë kurreshtje.

- He,... Rrapo Hekali ishte një trim me nam, ishte një kryengritës që luftoi Tanzimatin në Shqipëri dhe shokët e tij ishin Zenel Gjoleka e Hodo Nivica... Ishin kapedanë të mëdhenjë ata... dhe ende pa përfunduar historinë e tyre për këto trima, mysafiri ia filloi një kënge toskënishte që Elezi e kishte të vështirë ta kuptonte:

Hajde, mor Rrapo Hekali,
Kur thërret sa tundet mali.
Hajde, mor Rrapo o lule,
Lum si ti, bilbil që zure,
Një pasha me shtatë tuje.
Topi bam e ti tutje,
Plumbat të binin mbi supe
As u trembe, as u tute,
Se Hodo Nivica shkoi,
Kofshen derrit ia dërmoi
Ngriti flamurin te kroi.
Pse, lufton o derëzi?
As për mua, as për ty
Po për gjithë Shqipëri !

-Paska qenë një trim i vërtetë ky Rrapoja, -ndërhyri Elezi,- Po si përfundoi ky trim?

- Rrapo Hekalin, osmanllinjtë e zurën dhe e burgosën. Në burgun e Manastirit ia bën gjëmën dhe sërish ia filloi këngës:

Dolli marsi e hyri prilli
S`këndon qyqja e as bilbili
Rrapon e ngriti veziri
E shpuri nga Manastiri.
As e vrau e as e farkoi
Veç me helm e helmoi.
Rrapo Hekali ku je?
Keq për ty e keq për ne
Na mbeti vendi raje!

- Po shokët e tij ku mbetën?- ndërhyri sërish Elezi.
- Edhe shokët e tij, përfunduan në pranga në zandanët e Stambollit. Më vonë, qeveria turke i fali. Zenel Gjoleka u vra në mbrojtjen e viseve shqiptare nga malazezët. U vra në vitin 1852 dhe u varros afër kullës së Oso Kukës në Vraninë, ndërsa Hodo Nivica u vra në Shpuz të Podgoricës gjithashtu në mbrojtje të viseve shqiptare nga malazezët. Edhe Hodoja u vra në vitin 1852.

Që në orët e hershme të mëngjesit, dy mysafirët u nisën në drejtim të Grykës së Kaçanikut, për të vazhduar më tej për Prizren.
Elezi, derisa po nxjerrte ujin nga pusi në oborr, në brendinë e shpirtit sikur dëgjonte përsëri këngën e bukur të Rrapo Hekalit…
Pse lufton o derëzi?
As për mua e as për ty
Po për gjithë Shqipërinë!

Haj medet ka mbetë shumë njeri

-Gazepi s`po del nga strofulli i tij,- tha Zaptia, të cilin Elezi e kishte mik që prej kohësh dhe kishin besueshmëri ndërmjet veti. -Te Guri i Zi, në malet e Sharrit, një patrullë e Lidhjes arriti të kapë një ushtar të Regjimentit të shtatë të Batalionit të tretë dhe emri i tij ishte Hasan Hysni Tikveshi. Ky ushtar ishte i ngarkuar nga kajmekami i Prizrenit Sherif beu, që t`i dorëzoj disa dokumente me rëndësi Ibrahim Pashës në Shkup. Në ato dokumente shkruhej për të zëzën që po përgatitej për arrnautllukun tonë. Këto mi tha Haliti, dhjetari i xhandarmërisë i cili edhe ai është arrestuar nga forcat osmane dhe është dërguar në internim në burgun e Damaskut në Siri,- tha ai.

-Në Hanin tim vijnë udhëtarë nga kazatë e ndryshme e secili që vjen, nga një fjalë e lë,-ndërhyri Elezi. -Njëri më tha se pas shuarjes së kryengritjes së Lidhjes së Prizrenit, qeveria ka burgosur shumë njerzë, shumë kryengritës,- kështu po më thonë.

-Këto që t`i kanë thënë, të vërteta janë,- plotësoi Zaptiu. Nga një oficer i shërbimit sekret osman (Hud-Hud), kam mësuar se në Kalanë e Prizrenit mbahet i lidhur Avdyl Frashëri, Sulejman Vokshi e plotë të tjerë dhe po përgatitet dënimi i tyre. Këtyre ditëve, për në shkretëtira të Anadollit e gjetiu, kanë dërguar shumë të burgosur. Disa i kanë nisur për në ishullin Rodos, disa për në Diar Bekir, disa në Adana e disa edhe për në Nablus të Jordanisë. Në këto vende e kanë dërguar edhe telegrafistin e Prizrenit i cili nga posta e Prizrenit kishte marrë aparatin telegrafik dhe me urdhër të Sulejman Vokshit e kishte vendosur në Shtime për nevoja të Lidhjes. Janë mbyllur në zandan edhe shumë të tjerë që prenë rrjetin telegrafik nga Ferizaj e deri në Shkup. Dervish Pasha dhe shtatë gjeneralët e tij, gjithçka kanë futur në

këmbët e tyre. Veç në Slivovë thuhet se janë vrarë mbi 1200 ushtarë të Lidhjes...
Po, po kështu po thonë, - tha Elezi dhe ia ofroi kutinë e duhanit, Zaptisë.
Shtëllungat e tymit të duhanit, sikur paralajmëronin stuhi të tjera, rrebeshe të pafundëta mbi popullin shqiptar... Nëpër shtëllungat e kësaj tymnaje, nga goja e Zaptisë, sikur gjëmonin disa vargje të një kënge që shpirti i popullit i kishte krijuar atyre ditëve:

Krisi topi e krisi pushka,
Ushtoi mali, ushtoi fusha.
Luftoj Peja, luftoj Gjakova
Prizereni, mar Kosova.
N`Fushë t`Kosovës u mblodh jezeri
Hajmdet na ka met shum njeri.
Medet na met shumë njeri
Mic Sokoli e Smajl Hyseni.
Mic Sokoli, Samajl Hyseni
Na u ba Lidhja e Perzerenit.
Mic Sokoli ishte kan trim drangue
N`gryk te topit hasmit ju ka gjue.
N`gryk te topit hasmit ju ka gjue
Humbi veten shokt me i pshtue.
Smajl Hysni n`kam a que
Nan e bab jeni met pa mue.
Nan e bab jeni met pa djal
N` Fush t` Shtimes po dojmë me dal
Me dhanë jeten për vatan!...

Gjeneral Mizori

Fushkëllima e trenit që vinte nga Shkupi, në drejtim të Grykës, paralajmëronte se arritja e tij në stacion nuk ishte largë.

Muaji tetor kishte kaluar me ngjarje e me rënkime të shumta. Anasit kishin varrosur më të dashurit e tyre me dhembje të mëdha. Shumë sosh u varrosën aty edhe ku u vranë. Për disa të tjerë, për t`i mbajtur në mendje më gjatë, banorët hapën varreza të reja, madje nuk kishte as dy ditë kur në Varre të Epërme të fshatit u varros Hava e bija e Agushit të cilën serbët e vranë pasiqë kjo sulmoi me sopatë pushtuesit. U vra bashkë me babain e saj, aty te ,,Mani i Avdullahit''.

Pas 500 vjet qëndrimi në këto troje, turqit kishin marrë ikën, por vendin e tyre e zinin pushtuesit e rinj, pra serbët të cilët kishin kaluar Merdarën dhe krahinës së Llapit i kishin rënë kryq e tërthorë. Pas Llapit, ushtarët e Armatës së Tretë serbe, zaptuan edhe qytete e fshatra të tjera. Të ndodhur mes dy ushtrive të mëdha, shqiptarët nga një zgjedhë, po futeshin në tjetrën. Kështuqë më 26 tetor të vitit 1912 e pushtuan edhe Kaçanikun me fshatrat për rreth. Në pararojë të sulmeve serbe, prinin mjeshtrit e shtëpive të cilët shqiptarëve, ua dinin edhe lugët në kroshne. Prinin edhe terzitë që shqiptarëve ua qepnin tirqit me gajtana me netë të tëra, por edhe rrogëtarët e lopëve dhe mulligjinjët të cilët në kohën e turkut kishin ngrënë bukën e shqiptarëve, por tani ua përmbysnin kupën. Kishte ardhur koha e tyre... Pas krimeve që bënë në Llanishtë, Gjergjedell e Dërmjak, ushtria serbe, shkretëruan edhe Kumanovën, Shkupin...

Treni që po vinte, për në Kosovë sjellte udhëheqësin e tyre, sjellte gjeneralin e kësaj armate që me hekur e zjarr kishte vënë nën pushtim, plisbardhët. Fishkëllima e trenit dëgjohej

gjithnjë e më shumë, me çka kuptohej se ishte shumë afër arritjes në stacion. Këtë e dëgjonte edhe Aliu i cili ndodhej anës së djathtë të lumit në drejtim të Grykës e jo shumë largë stacionit i cili kur u ngrit në vitin 1873 nga francezët, mori emrin e Elezit sipas hanit të tij që gjendej në këtë vend.
Fishkëllimat e shpeshta të trenit dhe tymi i zi që tanimë dukej në jug të stacionit, Aliun e bënë edhe më kurreshtar të mësonte ,,hallin'' e trenit. U fsheh afër një trungu të një shelgu ku nga aty shihej mirë stacioni, brenda të cilit kishte ditë që ishin vendosur serbët pas pushtimit të tij.
Para objektit jo të madh, shiheshin të rreshtuar rreth 50 njerëz të armatosur me pushkë e hanxhar, ndërsa para tyre rrinte në gjendje gatishmërie udhëheqësi i tyre.
S`vonoi shumë dhe pas oshtimave të frenimit që u përhapën në fushëgropë, treni u ndal. Me të ndalur të tij, eprori ushtarak iu drejtua ushtarëve të rreshtuar për qëndrim gatitu, dhe me shpejtësi u kthye në të djathtë, në drejtim të një grupi ushtarakësh që zbritën nga treni. I pari i tyre ishte i veshur me një uniformë të gjatë ushtarake e cila nga ana e djathtë ishte e mbërthyer me pulla. Në kokë kishte të vendosur kapelën ushtarake, ndërsa në supe mbante shumë grada. Nga pamja shifej se ishte rreth të 60-tave dhe kishte një mjekërr paksa të gjatë dhe të thinjur. Edhe mustaqet i kishte të tilla.
-Gjeneral i nderuar, gjendeni në tokën e çliruar serbe e cila u fitua nën drejtim tuaj, andaj që nga sot, ky stacion ku po qëndrojmë ne, nuk do të quhet më siç ka pasur emrin e tij Elez-Han, por do të marr emrin dhe lavdinë tuaj !
-Ashtu qoftë!- ia ktheu përgjigjen gjenerali dhe filloi t`i përshëndetë ushtarakisht ushtarët e rreshtuar.
Aliu i mbërthyer pas trupit të shelgut, përcolli në tërësi edhe fjalimin e gjeneralit serb i cili të pranishëve u tha se

vjen nga Shkupi dhe udhëton për Prizren e nga Prizreni, nisemi në pushtim të Durrësit. Deti Adriatik është frymëmarrja jonë, këtë duhet ta dini të gjithë. Çdo kundërshti arnautësh që mund ta hasni, me zjarr t`i djegni, me hanxhar t`i shponi, me tmerr t`i dëboni!...
Fishkëllima e sërishme e trenit, paralajmëronte edhe nisjen e tij. Pas disa vu-vu-ve që nxjerrte lokomotiva dhe tymi që ngjitej qiellit, treni mori udhë dhe si gjarpër u nis në drejtim të Grykës së Kaçanikut...

Ishte 3 nëntori i vitit 1912

Qerret mbushur me plisa

- Kjo anë, gjithmonë ka qenë e këputur nga idarja,- e theu heshtjen Ukishi, derisa qerrje, të cilën e tërhiqnin dy qe të lodhur, me rrak-taket e sajë, sikur i dëshmonte fjalët e tij. Shitja e drunjëve në Shkup, është shpëtimi ynë, vazhdoi ai. Ka mbi gjysëm shekull që mbijetojmë kështu.
- Çka shitni tjetër pos drunjëve?- e pyeti udhëtari i cili në qerren e Ukishit kishte hypur që nga Hani i Djegur.
- Paj shitja e drunjëve është kryesorja, shesim edhe dardha e arra, kur bereqeti është i mirë, por druri është më i kërkuari.
- Po ju nga jeni, e pyeti udhëtarin me emrin Abdullah.[1]
- Jam nga Tali i Nocit të Ferizajt, por punoj dhe jetoj në Shkup. Punoj në bibliotekën e qytetit, por Shkupi është mbushur me bullgarë. Kanë ardhur me çeta nga Bullgaria dhe e kanë pushtuar Shkupin. Kërdi e madhe është kah bëhet në Shkup. Kudo që shohin flamurin tonë kombëtar e djegin, ndërsa plisat e bardhë po i mbledhin.
- Si po i mbledhin?- e pyeti me kurreshtje Ukishi.
- Sa isha brenda në Shkup, aty në Bit Pazar, me sytë e mi vërejta qerret e mbushura me plisa të bardhë që i kishin mbledhur anëve të Tanushës e Brezës,

[1] Abdullah Musliu i lindur më 1919 në Talinovc të Muhaxherëve të Ferizajt. Në prill të vitit 1947 nga pushteti jugosllav dënohet me 10 vjet burg për politikë si anëtar i LNDSH-së. Lirohet në vitin 1952. Ka qëndruar si robër lufte edhe në kampet e Hitlerit. Ndërroi jetë në vitin 2008, në dhe të huaj, në Turqi.

Kumanovës e Tetovës e vendeve të tjera. E tmerrshme ishte ajo pamje që shihja. Bashkë me mua ishte edhe Fahri Halim Shurdhani nga Kaçaniku, ndoshta e njihni.

- Po pse i marrin plisat,- pyeti plotë kurreshtje Ukishi.
- Sepse është simboli i shqiptarit- u përgjigj Avdullahi,- ai tregon lashtësinë tonë në këto troje, madje edhe Leka i Madh e ka mbajtur në kokë dhe kjo u pengon bullgarëve, sepse kanë qëllime pushtimi. S`më hiqen nga mendja qerret të mbushur me plisa të bardhë, të cilët më ngjanin në koka shqiptarësh - tha Avdullahu i cili Musliu e kishte mbiemrin. Krahas plisave, bullgarët po kërkojnë edhe koka të shqiptarëve. Disa ditë më parë, pasi e arrestuan Mahmut Shefket Pashën në Shkup, atij ia thyejnë gishtërinjët e dorëve në tortura dhe e hodhën nga kati i tretë, e njihsha mirë atë njeri... Frikë e madhe ka hy në popull.

Dy qetë e lodhur, dalë-ngadalë e tërhiqnin qerren në drejtim të Hanit të Elezit. Ukishi po kalonte një natë e një ditë në udhëtim. Këtë rrugë ai e bënte sëpaku dy herë në javë dhe perpipecitë e kësaj rruge ia tregonte edhe bashkëudhëtarit të tij , Abdullahut të cilin e shihte për herë të parë.

- Çka do të bëhet Abdullah?-pyeti Ukishi,-Sa do të vazhdoj kjo luftë?
- Askush se di, ajo çka dihet është se gjermanët, italianët e bullgarët janë me një anë, ndërsa në anën tjetër janë amerikanët, anglezët e rusët. Janë krijuar

dy blloqe të mëdha kundër njëra-tjetrës, dhe kjo luftë botërore do të zgjas shumë, ndoshta sa e para.

- E ne, nga t`ia mbajmë?-pyeti Ukishi, - Me cilin krahë të jemi?
- Tani për tani, toka jonë ka përsipër tre pushtues të fortë: ka gjermanët, italianët e bullgarët. Në pjesën ku jetojmë unë e ti, sundojnë bullgarët... dhe ende pa e përfunduar shpjegimin Abdullahu, Ukishi në ironi të asaj që dëgjonte nga Abdullah Musliu, ia filloi një kënge që rrjedhte nga viti 1912:

Kur na ra Serbia e parë
U bë bashkë me bugarë
U ba bashkë me Bugari
I ranë Kosovës bitevi
N`grykë të Llapit paskan hi
Bajnë zull në shqiptari
Ka tri shpi, tuj shti mej shpi
U mirrshin tokat me tapi...

dhe vazhdoi,- Me sa kuptova, vendin ku jetojmë ne, po e sundojkan bullgarët dhe se ata qenkan bërë bashkë me gjerman e italian.

- Po,- u përgjigj shkurt Avdullahu,- me boshtin fashist të Hitlerit.
- E zezëdita për ne! -tha Ukishi dhe me thuprën që e mbante në dorë e përplasi në shpinën e qejve që ecnin ngadalë nga lodhja.

Ishte shtatori i vitit 1941

Xha Suloja

I lodhur nga puna e rëndë, gjumi e mori menjëherë. Vetëm kur u zgjua e kuptoi se sa shumë kishte fjetur. Doli me shpejtësi nga shtëpia dhe u nisë në drejtim të Taukbahçes që ta merr kalin të cilin e kishte lidhur që të kullos që në perëndim të diellit, por ai kishte këputur litarin dhe kishte ikur në drejtim të panjohur. Xha Suloja, filloi ta kërkonte nga një skaj në skajin tjetër të Taukbahçes së Prishtinës, por kalin sikur e kishte përpirë toka.

Derisa po ecte nën dritën e hënës së plotë, në mal dëgjoi një zhurmë. U ofrua sa më afër kaçubës dhe nëpërmjet dritës së hënës, vërejti tri hije njerëzish që për habi, hapnin një gropë në mes të malit. ,,Ç`bëjnë këta njerëz në këtë natë të vonë?!- mendoi në vete xha Suloja. ,,Po këtë gropë pse e hapin?'' ,, Mund të jetë varr?'',, Nëse po, kend po e varrosin dhe pse natën?'' Ishin pyetje plotë kureshtje që koka e tij i shtronte me të drejtë. U bë si u bë, xha Suloja harroi kalin, u struk brenda kaçubës dhe përcjellte njerëzit që punon pandërprerë dhe fshehurazi. Kishte frikë vetëm nga kolla e tij e thatë e cila mund ta tradhtonte në atë natë të vonë. Nxori nga brezi marhamën ngjyrë kafeje dhe për çdo rast e mbante afër gojës së tij. Nga mesi i natës, punëtorët përfunduan punën. Kazmat dhe lopatat i lan afër gropës dhe shkuan në drejtim të qytetit si hije.

Xha Suloja doli nga kaçuba ku ishte fshehur dhe iu ofrua gropës së hapur. U bind se gropa ishte në formë varri. Por kush do të varroset në të dhe pse natën, ishte pyetja kapitale e xha Sulos. Mendja i iku te pëshpëritjet në qytet se pushteti i njerëzve me yll në ball, natën i nxjerr të burgosurit shqiptarë nga burgu i Prishtinës dhe i pushkatojnë në Taukbahçe dhe i varrosin pa i parë askush.,, Mos vallë këtë ,,fat'' mund ta ketë ndonjë i burgosur sonte''. Vendosi të

qëndronte rreth varrit të hapur dhe të vëzhgonte se ç`mund të ndodhte atë natë gushti e cila për fatin e tij, ishte natë me hënë.
Rreth orës tre të mëngjesit u dëgjua uturima e një xhipi ushtarak dhe të dy makinave të tjera përcjellëse. Me shpejtësi nga makinat dolën disa milicë me pushkë të gjata dhe disa njerëz me rroba civile. Më në fund nga xhipi nxorën katër njerëz duarlidhur duar e këmbë, ndërsa sytë ua kishin mbyllur me shami. Xha Suloja u struk edhe më shumë brenda shkurres. I tëri u bë sy e vesh.
Njerëzit sylidhur i sollën te varri i hapur dhe ashtu të lidhur, njëri nga civilët, nën dritën e një baterie, filloi t`u lexoj një vendim, nga i cili xha Suloja po e kuptonte të vërtetën e asaj nate.
Ukë Sadiku nga Gjurgjeviku i Madh, Ajet Gurguri nga Dubovci i Drenicës, Gjon Serreqi nga Ferizaj dhe Osman Bunjaku nga Samadregja e Vuçitërnës, Presidiumi i Kuvendit Popullor të Jugosllavisë ju ka dënuar me vdekje-pushkatim, andaj ekzekutimi i juaj po bëhet sonte me datën 31 gusht të vitit 1947, tha Glisha Sharanoviqi, i njohur ndër shqiptarë për mizoritë e tij, andaj sipas ligjeve të pushtetit tonë popullor, ju duhet të shprehni dëshirën tuaj të fundit!
-Pasi puna qenka kështu, atëherë na i hjekni shamitë që na i keni lidhur sytë. Na i hiqni prangat në duar e këmbë e pastaj ua themi edhe dëshirën tonë!- foli Gjon Serreqi.
-Shamitë mund t`ua heqim, por prangat nga duart e këmbët tuaja, jo. Kjo kërkesë e juaja është jashtë rregullave të ekzekutimit.
Nën dritën e hënës, xha Suloja kishte ngulitur sytë në drejtim të fytyrave të të burgosurve, për të cilët emra kishte dëgjuar në popull, por s`kishte besuar kurrë se do të mund t`i shihte ndonjëherë.

-Ne kemi shumë dëshira, nisi të flet Gjon Serreqi, sepse jemi shqiptarë, jemi në truallin tonë, jemi në tokën tonë, jemi në atdheun tonë të cilin na e keni zaptuar ju. Është e vërtetë se pushtetin tuaj jugosllav e kemi luftuar me armë në dorë maleve të këtij vendi dhe për këtë nuk jemi pishman. Zhig në jetë na mbetet vetëm një punë, që hë për hë nuk mundëm t`ua qesim farën nga atdheu ynë. Sot forca po vendosë mbi drejtësinë, e padrejta mbi të drejtën, robëria mbi lirinë. Nuk do të kalon shumë kohë dhe synimet tona do të realizohen. Mbi këtë gropë varri ku po varrosemi unë dhe shokët e mi, shqiptarët lule e përmendore do të vendosin…
-Mjaftë më!- u dëgjua zëri i Sharanoviqit dhe menjëherë u kthye nga toga e pushkatimit dhe pas urdhrit: Zjarr! shkrepën përnjëherë pushkët e tyre. Me të shpejtë, sikur bari që bie nga kosa, ranë përdhe: Ukë Sadiku, Ajet Gurguri, Gjon Serreqi e Osman Bunjaku. Pasi mjeku Vaso Jovanoviq vërtetoi vdekjen e tyre, diçka shkroi në një letër dhe me të shpejtë mbuluan gropën e hapur. Mbi varr nuk vendosën asnjë shenjë. Ikën si hije…
Xha Suloja i dërmuar në trup e shpirt u ngrit nga kaçuba me këmbë të mpinjëta. U ofrua te varri dhe e vështroi edhe njëherë atë sikur donte të mos e harrojë kurrë. Në të majtë të gropës – varr, gjeti një gurë dhe e vendosi në njërën anë të varrit. Një rrem dushku shkëputi nga një degë lisi dhe e vendosi mbi varrin e tyre.
Në kufirin ku nata ndahej me dritën, Xha Suloja u kthye në shtëpi i tëri në ethe, por me një histori që do ta kujtonte për të gjallët e tij. Ra për të thyer pak gjumin, por nuk mundi të shtynte gjumë në sy.
Ishte 31 gushti i vitit 1947.

Kur objekti shkollor u pushtua nga UDB-a

Nga bora e madhe në Grykë, treni lëvizte me vështirësi. Vija nga Ferizaj dhe stacioni ku duhej të zbrisja, ishte Hani. Që nga shtatori i vitit 1956 isha caktuar të punoja si mësues në fshatin P, pasiqë kisha të kryer Shkollën Normale, fillon rrëfimin e tij veteran i arsimit, mësuesi Ibush. Në këtë fshat punoja bashkë me një koleg timin nga Gjakova, mësuesin Jashar, i cili pas dy muaje, iku në Shqipëri pa më treguar. Ishte koha e Rankoviqit, dhe të ikte për Shqipëri shoku i punës, e ti të mos dije, këtë nuk ta besonte pushteti, sepse s`donte ta besonte, kështuqë filluan hetimet edhe ndaj meje. Kohët i kaloja si në teh të shpatës, siç thotë populli. U bë si u bë, mua më mbeti të punoja me dy ndërrime. Në atë vit shkollor ishin rreth 100 nxënës, të varfër sa s`kishte më.

Nxori cigaren nga kutia dhe pasi e ndezi me shkrepsë, shtëllungat e tymit të duhanit, mbuluan fytyrën e tij. Ashtu i kredhur në mendime, harroi se në dhomë kishte, bashkëbiseduesin tjetër i cili kishte shkelur derën e tij, në hulumtim të historikut të shkollës shqipe.

-E mandej, si rrodhi ngjarja?- pyeti bashkëbiseduesi.

-Ëhë,-u rikthye në besidë mësuesi, - kështu kaloi gjysëmvjetori i parë dhe dolëm në pushim dimëror. Me 7 fror të vitit 1957, filloi gjysëmvjetori i dytë. Kur arrita në fshatin P. në Lamën e Katundit, vërejta nxënësit e mi, e bashkë me ato edhe nënat e tyre. Kurr më parë nuk kishte ndodhur një gjë e tillë.

-Mësues, o mësues, na ndihmo, burrat i kanë mbledhur në shkollë dhe po i rrahin në dru për dorëzim armësh! -folën pothuajse njëzëri nxënësit dhe nënat e tyre.

-Trupi mu rrenqeth,- vazhdoi rrëfimin e tij mësuesi Ibush. Jo që s`kisha dëgjuar për torturat e Rankoviqit gjithandej Kosovës, por që kanë ardhur edhe në këtë fshat të mbuluar

nga varfëria, këtë nuk e dija. Kalova mes për mes fshatit, në drejtim të Kronit dhe kur e kalova shpatin, arrita në oborr të shkollës. Kur u ndërtua shkolla në vitin 1952, për shkrirje të gëlqerës, fshatarët kishin hapur një gropë e cila gjatë të reshurave ishte mbushur me ujë. Te kjo gropë gjeta fshatarët të cilët po i fusnin në ujë të ftohtë frori e pastaj i futnin në klasë dhe i torturonin. U tmerrova nga ajo që vërejta! Iu ofrova milicit dhe i thash se jam mësuesi i shkollës, andaj kërkoj lirimin e objektit! Më fyu, siç deshi dhe pas kësaj më tha të shkoja në katund dhe këtë kërkesë t`u shtroja shtabit të UDB-së, të cilët kishin zaptuar një shtëpi. Kur u riktheva në katund, një roje qëndronte përpara derës së hyrjes. Kur hyra brenda, aty kishin qenë Pera i Myzeqinës dhe Qazim Udba i Gjakovës me një shishe të rakisë përpara. Para se t`ua shtroja pyetjen, më kërkuan armën. U thashë se jam mësuesi i shkollës, sot është gjysëmvjetori i dytë, ndërsa shkollën e keni nxënë ju. Më shanë çka u nxori goja. Mora ikën në drejtim të Hanit dhe vazhdova për Ferizaj. Pas tri dite u ktheva përsëri në fshat, mbi të cilin kishte rënë një heshtje e rëndë. Rrugët ishin të zbazura. Në shkollë kishin ardhur shumë pak nxënës. Korieri i shkollës ishte rrahur aq rëndë, saqë me javë të tëra mbeti i shtrirë në shtrat, ndërsa këmbët nuk iu shëruan kurrë. Krahas korierit, UDB-a kishin rrahur edhe të tjerë. Ishte kohë e rëndë, koha e Rankoviqit, sikur dëshironte t`i vënte kapak mësuesi Ibush kësaj ngjarje.

-Po për mësuesin Jashar, mësove gjë për fatin e tij?

-Një fat të keq e kishte edhe mësuesi Jashar nga Gjakova. Ai pasi kaloi në Shqipëri, punësohet si mësues dhe martohet. Pas disa viteve u burgos edhe ai. Kam dëgjuar se ka vdekur në Fier të Shqipërisë në vitin 2006.

-E mban në mend, kush e sundonte Hanin në atë kohë?

-Elezi, jo- buzëqeshi mësuesi Ibush. Pushtetin e kishte Marko Babiqi i Pleshinës, i cili njëherit ishte edhe drejtor i fabrikës. Komandant i milicisë ishte njëfarë Millan Haxhiqi nga Starasella e Ferizajt, ndërsa në popull ,,porezin'' e mbledhte Dushko Rexhiqi.
Dielli me rrezet e tij po shuhej mbi Lypeten. Deri te dera e oborrit e përcolli mësuesi Ibush i cili i kishte rrafshuar të 80-tat. Pasi u përshëndetën, kronisti ndezi makinën dhe u nis në drejtim të shtëpisë së tij. Sapo e kaloi qytetin e Ferizajt, krahas rrapëllimave të motorit të makinës, mendja i iku te poema e Hysë Dervenit, lexuar vite më parë në ilegalitet:

Atë vit kishte marrë
Dimër i vështirë
Nën borë e acar
Gjithçka kishte ngrirë…

Se ç`u bënin burrave
Ne atëherë se dinim
Por ne e shihnim
Se si shkonin, nuk vinin…

I egër ishte ai dimër
Plotë ngricë e acar,
Të tillë dimër fshati
Kurrë nuk kishte parë.

Gjithçka kishte ngrirë
Nën çizme e dëborë
Veç zjarri i urrejtjes
Rritej në krahëror…

Sokoli

Sokoli nuk arriti të kryej më shumë se shkollën fillore. Madje edhe filloren që e kishte përfunduar, nuk e kreu në vendlindjen e tij, por në një fshat tjetër, pasi që në Ahishtë nuk kishte shkollë. Atë ditë që e arrestuan në Prishtinë, ai kishte shkuar atje krejtësisht për një punë tjetër, te një shok i babait të tij, por kur pa rininë shqiptare duke kërkuar liri rrugëve të qytetit dhe kërbaçët e pushtuesit që binin mbi shpinat e tyre, për një çast iu kujtua vajza e grabitur nga shkiet dhe humbja pa gjurmë e saj dhe pa u hamendur u fut në mesin e turmës, afër një studenti që valëvite flamurin kuq e zi. Gjersa grumbulli i njerëzve buçiste Kosova-Republikë, në mendjen e tij skaliti fjalët e një studenteje e cila thoshte:

,, Mos u ligështoni vëllezër, lidhuni fort njëri me tjetrin, dasëm pa mish nuk ka. Rroftë Kosova! Rroftë populli shqiptarë! Rroftë Liria! Rroftë Shqipëria! Nuk jemi jugosllav, por shqiptarë''! dhe për një çast Sokolit iu kujtuan trimëritë e kreshnikut të Kradakut që me vite të tëra si kaçak malit, shumë fish ia kishte marrë hakun Ahishtes dhe fshatrave për rreth. Derisa masa buçiste e Prishtina ushtonte nga kërkesa gjithë popullore: Kosova–Republikë, një student në mesin e demonstruesve shpërndante një Trakt të cilin e mori edhe Sokoli, ku ndër të tjera thuhej:

,, Vëllezër e motra, në emër të atyre që u vranë nga plumbat e shovinistëve serb, në emër të atyre që dhanë jetën nën peshën e rëndë të tankeve, në emër të atyre që torturat dhe masakrat bien mbi trupin e tyre të njomë,... u bëjmë thirrje që ta vazhdojmë rrugën e filluar dhe nuk do të shkoj kot gjaku që u derdh nëpër rrugët e Kosovës dhe të shkëputemi njëherë e përgjithmonë nga prangat e pushtuesit serb... “

Sokoli nuk dinte të shpjegonte se si e arrestuan. I kujtohej vetëm momenti kur u zgjua nga alivania në një kthinë të vogël, ku nga shokët kuptoi se ishte në burg dhe një e therur pas koke e zgjoi të tërin.
Para vetes vërejti një derë hekuri gati dyfish më e gjatë se sa e gjerë që hapej dhe mbyllej me një rrapëllimë shuli. Pas shpine vërejti një dritare të vogël me grila, një llambë elektrike e instaluar brenda murit, një kovë uji dhe një enë nga plastika që më vonë e kuptoi se ishte për kryerjen e nevojave fiziologjike. Kishte dhembje të madhe trupi, por kur shokët i treguan se për dy ditë me radhë nuk kishte lëvizur fare dhe se ata kishin menduar se tanimë ai po vdiste, këndellja e tij ua kishte lehtësuar shpirtin.
Rrapëllima e derës, të burgosurve ua ndërpreu bisedën. Në derë u duk një uniformë ngjyrë e kaltër dhe një urdhër i vrazhdë për në shëtitje.
Dy të burgosurit u nisën të parët, pasi që ata kishin disa ditë që ishin arrestuar para Sokolit dhe kishin mësuar rrugët e burgut. Pas tyre, me lëvizje shumë të ngadaltë ecte Sokoli. Kaloi nëpër një korridor të ngushtë gjysmë hark dhe pa një pa dy, doli në një hapësirë tjetër dhe në beton vërejti një rreth, e brenda tij një shigjetë në kahen e kundërt të akrepave të orës, një simbolikë se koha në burg matej mbrapsht dhe njëkohësisht shigjeta tregonte kahjen se kah duhet të shëtisnin të burgosurit. Muret e larta nga betoni dhe vëzhgimoret e gardianëve për rreth, bënë që Sokolit vetja t`i dukej si në një pus të thellë. Temperatura në trup dhe shëtitja si në unazë, djersitën trupin e tij, andaj urdhrin për ndërprerjen e shëtitjes e priti me gëzim. Përsëri të burgosurit i futën në dhomën e burgut e cila nuk ishte si dhomat që i kishin në shtëpi, por dhoma si në gjysëmhark. Më vonë kuptoi se burgu kishte formën e patkoit dhe

kishte dy dyer: njëra që futeshe në te kur të burgosnin, ndërsa tjetra shërbente për të kaluar në dhomat hetimore të UDB-së, ku torturoheshin të burgosurit politikë. Këto dhoma për muaj të tërë i vizitoi edhe Sokoli dhe brenda atyre dhomave vërejti se njeriu për njeriun vërtetë ishte ujk.

Nënë Hanës, lajmin për burgosjen e djalit ia solli një patrullë policore e cila jo vetëm që ia dha lajmin ogurzi, por edhe e fyen rëndë, duke i thënë se:,, Djali juaj është armik i shtetit dhe se këta pjella duhet zhdukur nga faqja e dheut''. Erdhën dhe shkuan si hije, por prapa lanë një ngjarje shumë të rëndë për nënë Hanën.

,,Sokoli në burg!….Armik i shtetit!… Në demonstrata!… Ka kërkuar Republikë!…I kanë gjetur trakte!... Kur?... Si?…'', ishin një varg pyetjesh që nënë Hanës i parakalonin me shpejtësi në kokën e sajë.

Perëndimi i diellit paralajmëronte një natë të gjatë, një natë të pafund. Si për inat u fikën edhe dritat. Ndezi fitilaqen dhe ashtu mendueshëm u shtri ta merrte gjumi, por…

Dallgët e rrëmbyera të detit përplaseshin brigjeve me tërbim. Shi binte pa pushim, thuajse detin dëshironte ta ngrite deri në maje të kodrave. Vetëtimë e bubullimë…Në largësi vërejti një lundër që ndeshej pamëshirshëm me valët e detit. Anija herë - herë humbiste dhe dukej sikur e përpinte deti, por kur shafonte vala dhe ajo dukej përsëri, nënë Hanës i qetësohej zemra. Një zë dëgjohej, por bubullima nuk lejonte ta dallonte se ç`thoshte lundërtari. Më në fund dëgjoi zërin e të birit:

,,Nënë, nënë, jam unë, Sokoli. Ndihmë!. Sokoli jam, ndihmë…!'' Valët e detit e mbuluan. Piskama e nënës për djalin që ia përmbytën valët e detit e zgjuan nga ëndrra e tmerrshme. Koka i dhembte me furi. Nuk priti të gjejë

gotën, ngriti shtambën me ujë për të shuar etjen që po i kallte gjoksin.

Kokorisjet e një pule që dhelpra e mori nga koteci, sikur e sollën në vetvete pas ëndrrës që kishte parë.

Pasqyra e qelisë

Nuk e dinim se shumë furgonë gjysmëbusë i kishin sjellë në burg dhe rreth tij, si u thonim "maricave" pilicore. As që e dinim pse i kishin sjellë. Përkundër pushimit të pasditës që kishim, me dhelpëri të pashoqe na nxorën prej dhomave në sheshin e burgut. Pandehëm mos ka ndonjë zhvendosje të burgosurish. Sapo i zbrazën dhomat nga ne të burgosurit, vrik e vrik i mbyllën dyert e pavijonëve, pastaj nxitimthi dhe zëçjerrë i mbushnin "maricat" me të burgosurit. Nga denduria e njerëzve në furgonë, u ngjanim thasëve të çimentos të paluar njëri mbi dhe pranë tjetrit. Ata brenda nuk u ngjanin njerëzve, por mallrave dhe sikur nuk kishin nevojë për frymëmarrje. E kuptuam se nga Gurrakoci po na dërgonin në qelitë e Burgut të Dubravës gjatë atij 3 janari 1989. Ky vit, që sapo kishte nisur, sikur na erdhi me ogure jo të mira, përjetova bindjen ndërsa dëgjoja ushtimat e paradhomave, bërtimat, sharjet, fyerjet e poshtërimeve në to. Na i zhveshëm prej trupit rrobat e trasha që na i kishin sjellë nga shtëpia familjarët e farefisi. Edhe mua më futën në njërën nga qelitë e këtij burgu, pa çorapë në këmbë, gjymtyrë sikur ishin pararojë e trupit përballë të ftohtit djegës të janarit. Si muaji, e ftohtë ishte edhe qelia, shtrati i montuar për muri në të. Kur erdhi koha e pushimit për të përvjedhur një sy gjumë, nga dera e hekurt fqinje hyri rojtari, i cili përmes grilave ma dha çelësin e krevatit të drunjtë, gjegjësisht shtrirjen e tij. Me të shtrirë ai, zuri gati

tërë hapësirën e qelisë. Bri shtratit ishte nevojtorja, në faqen e murit të së cilës varej pasqyra që merrte pamjen e një krahërori njeriu, nën të çezma. Në pasqyrë sikur shihja meditimet e mia të gjetura. Pasqyrë kanë vendosur në qeli, ndërsa jastëk për të vendosur kokën nuk kanë të burgosurit! Pasqyrë kanë vendosur në qeli, ndërsa presë të thonjve nuk kemi! Pasqyrë kanë vendosur në qeli, ndërsa nuk u lejojnë familjarëve tanë të na vizitojnë. Pasqyrë kanë vendosur në qeli, ndërsa të drejtën e marrjes dhe të leximit të gazetave nuk e kemi! Pasqyrë kanë vendosur në qeli, ndërsa nuk na lënë të shëtisim. Pasqyrë kanë vendosur në qeli, ndërse ne dridhemi nga të ftohtët, ngaqë as dy batanije nuk kemi! Edhe shumë pse-he, sepse-he e ndërsa-he do të më shqiptonte pasqyra, por disi më ngacmoi pse-hu i fundit për qëllimin e vendosjes së pasqyrës së madhe. "Eurekaaaaa!', sa nuk bërtita si Arkimedi i lashtësisë kur e kishte gjetur zbulimin e tij, "Na e kanë vënë pasqyrën e madhe që të lajthitemi nga mendja, si thotë populli; të luajmë menç". Mu për këtë dyshim të së keqes së vënies së pasqyrës së madhe në nevojtoren e qelisë, kur shumëçka na mungonte nga e domosdoshmja, m'u bë një mëri ndaj saj, bile edhe në armiqësi kaloi kjo ndjenjë, kisha nevojë edhe ta luftoja pasqyrën. Pas dy ditësh me dhëmbë i shqeva dy llërët e nënkëmishës dhe i bëra si çorapë. Pas pesë ditësh, kur na nxorën në shëtitje, shokët më vërejtën se këmbët i kisha si të ,,arushës''. "Edhe ju shqyeni nënkmishat dhe bëni çorapë", u këshillova me zë të heshtur kur njeri flet në besim. Dhe erdhën nata-dita, dita-nata, përsëri nata-dita e dita-nata... Tridhjetë dita-nata ose nata-dita të këtij muaji të acartë, me të ftohtin sa nuk bën më shumë, ditë-net burgu. Një kokë njeriu si hije më doli në dritare. S`mund t`ia dalloja gojën, as hundën, as sytë, as fytyrën, por kokënjeriu nga dritarja me

,,fliste'' me mimikë kërcënueshëm. Pas disa çastesh koka u largua, por fillova të dëgjoj të grrithura në murin e trashë të burgut, u ngjanin si të thonjve të një maceje. Rrija nën batanijen kureshtar tërë sy e vesh, ndërsa nën dyshek i kisha këpucët(toplinka, si u thonim) në vend të jastëkut, sepse nënkresë nuk kisha. Vëzhëllimat e gërrithjet në qeli sa vinin e shtoheshin, me këtë edhe shqetësimi im. Shqisat i kisha vënë në gjendje gatishmërie… Dëgjohej si të ecte ndonjë iriq. E shtërngoja veten për shtratin si për ndonjë kashte shpëtimtare. Dy rrugë i kisha, të çirresha me sa zë që kisha si i llahtarisuri që kërkon ndihmë ose të luftoja me terrin. Kur vendosa për të dytën, pra luftimin e territ, nxora këpucën e burgut nga nëndysheku dhe e hodha drejt skutës ku dëgjohej ,,iriqi''. ,,Shkllum'' u dëgjua një zë nga drejtimi i nevojtores. Gjumë më nuk bëra. Lindi një mëngjes i acartë.

Gjetja e letrës së zverdhuar në dyshekun e krevatit

Në dhomën numër 15 të burgut të Gjilanit, të burgosurit SH. hisja i ra të flinte në anën e majtë të kësaj dhome. Pas tri jave, vërejti se dysheku i krevatit ku flinte, në një vend ishte i shkoqur, sikur ta kishte prerë dikush atë. Nga kureshtja për këtë të qarë në dyshek, futi dorën në brendësi të tij dhe nga dysheku nxora një letër dhe nga verdhësia e saj, shihej së ishte shkruar vite më parë. Letra ishte shkruar me një laps ngjyre dhe përmbante 10 porosi shumë interesante:

1.Viset shqiptare janë të pushtuara nga jugosllavët dhe derisa të jemi nën pushtimin e tyre, burgjet do të jenë plot me të burgosur politikë.

2.Të jesh i burgosur politik është një nder, por edhe sprovë e rëndë, jeta jote do të jetë një ferr i kësaj bote.

3.Në çfarëdo rrethane që të jesh, mbaje lartë krenarinë tënde, krenaria jote e tmerron pushtuesin.

4.Sa më i fortë të jesh përballë UDB-së, qëndresa jote i çarmatos ata.

5.Ata synojnë të shkatërrojnë shëndetin tënd, por ushqeje atë me idealin e çlirimit dhe të bashkimit.

6.Çdo gjë ka fundin e vet, edhe robëria një ditë do të përfundoj.

7.Ruaje familjen tënde, UDB-a synon ta shkatërrojë atë, e bashkë me familjen, të shkatërron edhe ty.

8.Ruaju dhe të jesh i kujdesshëm me shokët e dhomës, ka shokë që dështojnë kthinave të UDB-së dhe ty të hanë brenda saj.

9.Me sjelljen tënde të mirë, përpiqu edhe vrasësin edhe hajdutin ta shëndrrosh në luftëtarë për lirinë dhe çlirimin e viseve shqiptare nën pushtim.

10.Vdekje pushtuesve të trojeve tona – Liri popullit shqiptarë!

I burgosuri SH. e lexoi letrën fshehurazi dhe përsëri e futi nën dyshek, nuk ua tregoi shokëve të tjerë. Pothuajse çdo ditë e nxjerrte me fshehtësi nga dysheku dhe e përziente me aktvendimet e burgut dhe bëhej kinse po i lexonte ato. Në fakt mësonte përmendësh 10 porositë e të burgosurit që nuk dinte as nga ishte e as a ishte në mesin e të gjallëve. Edhe kur e transferuan nga ky burg, në qershorin e vitit 1986, letra e verdhë me 10 porositë e saja, mbet në brendësi të dyshekut.

I burgosuri SH, do ta kujtoj për jetë letrën dhe të burgosurin anonim të cilin nuk arriti ta njeh kurrë.

Kosi i nënës

Ishte pranvera e vitit 1986. Tanimë i burgosuri SH. kishte kaluar disa muaj në burgun e Gjilanit dhe hetimet ndaj tij, udbashët i bënin natën, ndërsa gjatë ditës, ,,ishte'' i lirë. Familjet e tyre i vizitonin çdo dy javë, natyrisht në ditët e caktuara dhe paraprakisht duhej që familja të merrte lejen për vizitë në Prishtinë. Vizitat realizoheshin nën përcjelljen e UDB-së, me grila në mes dhe në këtë burg, kurrë nuk arriti të preku dorën e nënës, vëllaut, gruas...

Një ditë vizite, nëna nga shtëpia , krahas gjërave të tjera ushqimore, kishte sjellë edhe një enë plastike me kos. Në dhomën numër 15 të burgut të Gjilanit, bashkëvuanim edhe 8 të burgosur të tjerë. Kishte raste, kur kishte arrestime, të ishim edhe nga 10 të burgosur. Vuajtjet, ndihmën dhe ushqimin ,,i hanin'' së bashku.

Krahas ushqimeve të tjera, në ,,sofrën'' e të burgosurve, i burgosuri SH. nxori edhe ,,kosin'' e nënës.

-Çka i thoni ju këtij ushqimi?-pyeti një i burgosur.

-Ne i themi dhalltë, dikush i thotë edhe dhallë. Nëna e din se dhalltin e kam në qejf, andaj sot më paska sjellë pijen që e dua.

Dhe derisa hanim dhe pinim ,,kosin'' e nënës, ajo sikur parakalonte pranë ,,sofrës'' dhe sikur të burgosurit SH. i thoshte: Djali im, rruga e gjatë e tundi, se prej shtëpisë, kos ta kam sjellur.

Letër nga burgu i Gjilanit

E dashura nënë! E di se dimri i këtij viti të ka lodhur shumë. Ishte një dimër me acar e ngrica, me ushqim të pakët e me reumë të thellë. Ç`të bësh, kështu e kanë dimrat. Edhe më i rëndë bëhet kur të birin se ke në shtëpi. Po të isha, së paku disa punë do t`i lehtësoja, por...

Duhet të qëndrojmë e dashura nënë, ti jashtë e unë brenda dhe nuk do të jetë e largët dita kur do të jemi së bashku e ta këndojmë atë këngën e moçme që ti e ke mësuar që në moshë të re:

,, Mos na pritshin për shtatë vjet
Thuju grave ne të shkojnë në shpi të vet
E ti marrin burrat pleq
Burrat pleq, pleq me mjekërr
Ishalla vjen naj dever tjetër!''

Eh, sa shpesh e këndonim këtë këngë buzë oxhakut, dimrave!

E di që ky dimër është më i gjatë se të tjerët, por sa do i gjatë që të jetë, s`mund t`ia zë vendin pranverës. Ajo veç është nisur tanimë që të vjen. A e mban mend kur te Lisi i arës sonë, kur në maje të tij kishte zbritur një dallëndyshe dhe ti thoje që të mos e trembë se ajo kishte sjellur një grusht pranverë. Te lisi në fund të arës, ruaj edhe kujtime të tjera. Aty lexoja edhe libra, nëse të kujtohet ai libri ,,Zgjimi'' për të cilin më pyesje se çka po thotë ky libër. Aty lexoja edhe libra të tjerë...Ta ruani lisin, Nëno! Kemi shumë kujtime të përbashkëta.

E dashura nënë! Në vizitën e fundit, nuk munda të ta prek dorën se

grilat nuk na lejuan, por ta dish që edhe kur s`mundem të të prek, brenda zemrës tënde jam.

E mbyll këtë letër me dëshirën dhe shpresën që ti Nënë të jesh e fortë, të jesh e fortë si ajo Nëna Qëndresë që e lexonim nga libra e leximit. Në Krua të Përtem kur të shkosh me mbushur ujë, të pish edhe pak ujë për mua, ndërsa Pranverën t`ma përqafosh shumë dhe ta urosh që të rritet shpejtë!
Harrova të them se kur të vini në vizitën e radhës, t` më sjellni librin e Dostojevskit ,, Shënime nga shtëpia e të vdekurve" dhe librin e Gaspër Gjinit ,,Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj''.

Bashkohuni shokë, bashkohuni në Demonstratë!

Qyteza buzë lumit, megjithatë kishte historinë e sajë, por meqenëse gjeografikisht shtrihej ndërmjet Grykës dhe Skupit antik, ishte rritur e zhvilluar nën hijen e këtyre kufizave gjeografike dhe nuk dihej shumë për atë.

Krahas fushave dhe maleve, lumi ishte një pasuri tjetër e qytezës dhe me freskinë e tij i jepte gjallëri këtij vendi e sidomos gjatë stinës së nxehtë të verës. Kur dielli zhurite me rrezet e tij, banorët dhe fëmijët e qytezës freskinë e gjenin në valët e bukura të Lypenës, që burimin e kishte dikund në rrënjët e Sharrit. Por ky lum, dinte të ishte edhe idhnak. Kur biente shi me rrëmbim, shpesh vërshonte majtas e djathtas brigjeve të tij, e sikur donte t`u thoshte anasëve se në këtë Fushëgropë, para jush ka qenë një vendbanim i vjetër, por e kam gllabëruar para shumë e shumë shekujve, andaj ...

Aty buzë lumit, dhjetëra metra më largë ishte edhe hekurudha e cila ishte ngritur nga francezët që në kohën e perandorisë osmane në vitin 1873. Kjo hekurudhë, që anasit e quanin ,,Udha e Frengit'' më shumë kishte nxjerrur pasuritë tokësore dhe nëntokësore të këtij atdheu, sa sa kishte sjellur të mira. Por edhe ato të mira që vinin, përfundonin në duartë e atyre që e sundonin këtë popull dhe nuk shtriheshin te shtresat e gjëra popullore.

Mu këtu afër hekurudhës, organizatorët e demonstratës, tre shokë të sapo dalë nga burgu, kishin planifikuar edhe pikën ku duhej të takoheshin ata që kishin shpirtin kryengritës, ata që nuk duronin shtypjen e mëtejmë. Jo rastësisht, Treshja organizuese, kishte caktuar këtu pikën nisëse të demonstratës, sepse hekurudha kishte shumë gurë, dhe këta gurë ishin e vetmja armë që demonstruesit mund ta përdornin kundër policisë së pushtuesit në kundërsulme.

Janari i atij viti, nuk kishte dallim nga janarët e tjerë, ishte i acartë e me plotë borë. Brenda këtij acari të janarit, në gjakun e të rinjëve të qytezës, vlonte dëshira liridashëse, vlonte një ideal për një ditë të re. Treshja organizuese, krahas pikës grumbulluese, që me kohë kishin caktuar edhe parullat që demonstruesit duheshin t`i brohorisnin para masës e cila sa vinte e shtohej. Fillimisht u mlodhën rreth 40 demonstrues, sepse pushtuesi kishte arritur që në popull të fuste një frikë të madhe. Kush kishte pasur guximin që t`ia kthente grushtin atij, masat ndëshkuese kundër tyre kishin qenë të rënda; burgosje, tortura e dënime. Ndërsa familja, izolohej, distancohej e leqitej nga rrethi. Kështu kishte ndodhur edhe me grupin e zbuluar për Republikë në vitin 1985 dhe ende po vuanin burgun nga dënimi pesëvjeçarë. Ishte hera e parë që qyteza dhe banorët e sajë ballafaqoheshin me një demonstratë të tillë, prandaj kjo shënonte edhe një ngjarje të madhe, në rend të parë historike.

Treshja organizuese, kishin dy muaj që kishin dalur nga burgu politik prej dy viteve. Ata ishin dënuar në një grup në vitin 1987 ku kishin vepruar fshehurazi për lirinë e Kosovës, për Kosovën që të bëhej Republikë. Që të tre ishin të rinjë dhe kur ranë në burg nuk kishin më shumë se 19 vite, sejcili. Vrulli i tyre rinor, që në burg ishte ndeshur edhe me vrulle të tjera liridashëse,... ishin ndeshur me shkollën e shokëve të burgut, me shkollën e lirisë, me shkollën e grevës e të rezistencës, me shkollën e demonstratës.

Koha ecte me shpejtësinë e saj e bashkë me atë edhe tiktaket e zemrave djaloshare, shpeshtoheshin. Jo rastësisht, Treshja kishte paracaktuar orën 14.30 minuta ku duhej të fillonte ajo dasma e madhe, sepse në orën 15, punëtorët e turnit të parë duhej të dilnin nga puna, të dilnin nga fabrika e cila çdo ditë

e më shumë kërruste shpinën dhe zverëdhonte fytyrat e tyre. Me daljen e atyre, puna vazhdohej nga turni i dytë. Kështuqë, nga ky grumbullim punëtorësh, Treshja organizuese kishte paraparë edhe përkrahjen e punëtorëve. Grumbullimin e demonstruesve e kishte vërejtur policia, andaj edhe lëvizjet policore shtoheshin e krahas tyre po rritej edhe numri i atyre që kishin ndarë mendjen kryengritëse.

Fillojmë! - foli si nën urdhër Meti. Fillojmë!- u përgjigjën njëzëri Braha e Xhati, dhe me një zë që qyetza e dëgjonte për herë të parë, filloi ajo që kishte kohë që ishte e ndaluar.

Liri, liri, liri! - u dëgjuan brohoritjet e para të demonstruesve dhe ashtu të lidhur krah për krah, filluan rrugëtimin në drejtim të qendrës së qytezës. *Liri, barazi, demokraci*! - ushtonin zërat kryengritës dhe jehona e këtyre brohoritjeve shpërndahej shpateve dhe kodrinave të qytezës dhe sikur ftonte ,,dasmorë'' të tjerë. *Përpara për fitore*!- kumboi zëri si në kor i Treshes duke u pasuar edhe me zëra të tjerë që gjithnjë e më shumë shtoheshin e bashkangjiteshin, dhe vargu demonstrues tanimë kishte kaluar qindëshen.

Liri, demokraci! *Lironi shokët nga burgu*! *Duam punë*! *Poshtë dhuna shtetërore ndaj shqiptarëve!* - gjëmonin zërat e rinisë djaloshare. *Kosova –Republikë*! - kumboi njëzëri Treshja duke u pasuar me qindra zëra të tjerë dhe gjithnjë e më shumë po i afroheshin portës së fabrikës, aty ku demonstruesit kërkonin përkrahës të tjerë, aty ku ishte edhe qendra e qytezës, aty ku ishte edhe pika më e nxehtë e demonstratës. Mu aty ishin krijuar dy barikada, ajo e demonstruesve me zjarrin liridashës, dhe e forcave të rendit me kërbaq e automatikë.

Dhe derisa masa e demonstruesve, brohoriste me tërë fuqinë e saj, njëri nga Treshja organizuese, që quhej

Ibrahimi, hypi mbi një copë betoni ku shiheshin më mirë demonstruesit, dhe para tyre filloi një fjalim mobilizues, një fjalim me plotë zjarr lirie dhe për një çastë mendja i iku te librat e shumta të lexuara qelive të burgut dhe te personazhet kryengritëse...
Të dashur shokë demonstrues!
Mjerimi shoqëror, këtu po e takon idealin e lirisë. Nga përqafimi i të gjitha dëshprimeve tona shoqërore, këtu shpërthen besimi, besimi për një ditë të re, për një ditë më të mirë, për një ditë të lirë. Atë që nuk arritën ta realizojnë brezat tanë para nesh, duhet ta realizojmë ne. O vëllezërit e mi, këtu është vendi i bashkimit të atyre që mendojnë dhe të atyre që vuajnë! Bashkohuni vëllezër, frika duhet të mposhtet, Kosova jonë e dashur po lahet në gjak! Mjaftë më me vrasje, burgosje e terror mbi ne! Ne s`duam asgjë tjetër, pos lirinë, lirinë që na e kanë marrë këta që po na rrethojnë me forcat e tyre, por ne...
Zërin e Ibrahimit, e mbuluan thirrjet e fuqishme të masës e cila tanimë kishte kaluar 300-shin. Disa punëtorë kaluan portën, dhe iu bashkëngjitën masës së demonstruesve. Brohoritjet për liri e demokraci dëgjoheshin gjithnjë e më shumë, por edhe forcat e ndërhyrjes shtoheshin gjithnjë e më tepër.
Në dritaret e shtëpive vëreheshin kokat e atyre që nga brenda përcjellnin demonstratën, ndërsa rruga e magjistrales ishte mbyllur në tërësi. Punëtorët i kishin bllokuar në fabrikë dhe nuk lejoheshin të dilin nga vendet e punës, ndërsa qyteza jehonte nga zëri i demonstruesve.
Nga një lloj arme, prej forcave të rendit, u dëgjua një shpërthim. Disa sosh pasuan shpërthimin e parë dhe ky gaz lotësjellës mbuloi masën e demonstruesve. Shpërndahuni! - dëgjoheshin zërat e policisë. Në vend të

shpërndarjes, demonstruesit u përgjigjën me gurë, të cilët i kishin marrë që më herët në hekurudhë. Nga dy anët e barikadës shpërthenin reagimet, shpërthenin kundërsulmet. Nga policia, gazi lotësjellës që të ngulfaste frymën, e nga ana e liridashësve shpërthenin brohortjet dhe gurët.

Përpara !- u dëgjua sërish zëri i Ibrahimit, që po ngulfatej nga gazi lotësjellës.*Të drejtën e lirisë, s`mund të na e ndalë askush*! *Përpara*!-brohoritën edhe shumë të tjerë..., por masa demonstruese me mjeshtri po tërhiqej në drejtim të kundërt, në drejtim të hekurudhës, aty ku ishte edhe arsenali i tyre i gurëve. Aty u zhvillua edhe pjesa më e lavdishme e demonstratës së asaj dite.

Rrëmuja vazhdoi me orë të tëra dhe rrugët ishte mbushur plotë me gurë, sukur të kishte vërshuar Lypena, ndërsa qiellin e kishte mbuluar gazi lotësjellës. Me këtë ngjarje që qyteza po e përjetonte, sikur toka shiun, dalëngadalë po afrohej edhe nata, natë e cila do të trokiste në dyert e çdo demonstruesi.

Mëngjesi i së nesërmes shumë sosh i gjeti nën pranga, në mesin e tyre edhe dy nga organizuesit, ndërsa i treti kaloi në arrati. Shokët e arrestuar, sërish u kthyen te shokët e vjetër të qelive, prej të cilëve ishin ndarë jo më shumë se dy muajë më parë. Sërish u kthyen në shkollën e burgut, në shkollën e qëndresës e të lirisë, në shkollën e luftës për liri.

***

Kronikat e kohës, rreth kësaj demonstrate, shkruanin:

Përkundër ndërhyrjes së policisë, demonstratat në qytezën buzë lumit vazhduan edhe ditëve të tjera, edhe përkundër arrestime që u bënë. Demonstruesit, me gurë e gjësende të tjera kanë sulmuar policinë, duke arritur të demolojnë edhe stacionin policor.

***

Ndërsa Shërbimi sekret jugosllav, UDB-a, rreth kësaj demonstrate, shkruante:
Një grup nacionalistësh e irredentistësh në përbërje të: I.C, M.B. e N.B. të cilët nga burgu janë liruar dy muaj më parë, nga kanalet tona operative, na është bërë e ditur se po bëjnë përpjekje për organizimin e një demonstrate. Ata, zonën e kanë ndarë në tri pjesë dhe secili nga ata po veprojnë në zonën e caktuar dhe po kërkojnë bashkëmendim-tarë. Që të tre, gjatë tërë natës kanë kontaktuar me shumë të rinjë, duke shfrytëzuar edhe lidhjet familjare dhe këto parashihen që të jenë baza e demonstratës. Informatat tona flasin se ata kanë arritur qëllime të caktuara indoktrinimi, por nga ana jonë po merren të gjitha masat që demonstrata e planifikuar për orën 14.30 minuta, të dështojë...

***

Ndërsa, historiani i trevës, në reflektim të asaj ngjarje të madhe, ndër të tjera, shkruante, se:
Përkundër arrestimeve që ndodhnin, numri i demonstruesve rritej, shumë sosh që nuk morën pjesë në ditën e parë, u bënë pjesëtarë në ditën e dytë... Edhe pse u arrestuan organizatorët, demonstrata për çdo ditë gjente udhëhëqësit e saj. Demonstrata zgjati rreth një javë ditë. Ajo u ndërpre, pasiqë njësitë speciale nga Beogradi, ndërhynë me tërë dhunën e tyre brutale, duke përdorur edhe armët e zjarrit. Ishte fat që kjo demonstratë s`pati të vrarë, ndërsa plumbat e shkrepur goditën shumë objekte në qendër e për rreth saj...

Muzeu

Ç`prej se Arkeologu u punësua si arsimtar i historisë në fshatin e tij, krahas punës me nxënës, filloi të tuboj relikte të vjetra nga e kaluara e popullit shqiptar. Ai, me shumë mundime, në shtëpinë e tij kishte arritur të ngrit një muze lashtësie. Andaj edhe bashkëfshatarët e tij, nuk e thërrisnin me emrin që e kishin pagëzuar pas lindjes, por me një emër krejtësisht tjetër, Arkeolog.

Shtëpia e tij ishte mbushur me relikte e artefakte të ndryshme dhe secili element shpaloste të kaluarën e popullit shqiptar. Pëlqente motivet florore të paraqitura në janat e odave si dhe kornizat kuq e zi të tyre, ndërsa në qilimat e endur në vek i pëlqente forma e thurur e shqiponjës e cila i ngjasonte edhe përkrenares së Skënderbeut. Mblodhi veshje të ndryshme për gra e burra dhe vlerësonte ornamentet etnologjike brenda tyre. Studioi vlerat arkitekturale në shtëpitë e vjetra të trevës e mbi të gjitha spikati vlerat vernakulare në objekte. Mblodhi trashëgiminë bujqësore të trevës dhe i sistemoi ato. Hulumtoi antroponimet, toponimet dhe mikrotoponimet e trevës dhe veçoi ato më të rëndësishmet për studim të mëtejmë si: Pal, Nikë, Kolë, Te Kroi N`ah, Mlojsë, Elbore, Gjolltë, Vathi i Partallit, Prroni i Kalun Gjerës, Llokë, Udha e Mllakës, Mshtekna, Broboshtina, Dëgërgjik, Lisevë, Përroni i Nikobllavës, Kodra e Gjigjëve, Arat e Xhonëve, Livadhet e Gjibretës, Ara e Biznakit, Mali Lapgjan, Rrafshi i Isëbegit, Kodra e Dikaqit, Ara e Bogdanit, Ara e Mulës, Kepi i Markit, Hurdhë, Kroni i Micit, Shorkuqe, Përsllinë, etj. Me shumë interes mblodhi shënime për Kalanë e Ortikës e cila gjendej në anën perëndimore të trevës së tij, në lartësinë mbidetare 627 metra dhe në kordinatat N 42 08 539 dhe E 21 16 277. Erdhi në përfundim se lashtësia e saj ka të bëj me

perandorin ilir Justinianin e Parë dhe se kjo kala shërbente si mbrojtje shpinore e kalasë së madhe të Skupit të lashtë, ndërsa në thellësi të Dardanisë, lidhej edhe me kalanë e Lypetenit në veri. Gjeti brezore bronzi të punuara me teknikën millefiori (nga qelqi) si dhe një brezore tjetër dekorative ku në epiqendrën e saj spikate spiralja koncentrike. Hulumtoi në tërësi varrezat e trevës dhe në shkrimet mbivarrore, zbuloi fibulën e njohur ilire, diellin, sfastikën dhe elemente të ndryshme pellazgo ilire duke përfshirë edhe plisin me diell e hënë të Lekës së Madh. Gjeti monedha të ndryshme nga periudha e Konstandinit, Julianit e Probusit, ndërsa në kisha, krahas fragmenteve të qeramikave e bedenave të saj, Arkeologu gjeti edhe relikte nga koha e kultusprotektoratit austriak.

Arkeologu kishte lindur në vjeshtën e vonë të dyzet e katërtës, atë ditë, kur në fshat kishin depërtuar ,,njerëzit me yll në ballë'' dhe po të njëjtën ditë kishin lidhur burrat e fshatit dhe i kishin pushkatuar. Në mesin e të lidhurve kishte qenë edhe babai i Arkeologut, të cilit ia kishin shuar jetën me të perënduar të diellit në hyrje të Grykës.

Për mënyrën e arrestimit dhe vrasjes së babait, Arkeologu mësoi disa vite më vonë, por gjatë studimeve në Prishtinë historinë e kësaj ngjarjeje e studioi edhe më shumë, falë edhe profesorit të historisë i cili siç thuhej historinë e shpjegonte me rrënjë.

Sa herë që kalonte kah Gryka, s`kishte si të mos i shkonte mendja te njerëzit e pushkatuar të cilët Brigada partizano-çetnike i rrethoi në festën e Bajramit dhe i theri e pushkatoi 111 kryefamiljarë. S`kishte si të mos e kujtonte edhe vrasjen e babait që nuk arriti ta shoh kurrë. Kur një ditë ia kërkoi nënës ndonjë shenjë të babait, nëna nga arka e saj nxori qeleshen e burrit të pushkatuar, të cilën e kishte gjetur në

vendin e pushkatimit te Dheu i Bardhë, andaj edhe eksponati me rëndësi të veçantë, në dhomën muze të mësuesit, ishte pikërisht plisi i bardhë i babait. Por kur një ditë po hulumtonte në vendin ku u ekzekutuan të pafajshmit, nga dheu nxori një kafkë njeriu ku përpos gropëzave të syve që vështronin trishtueshëm, nëntoka kishte ruajtur edhe dhëmbët, nëpërmjet të cilëve, nëna identifikoi babanë e Arkeologut.

Një makinë që u ndal në oborrin e shkollës, nxënësve ua largoi vëmendjen nga mësimi. Me ta vërejtur atë, Arkeologu doli nga mësonjëtorja dhe i uroi mirëseardhje Këshilltarit i cili e kishte bërë traditë të vizitonte mësuesin e historisë.

-Kur isha vjet në mesin tuaj, filloi të flas Këshilltari para nxënësve,-ju ishit më të vegjël, por puna juaj në lëndën e historisë më la mbresa, andaj kisha dëshirë që edhe këtë vit t`ju vizitoj dhe gjithsesi dëshiroj që nga ju të ndahem me përshtypje të mira…

-Pra, vazhdoi shtjellimin e temës Arkeologu - në çastin më kritik , nipi i tij Hamza tradhtoi Skënderbeun. Tradhtia e tij ishte e rëndë për dy çështje: e para se ai ishte nipi , pra gjaku i tij dhe e dyta Hamzai te ushtria turke do të zbulonte numrin e ushtarëve, sasinë e ushqimit, kanalet e ujit dhe strategjinë e luftës. Andaj, duke marrë parasysh këtë fakt fatkeq, Skënderbeu sajoi një strategji të re lufte. Se si do të përfundoj kjo, do të mësojmë në orën e ardhshme kur do të flasim për Betejën e Albulenës.

Cingërima e ziles lajmëroi fundin e orës mësimore, njëkohësisht edhe përfundimin ditor të punës, andaj Arkeologu së bashku me Këshilltarin shkoi në shtëpinë e tij për të ngrënë, siç tha ,,një gojë bukë''.

Sapo u fut në dhomën muze të Arkeologut, Këshilltari vërejti në këndin e saj një kafkë njeriu e mbi të një plis,

verdhësia e të cilit fliste për një kohë më të vjetër, andaj menjëherë e pyeti Arkeologun:
-Po kjo kafkë me plis?
-I zoti i shtëpisë,-iu përgjigj Arkeologu.
-S`paskam pasur rast të shoh mikpritës të tillë?!
-E besoj këtë që po e thoni, por ky që po e shihni vërtetë është i zoti i shtëpisë, sqaroi Arkeologu.
-Si është e mundur kjo?-pyeti plot kureshtje Këshilltari.
-Është babai im. Fytyrën e tij nuk kam arritur ta shoh kurrë.
-E çuditshme - foli nëpër dhëmbë Këshilltari dhe vazhdoi: Cila është historia e kësaj kafke?
Pasi i fshiu djersët e ballit dhe pasi e shoqja e tij shpërndau kafetë, Arkeologu filloi rrëfimin e gjatë e të dhembshëm për babanë, bashkëfshatarët dhe masakrën serbo-çetnike të atij viti.

Arkeologu

- Kjo tokë fsheh gjëra të mrekullueshme,-tha Arkeologu derisa rrotullonte pllakën e gjetur nën dhe - Ja edhe shkronjat, dhe pasi fshiu dheun nga ballina e pllakës, nxori kutinë e cigareve dhe e ndezi një, duke ua ndarë nga një edhe të rinjve duhangjinjë të fshatit të cilët po i ndihmonin Arkeologut.

-Ky është thesari i Ilirikut tonë - vazhdoi ai. Këto janë argumentet e historisë sonë të lashtë, dëshmitë e gjalla ilire përballë propagandës ekspansioniste serbe. Këto shkronja dëshmojnë kohën romake, pra pushtimin romak të Ilirisë, atëherë kur serbët jetonin në Karpate, dhe me një brushë të butë që nxori nga çanta, filloi të pastronte dheun e mbetur në shkronja.

-Ja, lexohen mirë, sqaronte Arkeologu para të rinjve, shkronjat e para : D M dhe vazhdoi leximin e shkronjave në vazhdim: M…I V L I S F,…C V S V I X…^…N , e kështu me radhë deri në rreshtin e dhjetë ku edhe përfundonte mbishkrimi. Pasi mendoi një kohë dhe pasi u konsultua edhe me një libër që nxori nga çanta, iu drejtua të rinjve:

-Kjo pllakë është karakteristikë e shekullit III të erës sonë. I përket Gentilicit perandorak Julius, të cilët në koloninë Scupi janë mjaftë të gjetura. Këtë pllakë, prindërit ia paskan ngritur të birit të tyre, i cili paska vdekur në moshën katërdhjetë vjeçare. Një pllakë e tillë, vazhdoi Arkeologu, është gjetur para disa viteve edhe në qytetin andej Grykës. Ajo është edhe më e vjetër. Është një stellë mbivarrore dhe në atë varrë kanë pushuar Viatori dhe Ulpi Annia.

Perëndimi i diellit paralajmëronte edhe fundin e punës. Blegërimat e qengjave në livadhin e shtëpisë përballë i gëzoheshin kthimit të nënave të tyre nga kullosat. Një bari

me fyell sikur përshëndeste natën që po vinte, por një krismë e thekshme pushke sikur i ndau nga jeta Arkeologun dhe shoqëruesit e tij. U shtrinë përtokë, por pos krismës së pushkës dhe plumbit që ra diku në afërsi të tyre, nuk vërejtën asgjë.

Komandant Xhaviti

Ora i ngjitej katërshit të mëngjesit dhe nuk ishte larg agu i ditës që po vinte. Kur arriti në Fushë të Thanave, papritmas, takoi tre njerëz të panjohur, të cilët posa e vërejtën, me të shpejtë ia rrotulluan pushkët.

-Kush je ti? – u dëgjua zëri i njeriut trupmadh, derisa dy të tjerët po e futnin në rreth udhëtarin e panjohur.

-Jam Arkeologu, u përgjigj ai me zë të shterur , dhe kush e din se sa e sa mendime të shpejta kaluan nëpër kokën e tij e mbi të gjitha krisma e pushkës në Dardhani të Poshtme në mbrëmjen që kaloi.

Dy njerëzit e armatosur iu afruan udhëtarit dhe pushkët i mbanin në drejtim të tij. Pasi ia kontrolluan trupin me shpejtësi dhe vërejtën se udhëtari ishte i pa armatosur,e dërguan te i pari i tyre i cili nuk kishte lëvizur nga pozicioni dhe me të shpejtë filluan t`ia kontrollonin çantën. Nxorën një libër të trashë, një brushë të butë, një metër rrumbullake, një fletore me shënime dhe një pjesë bukë, brenda me ca copa të vogla djathi.

-Kush jeni ju?-kumboi sërish zëri i njeriut të parë të cilin e quanin Xhavit. Nga jeni dhe ku shkoni?

-Jam Arkeologu.Vi nga Dardhania e Poshtme dhe udhëtoj për te një miku im në Ahishtë.

-Ç`hall ke që udhëtoni natën dhe jo ditën?- e pyeti i armatosuri i dytë, derisa i treti po kontrollonte malin për rreth.

-Meqë duhet të takohem me një mik timin - siç iu thashë më parë dhe kam për të udhëtuar në një fshat tjetër, së bashku me atë, për të kursyer kohën, vendosa që një pjesë të udhëtimit ta kaloj natën, gënjeu paq Arkeologu.

-Po ky libër ç`është?- ndërhyri i armatosuri i parë.

-Është një libër mbi ilirët, siç e shihni edhe nga vetë emri,- u përgjigj paksa i çliruar Arkeologu duke krijuar një bindje se njerëzit e armatosur që takoi, nuk kishin të bënin me krismën e pushkës në Dardhani.
-Po kjo brushë, kjo metër, këto shënime ç`janë?, pyetën pothuaj se njëzëri dy të armatosurit.
-Janë vegla pune,-u përgjigj shkurt Arkeologu.
-Me çfarë pune merreni zotëri?-ndërhyri i armatosuri i parë.
-Jam Arkeolog dhe merrem me zbulime arkeologjike. Zbuloj nëntokën e Kosovës dhe pasi mori leje që nga xhepi i tij të nxjerr pakon e cigareve dhe pasi ua shpërndau nga një edhe njerëzve të armatosur, vazhdoi:
-Nëntoka e Kosovës fsheh thesare të çmueshme për historinë e popullit shqiptar. Në dheun e kësaj toke janë rrënjët tona. Unë s`bëj gjë tjetër vetëm se këto gjurmë i nxjerrë në sipërfaqen e tokës së Kosovës që t`i shohim ne, t`i shohin të tjerët.
-Po ju kush jeni, nga vini dhe ç`bëni në këto male, madje me pushkë në duar?-pyeti disi i druajtur Arkeologu.
-Edhe ne si ju jemi, u përgjigj i armatosuri i parë. Derisa ti zotëri, zbulon nëntokën e Kosovës, thesaret dhe rrënjët e saja, ne me armë në duar i mbrojmë këto vlera nga armiqtë e kombit tonë, të cilët, jo vetëm që dëshirojnë që të na e zhdukin nëntokën, por dëshirojnë që t` na shfarosin edhe neve të gjallëve nga faqja e dheut.

Drita kishte marrë udhën e saj dhe Arkeologu ndodhej sikur në një botë tjetër. Tani po i shihte edhe më mirë njerëzit e armatosur. Veshja e tyre, fytyrat e parruara, armët dhe bombat e varura në rripat e pantallonave, para syve të Arkeologut shfaqën heronjtë kombëtarë të dekadave të kaluara dhe në vazhdim, njerëzve të armatosur u tregoi fill e për pe gjithë ndodhinë dhe krismën enigmë të pushkës

në Dardhani të Poshtme dhe pasi të pranishmit e dëgjuan me kujdes e lutën që edhe për një kohë të qëndronte me ata.

Axhentët

-Ne duhet të punojmë më shumë! - shfryente kryeeprori serb para axhentëve të tij, - dhe nëse ne nuk punojmë, djepi i serbizmit mbaroi. Informatat që i sjellni, nuk them që janë të pakta, por ato nuk po e ndryshojnë situatën. Kësaj radhe, para jush kam sjellë një projekt të ri. I ndrituri ynë, një jetë ia fali elaborateve kundër shqiptarëve, dhe nuk mund të themi se ato nuk dhanë rezultate, por për të qenë sukseset edhe më të mëdha, lypset përkushtim, në këtë rast përkushtimi i juaj dhe vazhdoi:Thamë se këta harbut duhet zhdukur dhe kjo është mirë. Megjithatë një popull nuk e zhduk vetëm pushka, ka edhe forma të tjera si përçarjet, grindjet dhe sidomos mosbesimi brenda tyre. Kjo e fundit është arma më e fortë dhe e padukshme që i vret ata për çdo ditë. Kur ka mosbesim, ka dyshim, kur ka dyshim nuk mund të ketë organizim, kur nuk ka organizim atëherë nuk ka edhe rrezik për ne. Andaj, këtë që e them duhet t`ua fusim sa më thellë në shtëpitë e tyre. Krahas bastisjeve për armë që po japin rezultate dhe krahas dhunës së përhershme, ne do të përpiqemi të nxjerrim një libër, fillimisht për një trevë të caktuar, ku do të shkruhet për amoralitetin e tyre. Libri do të filloj me emrat e disa prostitutave që vërtetë merren me këtë ,,zeje'' dhe që i njeh populli, ndërsa në vazhdim të lëndës do të përmendim emra të grave dhe burrave që nuk kanë faje, por që ,,flertimin'' e tyre e teleisim siç dimë ne vetë. Libri do të shpërndahet në emër të një shqiptari të rrejshëm, natën, nëpër oborret e tyre. Pas një jave me siguri do të dëgjohen

edhe krismat e para të pushkëve ndër veti dhe hasmëria do të jet e përjetshme.
E dyta, njerëzit që kanë autoritet në mesin e popullit, atyre duhet t`ju ngjesim bishta, do t`i përfolim që t`ua heqim autoritetin që kanë dhe këta njerzë vazhdimisht t`i rrethojmë me njerzë të këqinj.
Ndërsa axhentët tanë që veprojnë për interesin tonë, do t`ua mbulojmë veset e këqia që kanë, gjithnjë duhet t`i propagandojmë për njerzë të mirë, besnik dhe njerëz të sojit, pra me një fjalë duhet t`i komuflojmë që të depërtojnë sa më thellë në mesin e shqiptarëve.
Çdo popull ka dy anë, ka dy shtresa; ka shtresën e mirë dhe të keqen. Mos harroni, shtresa e keqe, injorante dhe shërbëtorja jonë duhet ta sundoj shtresën e mirë. Shtresa e keqe duhet ta sundojë të mirën, shtresa e keqe duhet ta sundoj të mirën, ky është ligji ynë, ky është ligji serb, po ndodhi ndryshe, sundimi ynë mbi shqiptarët merr fund.

Hoxha i Ahishtes

-Jeta nuk është e njëjtë për të gjithë njerëzit. Dikush dëshiron të mos vdes kurrë, ndërsa tjetrit jeta i duket e gjatë. Për dikë jeta është argëtim, për disa të tjerë rëndim. Dikush jeton, por rron pa jetë. Dikush jeton nga djersa, shumë të tjetër nga mashtrimi. Dikujt i tepron pasuria, shumë të tjerëve u mungon buka. Dikush s`mund ta qoj barkun e dikujt i ngjitet për kurrizi. Dikujt i buzëqeshë fati, tjetrit i mungon fare. Një diell kemi mbi kokë, po për të gjithë nuk nxeh njëjtë. Mbi të njëjtën tokë shkelim, por begatia e saj dallon. Zemër kanë të gjithë, por nga mirësia dallojnë…, rrëfente hoxha i Ahishtes para Timit.

- Kjo tokë ka pasur burra si lisa të mëdhenj. Historia jonë flet për imam të devotshëm dhe kombëtarë të spikatur. Sikur sot i mbaj në mend rrëfimet rreth gjykimit të hoxhë Haki Sermaxhajt në Gjilan si Nacional Demokrat Shqiptar, kur nga qelia e sollën të lidhur me zinxhirë dhe trupin gjysmë të kalbur. E dënuan aq sa deshën. Vdiq në burgun e Mitrovicës së Sremit. Kur u zbulua Mulla Idrisi dhe kur UDB-a e djegu me benzinë në lokalet e saja në Gjilan, ishte një ngjarje e dhembshme për popullin tonë. Imam dhe atdhetarë të tillë dhe të tjerë si Ymer Prizreni, hoxhë Kadri Prishtina, populli ynë ka pasur mjaft dhe këso burra të odave, të fjalës e të besës duhet të kemi edhe sot, njerëz të lidhur fort me truallin dhe popullin e këtij vendi dhe në vazhdim recitoi disa vargje, siç tha ai të Gjergj Fishtës për Hafiz Myslimin:

,, Jasht n`sokak me ftyrë për gur
Shtrinë të ngratin Hafiz Myslimin,
Edhe n`dru e rrahën trimin,
Tue krisë lodra e tuj ra fylli,
Dersa kambës iu thy kërcylli,

E me gand gjith jetën mbet,
Jo për tjetër xhinajet
Veç pse e vetën n`hyqimet:
A ishte shqiptar apo osmanli
Iu përgjegj me trimëni:
Sado që ishte një hafiz,
Jam shqiptar me gjuhë e fis"

Por, krahas këtyre atdhetarëve, kemi pasur edhe imamë që me Kur`an në dorë i kanë shërbyer pushtuesit. Ata me propagandën se ,,nuk jetohet në vendin e kufrit'', ndikuan që shumë shqiptarë të shpërnguleshin për në Turqi, e trojet tona i zaptuan kolonistët serbo-malazez.

Zoti na krijoi të lirë, këmbëngulte hoxha, pushtuesit janë ata që na e kanë bërë jetën terr e zi. Ne duhet të luftojmë për lirinë e dhuruar nga Zoti. Nuk janë të kota pushkët që dëgjohen në Drenicë, Malishevë e Dukagjin…,ato armë kërkojnë lirinë e Kosovës. Adem Jashari që u vra me krejt familjen në Prekaz, është bereqeti i Kosovës dhe i krejt Shqipërisë sonë, ata janë tharmi i bukës së atdheut. Kësaj lufte do t`i ndihmon edhe Zoti sepse Ai në Ballkan ka krijuar baraspeshën biologjike, por pushtuesit janë ata që kanë ndërhyrë si djajtë dhe trupin tonë e copëtuan në shumë pjesë dhe derisa s`bashkohet ky trup, dhembjet nuk do të ndalen…

Muezini në minaren e vogël të xhamisë, ftonte besimtarët në faljen e namazit të ikindisë.

Vapa e asaj vere bashkëjetonte me bombardimet serbe në shtëpitë shqiptare. Gratë, fëmijët dhe pleqtë kalonin nga një fshat në tjetrin. Flaka dhe hiri ishin personazhet e tragjedisë që po zhvillohej.

Plaka Nifë

Arkeologut iu caktua një detyrë me rëndësi të veçantë, por edhe rrezikun e kishte më të madh. Përkundër kësaj, detyrat duheshin kryer dhe urdhrat e Shtabit duheshin përcjellë nga njëra zonë në tjetrën. Fshatra të tëra ishin ndezur dhe me këtë armiku realizonte planin e ,,Tokës së djegur''. Kudo që udhëtonte, ndeshej me varre të reja, kafshë të vrara, bagëti të braktisura. Popullata bartej nga njëra anë në tjetrën. Ushtria Çlirimtare e Kosovës tanimë kishte ndërruar strategjinë e saj; nga lufta në istikame ishte tërhequr në njësi të vogla, por megjithatë vijat e saja strategjike kishin ngelur të pa pushtuara. Shumë kush kishte menduar se puna e saj kishte përfunduar me kaq e mbi të gjitha gëzim të veçantë kishte Kryedemoni ku eprorët e ushtrisë së tij, për sukseset e treguara, i gradoi në shkallë më të larta ushtarake.

-Zoti ju faroftë!-tha plaka Nifë me nipin e vogël mbi shpinë. Ikte në drejtim të luginës me gratë e tjera të lagjes. -Zoti ua humbtë farën!-shfrynte plaka. Si na djegën kështu moj gra? Ku do të shkojmë ne të shkretat? Po fëmijët ku do t`i strehojmë, si do t`i shpëtojmë? Po nuset? Po vajzat e reja? A dëgjuat moj ç`kishin bërë katilët në Shkozë? O Zot, mos na ngarko me gjëra që nuk durohen! O Zot mos na e poshtëro trupin tonë, më mirë na e merr shpirtin!

-Nëna…,motra…,fëmijë të dashur, mos u shqetësoni. Lufta i ka mundimet e saja. Nuk kemi pritur gjë më të mirë nga shkau, pos këto që po i shohim e po i përjetojmë. Ja, ata pushkë që po i dëgjoni, janë pushkët e djemve dhe vëllezërve tanë. Ju do të strehoheni pak këtu e nesër diku tjetër. E rëndë, por për lirinë e vendit –thoshte Arkeologu dhe i tërhiqte të ikurit në drejtim të luginës që kishin përballë.

-Ujë, ujë !-klithte Fazilja,- nuses së Demës i ka rënë të fikët. Ujë, ujë, kush ka prej nesh ujë ? Më shpejtë, më shpejtë!
Arkeologu u afrua në drejtim të zërit që dëgjoi, por ujë s`kishte askush. Nga barku i fryrë, kuptoi se nusja e re ishte paralindjes. Pas disa të rënave faqeve, nuses i kaloi alivania. Zbehtësia e fytyrës paralajmëronte gjakderdhje të madhe. U ngrit me ngadalësi në shoqërim të dy vajzave të reja, por kur me dy duart preku barkun e saj, kuptuan se lindja e saj po fillonte.
Para mbrëmjes, armiku ndërpreu granatimet. Flaka dhe tymi që dilnin nga shtëpitë e djegura, ia kishte ndërruar pamjen qiellit. Peisazhi i kuqërremët dhe dielli që po perëndonte ishin shenja se flaka kërkonte të kalite çelikun….
Nga thellësia e malit, në mes të kësaj katrahure që po ndodhte, dëgjohej kënga e një luftëtari:

Në vet nana gja për mue
Thujmi nanës se jam martue.
Në vet nana ç`nuse mur,
Mur dy plumba nër krahnur.
Në vet nana çfarë gra e kajshin,
Sorra e korba e vajtojshin.
Në vet nana çfar qezi pruni,
Dyshek tokën e jastak gurin.
Dyshek tokën e jastak gurin,
Në ven t`jarganit drrasa bungi.
Në vet nana hiq pa nda
Thuj Isufin se sheh ma...

Vaji i një fëmije që u lind në luginë, paralajmëronte lindje të reja, jetë të re, dëshmorë të rinj.

Linda

- Jeni i çuditshëm z.Arkeolog!- shfaqi habinë e saj Linda, - nuk është koha të merresh me punë të tilla. Njerëzve po u shkon koka, ndërsa ti nëpër gërmadha kërkon dokumente, letërnjoftime, pasaporta…

- Në dukjen e parë keni të drejtë,- ndërhyri Arkeologu, por megjithatë unë mendoj se krahas këtij tmerri që po zhvillohet ndaj nesh, ne duhet kryer edhe punë të tilla, pra edhe punë gërmadhash, siç e cekët ju. Në çantën time kam rezervuar gjëra me vlerë për të ardhmen dhe për të bindur Lindën, nga çanta e tij, nxori një fletë e shkruar në çirilicë me emra të ushtarëve rus që po luftonin në anën e serbëve. Mos vallë të duken gjëra të imta këto që po i sheh? Këto janë shumë pak, madje shumë pak nga tragjedia jonë e madhe që po e përjetojmë çdo ditë. Ndihma ruse për serbët daton me shekuj. Ajo theksohet nga lufta ruso-turke e vitit 1877-1878 kur Serbia pushtoi Sanxhakun e Nishit dhe dëboi me dhunë banorët e mbi 500 fshatrave shqiptare. Krahas kësaj, siç kishte lexuar në një gazetë, mercenarët rus morën pjesë edhe në zhdukjen e çetës çlirimtare të Azem Bejtës në Drenicë. Gjatë luftimeve në Bosnje e Kroaci, morën pjesë njësitë ushtarake si ,,Ujqit caristë" ,,Ujqit e bardhë", etj. Rusët gjithmonë kanë kërkuar kontroll mbi Ballkanin, Detin e Zi dhe basenet e Detit Mesdhe. Teza ruse çirret për të ashtuquajturin ,,kufirin e tyre shpirtëror". Mobilizimi i vullneta-rëve rus në ndihmë serbëve u propagandua me të madhe pas 24 marsit 1999, pas intervenimit të trupave të NATO-s. Duma ruse haptazi kërkoi krijimin e Aleancës politiko-ekonomiko-ushtarake Rusi – Bjellorusi – Jugosllavi dhe kjo ishte një lojë shumë e rrezikshme.

- Ndoshta shpejtova,- ia ktheu Linda me një zë të butë, - Ku marrë vesh unë në gjëra të tilla? Po çfarë shkruan në këtë letër?
- Ky është një dokument fare i thjesht, por që në vetvete ngërthen një të vërtetë të madhe. Që nga fillimi i bombardimeve të NATO-s, në Kosovë janë futur ekspert ushtarak rus dhe nga frontet e luftës përcjellin gjithçka që po ndodhë në Kosovë. Në anën tjetër, vazhdoi Arkeologu, prezenca e ekspertëve rus në zona lufte shërben edhe për të ngritur moralin luftarak te ushtarët dhe eprorët serb. Ja, pra, Lindë e dashur, populli shqiptarë nuk zhvillon luftë vetëm kundër serbëve, por në këtë luftë janë përzier sllavët. Faktet flasin për rus, rumun, ukrainas, bullgar, malazez, maqedonas, etj.
- E ç`djall ju duhet atyre që të përzihen?-pyeti e revoltuar Linda.
- Shqiptarët të ndarë e të copëtuar, të shtypur e të nëpërkëmbur janë pikërisht nga këta. Në kthesa historike, të pa krah siç ishim ne, rusët kanë ndikuar te qendrat vendimmarrëse dhe historikisht na kanë dëmtuar. Nëpërmjet serbëve, rusët ruajnë interesat e tyre në Ballkan, andaj edhe u ndihmojnë sepse duke iu ndihmuar serbëve i ndihmojnë interesave të tyre.
- Në çantën tuaj ,,misterioze'' duket se fshihni edhe gjëra të tjera, pyeti me një kureshtje të ngritur Linda.
- Natyrisht, u përgjigj Arkeologu, - Ky është një shiringë injeksioni që ushtarët serb kanë përdorur në luftë. Nga ky shiringë kanë marrë narkotikë për të qenë më të disponuar në kriminalitetit e tyre, ndërsa këto fotografi që i gjeta në një shtëpi të braktisur, flet mjaft për egërsinë e tyre. Këtu shihen qartë katër ,, C '' serbe të gërryera me thikë në gjoksin e vajzave shqiptare para se të dhunoheshin si dhe

flokë të shkulura me gjithë lëkurë. Këtu kemi tru të derdhur nëpër tokë, fëmijë e pleq pa kokë, kufoma të djegura, kafshë të vrara.
- Pse kafshë të vrara?!-pyeti Linda, sikur deshi të largohet nga ajo tablo tmerri që demonstronte Arkeologu.
- Kam lexuar dikund se popujt pushtues që jetojnë nga robëria e të tjerëve, shumë shpejt dehumanizohen , por te raca serbe, dehumanizimi shkon edhe një hap më shumë, kriminalizohet në tërësi dhe synon të zhdukë gjithçka që është pronë shqiptare, madje edhe lopët - u përgjigj Arkeologu.
Shpejtësia e disa aeroplanëve luftarak të NATO-s që shkonin në drejtim të veriut, ia mbuloi zërin Arkeologut. Oshtima e tyre fliste mjaftë. Në Kosovë shpalosej e vërteta. Në Kosovën dardane po ngadhënjente liria.

Në Kodrën e Bajrakut

Kishte kohë që në Kodër të Bajrakut, frymohej ndryshe. Zjarret e Marsit kishin përflakur edhe majën më të lartë të saj. Kishte pasur shumë të drejtë gjeniu popullor kur kishte thënë: ,,Bjeshkët janë aleati ynë më i mirë''. Këtë madje e përsëriste shpesh edhe Komandanti i cili nga mosha dukej më i vjetër se sa në realitet që ishte.

Në njësitin e parë në Kodër të Bajrakut nuk kishte shumë luftëtarë edhe pse kërkesat e të rinjve nuk ishin të vogla. Më tepër kjo bazë, fillimisht luftës i shërbente për kalimin e njerëzve për në kufi dhe anasjelltas, por më vonë me zhvillimin e ngjarjeve, kjo pikë luftarake jo vetëm që do të rritej në një Brigadë, por kësaj zone do të kalojnë edhe figurat më të rëndësishme të luftës, andaj Kodrës së Bajrakut edhe më shumë ia skalitnin emrin, gjegjësisht namin e saj.

Verë e vjeshtë i kaluan në një tendë në mes të malit, ndërsa bukën ia sjellin banorët e Lagjes së Vogël me zemër të madhe nga dera e të cilëve kishin dalë atdhetarë të spikatur dhe pushteti i pas Luftës së Dytë Botërore i kishte burgosur me vite të gjata burgu.

Komandanti me kohë kishte zgjeruar rrjetin e ndihmësve në Qytezë dhe fshatrat përreth si dhe njësinë furnizuese të Njësitit që bazën e kishte në Selishtë, ndërsa me Bardhanët i ndante lumi nëpër të cilin kush e din se sa e sa herë e kaluan.

Vesa e përditshme solli borën e parë dhe zbardhoi Kodrën e Bajrakut. Njësitin e detyroi që të vendosej në një shtëpi të vjetër, të pabanuar të Lagjes së Vogël. Një shtëpi dykatëshe me tri dhoma në katin e dytë dhe me po aq në përdhese. Lidhja me katin e dytë bëhej nëpërmjet shkallëve pingule, natyrisht të papërshtatshme për rrethana alarmi.

Njëra dhomë përdorej për të përgatitur ushqimin, e dyta për mbajtjen e armatimit, ndërsa e treta për fjetje. Në vende të caktuara strategjike ngritën vëzhgimoret, ku ushtarët ndërroheshin sipas orarit ushtarak.
Njësiti kishte ngritur një bazë stërvitore në shtetin amë nën udhëheqjen e Metit, i cili në Lëvizjen ilegale kishte një përvojë të gjatë, ndërsa shumë luftëtarë të tjerë të kësaj treve, luftonin fushëbetejave të Kosovës. Ata që shprehnin dëshirën për t`iu bashkangjitur radhëve të luftës për liri, më parë kalonin në qendrën stërvitore dhe më pas futeshin në Kosovë ku zullumi serb ishte trashur më shumë se fjala e urtë e popullit.
Lufta e atij viti, shumë familje i la pa kulm mbi kokë. Misioni Verifikues, si ndërmjetës në situatë, mundohej që të sanonte gjendjen, por secili në vetëdijen e tij e dinte se një sanim i tillë është i përkohshëm dhe viti që do të vjen do të jetë më i përgjakshëm se ky që po kalonte. Këtë e dinin edhe luftëtarët e Njësitit në Kodrën e Bajrakut, të cilët kishin arritur t`i hapnin disa vija furnizuese, por megjithatë nevoja për armatim ishte shumë më e madhe.
Kur Veliu me gjakun e tij të njomë skuqi borën e Pashtrikut, Njësiti ndjeu një dhembje të madhe pasi që dëshmori i ri, fundin e rrugëtimit e kishte Kodrën me Bajrak. Kur kuptuan se në Pashtrik kishte dhe të vrarë të tjerë dhe se janë zënë rob nëntë ushtarë, ku dy prej tyre ishin nga Qyteza buzë lumit, Komandanti i Njësitit, gatishmërinë ushtarake e ngriti në shkallë të parë.
-A mund të na sulmojnë natën? - pyeti ushtari i cili në Njësit kishte ardhur para dy ditëve.-Pse, të ndaluar e kanë? - u përgjigj shoqëruesi që në Njësit ishte që nga ditët e para dhe ktheu kokën nga qielli sikur donte t`i numëronte yjet në natën e acartë.

-E kemi shumë larg pikën tjetër të zjarrit?
- Nuk mund të them që është larg, përgjigjej shoqëruesi, por nëse ndonjë befasi armike vjen në drejtimin tonë, ne duhet ta përballojmë sulmin, derisa të alarmohen pikat tjera. Atëherë, ne kalojmë në pozicionin e dytë që armiku të nënkuptojë se ne lëshuam pozicionin e nga pika e dytë e sulmit, rezultatet me siguri do të jenë më të mëdha.
-Para se të vijë në roje, dëgjova Komandantin që fliste për Bunkerin e Vdekjes. Jam kureshtar të di se ç`është ky bunker? - pyeti ushtari i ri .
-E kam vështirë t`i them të gjitha,- tha shoqëruesi, por meqë po të ngacmon kureshtja, të sqaroj se Bunkeri i Vdekjes është pika e fundit e luftës. Nga ajo qendër zjarri ose duhet ta likuidojmë armikun ose varri ynë do të jetë bunkeri, andaj edhe e pagëzuam me një emër të tillë.
Pas përgjigjes së shoqëruesit, pasoi një heshtje. Ushtari nguliti edhe më tepër kapelën ushtarake në kokë. Shoqëruesi nga xhepi i xhaketës nxori një pjesë bukë dhe e ndau me ushtarin e ri. Një pjesë bore që u shkëput nga dega e një lisi, bëri që ushtarët të marrin pozicion lufte.
-Sa do të zgjat kjo luftë dhe si do të jetë Kosova pas saj?- përsëri e ngacmonte me pyetje ushtari kureshtar, shokun e tij shoqërues.
-Nuk mund ta dijë askush se sa do të zgjas lufta, sepse varet nga rrethanat që do të zhvillohen. Puna jonë është ta forcojmë zonën tonë me armatim dhe sa më shumë të kuptojmë artin ushtarak. Nëse i bëjmë këto, më të vogla do të jenë humbjet. Ndërsa, për Kosovën e pasluftës me siguri nuk do të jetë kështu siç është sot. Mund të jetë më e mirë, por mund të jetë edhe më ndryshe. Kush e dinë?! Mendoj se, e detyrueshme është liria dhe njerëzit e saj. Po të jenë këta, të tjerat rregullohen. Po në fund të fundit, kush

siguron se ne do të jemi gjallë ore shoku im? Pastaj, kush e din edhe nëse mbetemi gjallë, mund të vijnë kohëra të tjera e neve mund t`mos na bëj kush mall.
-Si, mund të ndodhin gjëra të tilla?!-ndërhyri ushtari i ri.
,,Pushka për Ushtarin, Pushka për Ushtarin'', u dëgjua zëri i Komandantit në radiolidhjen e tyre.
,,Nga drejtimi juaj, para mëngjesit, duhet të vijnë dy shoqërues dhe një luftëtarë që vjen nga zonat tjera. Kujdes, parulla e njohjes është ,,Thana'' urdhëroi Komandanti.
Të lehura qenësh dëgjoheshin në fshatin tjetër. Hëna e plotë ndriçonte edhe më shumë në bardhësinë e borës. Ushtarët vazhdonin të qëndronin në istikame.Të ftohtit kalonte në trupat e ushtarëve, por zjarri i tyre i brendshëm, sikur shkrinte akullin dhe ngricat e atij dimri.
Sikur ushtarët të kishin mësuar më parë se luftëtari që do të vinte me dy shoqëruesit do të jetë Lushi, do të gëzoheshin edhe më tepër. Atij i kishte dalë zëri në shumë anë të Kosovës, andaj jo vetëm që Njësitit do t`i shtohej një krah lufte, por ushtarët vetën do ta ndjenin edhe më të fortë. Në fund të fundit Lushi nga lufta çlirimtare sjellte përvojë, e krahas kësaj edhe strategji të reja.
- Një ditë pasi iu bashkëngjita Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, - filloi të rrëfente Lushi ushtarëve të Njësitit, - armiku ndërmori një sulm me përmasa të gjëra. Kishte aktivizuar rreth 60 mjete të motorizuara. Në istikam më dridheshin duart e së bashku me duart edhe automatiku. Një shok afër meje, tani dëshmor, pasi më preku lehtas në qafë më tha:
,, Lush, e di se e ke vështirë sepse është dita e parë që merr pjesë në luftë, por të siguroj se serbi kurrë s`do të mund t`i kaloj istikamet tona, për këtë do të bindesh edhe vetë.''Ashtu edhe ndodhi, vazhdonte rrëfimin Lushi,

armiku s`pat çka të na bëj. Atyre çasteve zbulova armën më të fortë të UÇK-së - moralin luftarak, andaj të nderuar luftëtarë ky moral do të ngadhënjejë mbi trupat armike pavarësisht se sa të motorizuara të jenë.
Komandantin e parë e kisha nga Baja e Malishevës, por edhe komanda kryesore gjendej në të njëjtin qytet, ndërsa pikat luftarake ishin: Gryka e Llapushnikut, Kijeva, Ostrozubi dhe Bllaca. Kur kalova në Bllacë, ndërmjet nesh dhe pozicioneve serbe ishte një largësi rreth 700 metra dhe s`kishte ditë që nuk ndesheshim me forcat okupuese. Kur serbët ndërmorën kundërsulm ndaj Rahavecit, dy kamion me ushtarë të UÇK-së, në mesin e tyre edhe unë, u nisëm në ndihmë forcave tona në këtë qytet. Serbët kishin hapur vijën frontale të sulmit, por njëkohësisht kishin marr edhe krahët dhe forcat tona i kishin futur në rrethim. Ndihma nga ana jonë dhe njësive të tjera, bënë që humbjet në këtë qytet të jenë më të vogla. Me këtë duhet të them se kudo që sulmohen njësitë tona, ne duhet t`iu dalim në ndihmë. Në Rahavec kemi luftuar dy ditë me radhë. Pas rënies së këtij qyteti, ra edhe Malisheva dhe serbët të trimëruar nga suksesi i tyre e thyen edhe Grykën e Llapushnikut dhe kjo ishte një humbje e madhe për ne. Kur je i motivuar drejt për lirinë e atdheut, humbjet eventuale nuk mund të ndikojnë në dështim, përkundrazi, betejat që do të pasojnë më pas do të dëshmojnë se nga pësimet, duhet nxjerr mësime. Pas Rahavecit sërish kthehem në Bllacë, por me t`u kthyer atje, tanket serbe tentonin të depërtonin në pozicionet tona. Luftuam katër ditë rresht. Përparësia jonë ishte se patëm ngritur istikame të thella, mund të vraponim në këmbë, ndërsa pikat e zjarrit ishin rregulluar një shkallë më lartë. Bunkerët i kishim të mbuluar me lisa të trashë, e mbi drunj, thasë me rërë. Kishim edhe një bunker të maskuar me

mullarë bari. Në ditën e tretë tanket serbe arritën një afërsi prej 100 metra, por përballuam sulmin. Më e rënda ishte dita e katërt, kur tanket arritën të afrohen edhe më afër. Në istikame mbetëm një pjesë e vogël e ushtarëve, gjegjësisht gjashtë, pjesën tjetër e tërhoqi komandanti. Filloi një luftë për jetë a vdekje. Deri në orën dhjetë jemi plagosur të gjithë. Një shok i imi me mortajë dore sulmon tankun, por nuk e godet. Meqë serbët zbuluan se prej kah ne gjuajtëm me mortajë, na mbuluan me breshëri. Dheu na mbuloi të gjithëve dhe plagosem në shpatull. Duke qenë i bindur se po vdesim, në çastet e fundit ia marr mortajën shokut dhe e drejtoj në drejtim të tankut. Kam vërejtur kur flaka e kaploi në tërësi atë dhe pas një breshërie të madhe të forcave serbe, ata, për fatin tonë tërhiqen. Përjetuam një gëzim të madh. Me këtë dua të them se në luftë duhet këmbëngulje dhe guxim, kjo është abetarja e çlirimtarëve.

Pika e zjarrit në verilindje, njoftonte për një lëvizje të theksuar kamionësh në Grykë. Alarmohen të gjitha pikat…Para agut, Njësia furnizuese solli ,,Gulinovin" dhe uniforma ushtarake. Agoi një mëngjes i acartë.

INTERMEXO 1

Ushtar i UÇK-së jam që nga qershori i vitit 1998, por derisa nuk shpërtheu lufta në anën tonë, kam vepruar në vijën furnizuese, sipas urdhërave të Shtabit në Puset e Nikës. Kur shpërthyen pushkët e para më 26 shkurt, isha ushtar aktiv dhe forcat e armikut nuk mundën të depërtojnë në zonën tonë të lirë. Ishte një ngjarje e madhe. Në betejën e 26 shkurtit jam plagosur nga dy plumba, njëri në brinjë, ndërsa tjetri në krah. Ashtu i plagosur jam nisur për fshatin Kotlinë, ku edhe mora ndihmën e parë. Kur ndodhi lufta edhe në Kotlinë, mua ashtu të plagosur më bartën në fshatin e Vajës, por kur u djeg edhe Vaja, më 9 mars 1999, transferohem në Tetovë për shërim të mëtejmë.

***

Pjesëtar i UÇK-së jam që nga qershori i vitit 1998, kur edhe u vendos Shtabi i UÇK-së në shtëpitë tona në Puset e Nikës. Kemi kryer të gjitha detyrat që na i ngarkonte Shtabi, qoftë si vijë furnizuese, qoftë për punë të tjera. Jam pjesëmarrës edhe i betejes së 26 shkurtit 1999, madje pikërisht në këtë ditë, para orëve të mëngjesit morëm një grup ushtarësh që vinin nga Shqipëria e në mesin e tyre edhe ushtarë nga Shala e Bajgorës, bashkë me ato sollëm edhe armatim. Kur serbët tentuan të marrin pozicionet tona, një grup u pozicionua Te Antena e në këtë grup bënte pjesë edhe dëshmori Xhemsedin Suma, tjetri grup u pozicionua te bunkerat afër Arës së Misimit, ndërsa grupi tjetër Te Lamtë. Forcat armike nuk mundën të depërtojnë në pozicionet tona, u përballën me rezistencën tonë dhe i detyruam të tërhiqen. Derisa po vëzhgonim terrenin dhe tërheqjen e tyre, nga kazerma në Han të Elezit, serbët më plagosën me pushkë snajperike në brinjë dhe kisha shumë gjakderdhje. Krahas ushtarëve të tjerë që erdhën të më ndihmojnë, ishte edhe dëshmori Nuri Bushi. Nga Puset e

Nikës, kaloj në Kotlinë, por meqenëse pas disa ditëve në luftime u përfshi edhe ky fshat, kaloj në Vajë e nga Vaja në Tetovë për shërim të mëtejmë.

***

Nata e 2 marsit 1999, ishte një natë e ftohtë. Forcat serbe, që nga ora tre e mëngjesit ishin vënë në lëvizje në drejtimin tonë. U dha alarmi nga Komanda për t`i përforcuar pikat. Rreziku nga sulmi ishte evident. Jam pozicionuar në pikën te Guri i Rezhdës dhe në krahun e djathtë kisha Bajram Plisbardhin. Për rreth ushtarët e tjerë. Ishte një rrethim në shkallë të gjerë. Të gjitha pikat tona sulmoheshin, ndërsa granatahedhësit nga të gjitha drejtimet sulmonin Kodrën e Bajrakut. Të dukej se po çahej kodra...
Një ushtar serb me pushkomitraloz ishte afruar afër vendit ku isha unë. Me kundërpërgjigjen time, përfundoi misioni i tij. Kështu veprova edhe ndaj një ushtari tjetër i cili fillimisht u godit në helmetë, e kur u ngrit nga tronditja e kokës, plumbi tjetër e mori në trup. Një grup tjetër serbësh po i afroheshin një grope, dhe në momentin kur po e hidhja bombën, një breshëri automatiku më godet në bark dhe mi nxori zorrët jashtë. Pas plagosjes u tërhoqa nga shokët më të afërm: Selajdini dhe Rrahimi, të cilët më përcollën te mjeku Fatmir ku edhe mora ndihmën e parë. Meqë granatimet nuk pushonin mbi Kodrën e Bajrakut, shokët më transferuan në spitalin e improvizuar në fshatin e Vajës ku Dr.Imeri bëri intervenimin kirurgjik duke mi futur zorrët brenda pa anestezion. Por, meqë edhe këtë zonë e përfshiu lufta, me shumë mundime, me një grup luftëtarësh të plagosur, kaluam në Tetovë për kurim të mëtejmë. Ndërkohë kuptova se në betejën e madhe të 2 e 3 marsit, dëshmorë kishin rënë; Nuri Bushi e Xhemsedin Suma.

* * *

Për në Shqipëri u nisa bashkë me dy kushërinjtë e mi, njëri nga ata dëshmori i 14 Dhjetorit. Për dy muaj me radhë stërvitemi në Vlahën. Me 13 dhjetor me 142 ushtarë nisemi nga Cahani për të kaluar malet e Pashtrikut për të kaluar në Kosovë. Para se të arrijmë në Lubizhdë të Hasit biem në pritën serbe. Zhvillohen luftime të rrepta. Krahas armikut të parë, të dytin e kishim borën e madhe dhe peshën me armatim në shpinë. Në përjetësi kaluan 41 dëshmorë në mesin e tyre edhe Veliu. Në këto luftime plagosem në kokë nga predhat e granatës dhe forcat serbe më kapin të gjallë. Përpos meje zihen edhe tetë luftëtarë të tjerë. Fillimisht na dërgojnë në burgun e Prizrenit ku torturohemi rëndë pastaj me helikopter, transferohemi në burgun ushtarak të Nishit.
Ne, nuk kemi pasur njohuri rreth bisedimeve ndërmjet OSBE-së – UÇK-së dhe armatës serbe. Dhjetë ditë para se të lirohemi nga burgu na vizitoi OSBE-ja, por nuk treguan për negociatat. Lirohemi me datën 25 janar 1999. Në Kosovë futemi nëpërmjet Gjilanit. Në Therandë na mori OSBE-ja dhe na dërgoi në Likoc. Na priti zëdhënësi i UÇK-së. Ishte gëzim i papërshkrueshëm. Në Shtabin e Përgjithshëm qëndruam edhe dy ditë tjera dhe nëpërmjet Kleqkës-Bllacës-Krojmirit-Shtimjes-Jezercit, arritëm në Kodrën e Bajrakut.

* * *

Në Kosovë erdha nga Austria ku kisha shkuar për bukën e gojës. Kam nderë të veçantë që fillimisht kam qenë ushtar i Fehmi Lladrovcit. Kam marrë pjesë në shumë beteja. Ruaj shumë kujtime. Një javë para se të vinte prilli, me një grup luftëtarësh nga Kodra e Bajrakut shkonim për të marrë vullnetarë në kufi. Nga radha isha i katërti. Në çast

shpërthen mina e vendosur nga serbët. Këputa këmbën, humba gjymtyrën e trupit tim të njomë. Nuk munda t`i gjejë copat e këmbës sime. U ngjizën me dheun e atdheut.

* * *

Më quajnë Xhemë Kaçaniku. Në Kosovë futem nëpërmjet Shqipërisë. Kam marrë pjesë në pesë beteja. Në Dragabil të Malishevës ku kemi pas suksese të jashtëzakonshme. Beteja e dytë ishte në Malishevë. Në këtë betejë u plagosa dhe mora lëndime të lehta trupore. Beteja e tretë ishte në Kleçkë ku u përballëm me makinerinë e rëndë të çetnikëve. Beteja e katërt ishte në Drenicë, përkatësisht në Komoran. Beteja e pestë ishte më e përgjakshme, ku mua dhe dy ushtarëve të mi na ishte përgatitur pusi nga serbët. Ishim në një konsultim në Shtime. Gjatë kthimit pasojnë luftimet. Hasëm në patrullën policore ku ishin me dhjetëra policë. Fillojnë luftimet. Dy luftëtarët e mi plagosen dhe pas urdhrit tim që të tërhiqen, plagosem edhe unë me tre plumba në këmbë. Plumbat ma kapën edhe automatikun tim dhe e paaftësojnë për luftime. Fillova të shtijë me revole. Serbët tërhoqën kufomat dhe ikën, por unë mbeta për katër orë me radhë derisa erdhën përforcimet nga Shtabi. Kisha derdhur shumë gjak dhe isha në alivani…
(Beteja e gjashtë dhe e fundit në jetën e Xhemë Kaçanikut ishte Reçaku i 15 janarit).

* * *

Në fshatin përballë Kodrës, armiku arriti të depërtojë në brendi të tij. Para se ta ndezin fshatin, nga shtëpitë nxorën, burra, gra, fëmijë. Idrizin e mbytën me kondakë pushke.

Gratë dhe fëmijët i ngarkuan në kamion. Mbeta në bodrumin e shtëpisë që po ndizej. Hoqa llambën elektrike dhe u fsheha prapa grumbullit të fshesave që i mbjellim arave. Dy herë polici serb u fut në bodrum. Ndezi ndërprerësin, por llambën e kisha hequr me kohë. Pas pak dola fshehurazi nga bodrumi se ai po shembej dhe meqë xhamia ishte afër u futa në minare të saj ku nëpërmjet vrimave të minares, vërejta me sytë e mi tërë masakrën që bëhej ndaj bashkëfshtarëve të mi Te Bunari në Shulla të fshatit Kotlinë. Dëgjoja piskama të tmerrshme, njerëzit torturoheshin mizorisht me shkopinj në të cilët kishin ngulur gozhda dhe pasi i futën në bunar, atë e shembën me bomba dhe eksploziv. I vranë 22 fshatarë. Ishte 24 marsi i vitit 1999. Nuk di më se kah kam shkuar.

* * *

Bëj pjesë në bërthamën e parë të UÇK-së në trevën tonë. Me urdhër të Shtabit kaloj në Shqipëri nëpërmjet Dibrës. Më pastaj kaloj në Vlahën ku edhe i fillojmë stërvitjet ushtarake. Në Kalimash mbetëm me 21 ushtarë të trevës sonë. Me 9 prill nga forcat e UÇK-së thyhet kufiri Shqipëri-Kosovë. Në këtë betejë marrim pjesë të gjithë ushtarët e trevës sonë që mbetëm atje. Luftimet kanë zgjatur nga 9 prilli deri më 20 prill. Rrasa e Zogut dhe vëzhgimoret merren që ditën e parë, ndërsa kazerma ditën e dytë. Me 9 prill bie dëshmor Abushi. Me 17 prill forcat serbe ndërmarrin kundërsulm për t`i rimarrë pikat. Në këtë betejë bie dëshmor Imriu dhe Zekriu , ndërsa plagosen Baftiu dhe Sadiku. Baftiun e transferuan në spital me plagë të rënda. Me 8 maj, duke tentuar të depërtojmë në Kodrën e Bajrakut në vendin e

quajtur ,, Te lugjet '' bie në mina Fuati dhe i këputet këmba.

* * *

Në luftë erdha nga Zvicra dhe asaj i bashkëngjitëm në Koshare. Në vijën e luftës mbetëm të ngujuar për 24 orë me radhë dhe nga breshëritë e sulmeve armike s`kemi mundur të ngremë kokat. Arritën të ndërrojmë pikën e luftimit dhe me 50 luftëtarë tjerë, arritëm t`i depërtojmë armikut pas shpine. E sulmuam në befasi. Kishte humbje të konsiderueshme.

Plagosem rëndë me 31 maj ku një copë e predhës së tankut më godet në bark, ndërsa pjesa tjetër e predhës e godet Bashkimin në gjoks. Shokët na tërhoqën në spitalin e qytetit të Bajram Currit dhe aty më ka operuar një maroken. Plaga ime kishte një gjatësi prej 15 penjësh. Më pastaj më transferojnë me helikopter për në Tiranë.

* * *

Në gushtin e 98-tës kalova në Shqipëri gjegjësisht në Kukës, ndërsa stërvitjet ushtarake i kreva në Vlanë dhe Babina të Bajram Currit. Stërvitjet zgjatën tre muaj ditë. Në Ditën e Flamurit me 150 luftëtarë të tjerë morëm udhë për të depërtuar në Kosovë. Ishte dimër i madh. Në shpinë kishim rreth 30-40 kilogram peshë. Përcjellës kishim hasjanin H. Xhebegjinë. Pa e ditur jemi futur në një rrugë e cila na qoi drejt në kazermën serbe. Ushtria serbe sulmoi dhe plagoset përcjellësi Xhebegjia dhe njëkohësisht e zunë të gjallë.

Për shkak të arrestimit të përcjellësit tonë dhe borës së madhe, rreth Pashtrikut jemi sjellur tri herë, ku nga lodhja e madhe, luftëtarët alivanoseshin. Më në fund kalojmë në Kuzhnin pastaj në Kabash e më në fund në Lubizhdë ku na pritën ushtarët e Brigadës 123 të Pashtrikut e cila na përcjelli

në Breshancë të Suharekës në Lagjen Nishoraj. Pranë kësaj Brigade kam qëndruar deri më 3 mars ku me leje të Shtabit kaloj në Kodrën e Bajrakut si ushtar i Brigadës 164 dhe plagosem rëndë në këmbën e djathtë. Për shërim kaloj në spitalin e Tetovës.

INTERMEXO 2

Në Brigadën tonë, arriti një ekip i Radio Televizionit Francez për të marrë informacione rreth situatës politike dhe refugjatëve që me të madhe kalonin Grykën. Dukeshin të sjellshëm. Për të filmuar forcat serbe, me gazetarët, iu afruam afër pozicioneve serbe. Në momentin kur po ktheheshim na hetuan dhe filluan gjuajtjet e tyre.

* * *

Aty kah ora 5 e mëngjesit ramë në përrua. Shkuam te vendi ku e kishim pastruar rrugën nga minat. Nxorëm 40 copë. Në një vend ku ndaheshin dy rrugët, zbulova edhe një vend tjetër të minuar. Prej aty shihej qartë një trup i shtrirë që kishte filluar të mbulohej nga bari. Poshtë te këmbët vërejta mirë automatikun dhe një dru ishte i ngulur te koka. Tani duhej të çminohej edhe ajo rrugë që qonte te kufoma. I nxorëm 78 copa.

* * *

Meqë ishim të lodhur u ulëm pak të pushojmë. Fshati nëpër të cilin kalonim, ku më parë ishte bërë masakra e tmerrshme në banorët e tij, ishte i shkretë. Shihje vetëm qentë që sulmonin kafshët e pakta që kishin mbetur.

* * *

Grupi vëzhgues, te Baseni i ujit, sulmuan një automjet ushtarak të armikut. Sulmi ishte i suksesshëm. Pas dhjetë minutave filluan granatimet serbe mbi pozicionet tona. Ranë mbi njëqind granata. Sulmet zgjatën mbi dy orë.

* * *

Në afërsi të Guranës, njësiti ynë sulmoi dy kamion ushtarak serb. Më parë vramë dy ushtarë që ecnin para kamionëve e pastaj me mortajë dore sulmuam kamionin e parë. Sulmi ishte i suksesshëm.

* * *

Duke filluar nga orët e mëngjesit, ushtria serbe tentoi t`i fus në rrethim pjesën tjetër të Brigadës andej lumit. Luftimet janë zhvilluar nga afërsia. Armiku pësoi humbje; u vra eprori i tyre me disa ushtarë si dhe arritëm t`ua marrim minahedhësin 82 mm, harta luftarake, pushkë automatike dhe gjësende tjera, ndërsa nga ana e UÇK-së plagosen dy ushtarë.

* * *

Nga një kamion, serbët zbarkuan disa sënduk. Pasi hapën një gropë diçka futën në të. Dyshohet për varrezë.

* * *

Nga aksioni që kishte përfunduar plotësisht i suksesshëm në Kryenik, shokët u kthyen në orën 22,30. Në fakt ky aksion u përgatitë për dy ditë me radhë. Fillimisht vendosëm minat antitank. Ushtarët serb kishin zaptuar shtëpitë shqiptare dhe i përdornin si kazerma. Sulmin e parë e bëmë me mortajë 500 mm dhe arritëm ta shkatërrojmë objektin e bashkë me atë edhe ushtarët serb. Sulmin me mortajë e shoqëruan edhe armët tjera të ushtarëve tanë. Të nesërmen, derisa serbët tërhiqnin të vrarët e tyre, bie në mina kamioni me ushtarë. Ishte një aksion plotësisht i suksesshëm. Armiku pësoi një humbje të madhe si në kapacitete njerëzore e gjithashtu edhe në

teknikë luftarake. Nga ana jonë kishim vetëm një të plagosur dhe e përcollëm për shërim të mëtejmë në Tetovë.

* * *

Derisa vëzhgonim terrenin, te Çeshmja e Shahës, hasëm në një grup ushtarësh serb të cilët bënin minimin e rrugës. Sulmi mbi ata ishte i shpejtë dhe plotësisht i befasishëm. Korrëm edhe një fitore.

Letra me alfabet numerik

Deri vonë, Arkeologun nuk e zuri gjumi. Në kokë i parakalonin skena nga më të ndryshmet. Ndezje fshatrash, granatime të pandërprera, shtëpi të plaçkitura, dëbime, vrasje, trupa të karbonizuar, kundërmime të kufomave, dhunime e tmerre. Deshi nga çanta të nxirrte Ditarin, por kur iu kujtua se mungonte drita për lexim, hoqi dorë. U rrotullua disa herë, por përsëri gjumi nuk e mori. Nën jastëkun ku ishte mbështetur e vendosi një letër të gjatë të shkruar me alfabet numerik, ku ndër të tjera shkruante:

17 23 8 3 5 26 - 8 10 - 5 23 10 4 28 - 9 20 23 15 17 28 -10 - 28 3 4 - 21 20 - 28 10 18 28 20 18 - 28 17 - 8 3 18 20 4 -
5 11 28 11 - 6 28 9 28 11 - 30 10 21 30 10 - 10 - 13 3 18- 30 10 - 17 3 - 21 20 - 24 13 10 30 - 18 11 - 5 20 30 20 24 11.
23 26 17 4 26 18 3 - 13 10 21 11 23 28 3 8 3 28 - 28 11-
17 14 10 18 28 11 24 10 - 28 11 - 17 23 8 3 5 26 28 -
16 23 10 18 13 17- UÇK.

Para se të lindte dielli, mori Timin dhe u nisë në drejtim të panjohur. Ndoshta shkoi për të vizituar varrin e nënë Hanës që kishte dhënë shpirt si refugjate në një fshat të Shkupit. Ndoshta shkoi në drejtim të burgut të Dubravës të takohej me Sokolin e vrarë në këtë burg. Ndoshta u nis në drejtim të Muzeut të tij, ndoshta…

Në rrugë e sipër aeroplanët e NATO-s dhe këmbësoria e saj po futeshin në Kosovë.

Arkeologu diçka shkroi në Ditarin e tij.

Kthimi

Kishte kohë që njerëzit kishin ëndërruar një kthim të tillë. Ktheheshin burra, gra, fëmijë,…Kthehej gëzimi i humbur, gëzimi i shtypur dhe i nëpërkëmbur nga pushtuesi. Nuk kishte njeri që posa futej në tokën e Kosovës e të mos e kujtonte momentin e daljes dhembshëm nga atdheu, momentin kur secilit i dukej se prapa po linte një pjesë të shpirtit, një pjesë të qenies së tij.

Shumë sosh u futën me trupat e NATO-s, që tanimë ishin futur në hapësirën tokësore të Kosovës. S`kishe si të përshkruaje gëzimin kur njerëzit takoheshin me luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me emblemën e saj të lavdisë, të cilët me luftën e saj titanike kishte thyer mitin e të pamundurës. Një gëzim të tillë, atë ditë, e kishte edhe Dafina e cila me sytë e saj të vegjël dukej sikur përpinte mallin e atdheut, mallin e shkollës, abetares, mallin e lojërave buzë Kroit të Katundit.

Qyteza kishte ndryshuar me shpejtësi. Rrugët e saja dukeshin më të ngushta. Qentë e ngordhur, kuajt e vrarë që nga koha kur njerëzit dëboheshin nga atdheu, bari i rritur skajeve të rrugëve dhe natyra krejtësisht e vdekur e Qytezës, ishte peisazhi më morbit që parakalonte para syve dhe mendjeve të refugjatëve që po ktheheshin .

,, Pa njeriun, edhe tokat më pjellore bëhen shkretëtira'', u dëgjua zëri i një plaku, rrudhat e të cilit flisnin mjaft për vitet e kaluara dhe sapo takoi ushtarin e UÇK-së, që njerëzve u uronte mirëseardhje, e përqafoi me tërë fuqinë që kishte.

Atë vit kishte marrë një verë e thatë. Retë ishin shpërndarë qiellit sikur të kishin ende frikën e bashkimit. Arat e mbetura djerrina dukeshin të braktisura sa të mbushej mendja se kurrë s`do të bëheshin toka buke. Fushat ishin

mbushur lopë të dagëtisura të cilat sapo dëgjonin ndonjë zë njeriu, trembeshin dhe me shpejtësi futeshin në përrua i cili kishte kohë që kishte ndalur rrjedhën. Thatësira dhe etja kishin mbërthyer gjithçka.
Një etje të tillë e kishte edhe Arkeologu, por etja e tij nuk i ngjasonte etjes së ujit. Në gjoksin e tij ndizej diç më e etshme, diç më e përflakshme.
Kalonte nga një kodër në kodrën tjetër nga një luginë në luginën tjetër, nga një istikam serb në istikamin tjetër dhe kudo gjente gjurmët e krimit, gjurmët e dhunës dhe dhunimit të femrave shqiptare që mizori i kishte ndarë nga kolonat në Grykë të Kaçanikut. Rreth bunkerëve të krimeve, Arkeologu gjeti rrobe të jashtme dhe të brendshme të femrave të reja dhe pasi i mblodhi i varrosi në një vend të veçantë.
Vaji i një fëmije, në një shtëpi që ende si dukej tymi nga oxhaku, bëri që Arkeologu të largohej nga vendi ku ishte ulur më parë dhe u nisë në drejtim të piskëllimave. Nëna mundohej ta qetësonte, por ai nuk ndalej, Kërkonte babanë e tij të cilit i kishin humbur gjurmët që nga momenti kur e kishin marrë serbët.
Një shpërthim i fuqishëm i një mine që u dëgjua në luginë, Arkeologun e stepi në vend. Edhe pse ishte nisur në drejtim të fëmisë, shpërthimi i minës e bëri që të ndryshoj drejtimin. U nis në drejtim të luginës. Një plisbardhë i rrëmbyer nga malli, kthehej në vatër. Për të përqafuar sa më shpejtë pragun e shtëpisë, kishte hyrë një rrugice të shkurtër, por mina e kishte pritur në befasi, sikur bisha që pret gjahun e saj.

Dosja

Kishte kohë që Arkeologu nuk kishte vizituar kryeqytetin. Puna nëpër fshatra sikur e kishte ndarë nga ai, andaj me një nostalgji të veçantë ecte trotuarit dhe kujtonte ditët e bukura të tetorit të largët. S`kishte si t`mos i kujtoheshin ato ditë, kur si student i historisë shkeli në dyert e fakultetit dhe s`kishin si t`mos i kujtoheshin çastet e këndshme kur profesorët ligjëronin historinë e popullit shqiptarë në amfiteatër. Ende i kishte të freskëta mësimet e profesorit me syze i cili historinë shqiptare e shpjegonte me ndjenja ashtu siç ishte i ndjeshëm vet fati i shqiptarit. Kaloi mes për mes qytetit i cili gumëzhinte nga njerëzit dhe fëmijët që luanin rreth ndërtesave e shtëpive të tyre. U ul në shkallët e teatrit, aty ku ulej shpeshherë dekada më parë dhe përcjellke korzonë që të rinjtë e asaj kohe e kishin shumë në qejf. Nuk la pa kujtuar shokët dhe shoqet e gjeneratës së tij të cilët pjesa dërmuese tretën burgjeve për një copë liri. Vizitoi lagje të tëra të kryeqendrës sikur një kurbetçarë që s`ngopet me mallin e vendlindjes. Ishte edhe në Rrugën e Kasolleve, Rrugën e Llapit, Han të Dilit, Qarshi të Vjetër dhe dikur vonë u kthye sërish në qendër, te përmendorja e dëshmorit Zahir Pajaziti ku ditë më parë ishte ngritur i tëri në bronz.

- Arkeolog, - u dëgjua zëri i një femre dhe me të shpejtë preku supin e tij një dorë e lehtë.

- Ua, Linda! -bërtiti Arkeologu pa kontrolluar zërin e tij dhe e përqafoi me një butësi prindi.

- Ku e ke çantën misterioze Arkeolog? - pyeti si në shaka ajo dhe me tërë dëshirën e saj e luti Arkeologun që të ulej në verandën e hotelit përballë përmendores dhe pasi pinë nga një lëng pemësh, biseduan gjatë e gjatë për shumëçka. Kujtuan momente nga lufta, lindje fëmijësh në male, shokë

të mbetura pa gjymtyrë trupi, madje edhe për mugëtirën politike që po kalonin.
- Do të vish sonte në familjen time? – pyeti Linda.
- Kam planifikuar dikund tjetër, - u përgjigj Arkeologu.
- Patjetër do të vish, babai im do të gëzohet,- sërish e luti Linda.
- Do të vija me qejf, por kam planifikuar të shkoj te një shok i imi.
- Të kuptoj, por megjithatë sonte do të jesh mysafiri i familjes sonë, këmbënguli Linda dhe për ta përforcuar përgjigjen e Arkeologut shtoi: Edhe unë kam një çantë misterioze, madje shumë më misterioze se sa shiringat dhe letrat e shkruara me çirilicë.
Arkeologu nuk e zgjati, pasi e pranoi humbjen e luftës me Lindën. Shkoi mysafir në shtëpinë e saj.
Vërtetë takimi me Lindën kishte qenë i dobishëm. Ajo, fillimisht, siç thuhet, sa për t`u futur në temë, Arkeologut ia tregoi një ngjarje të dhembshme që kishte ndodhur që në kohën e Rankoviqit, përkatësisht të aksionit famëkeq të armëve ku fëmijët këmbëzbathur e të larë në lot, ndiqnin pas baballarët e tyre të cilët UDB-a po i qonte në shkollën e katundit për t`i shkallmuar në dru. Kur një grua nga rrethina e Ferizajt, përkatësisht nga fshati Komogllavë s`mundi më t`i duroj torturat e pamëshirshme që UDB-a bënte mbi burrin e saj, ajo luajti nga mendja dhe vdiq në spitalin e Shkupit. Krahas kësaj ngjarje, ajo Arkeologut i tregoi edhe shumë ndodhi të tjera ku secila ishte më e rëndë se e para dhe para se të ndahej me atë, Linda ia dha Arkeologut një grumbull të madh shënimesh të cilat siç tha ajo, i kishte mbledhur gjatë dhe pas luftës.
Pasi arriti në shtëpinë e tij, Arkeologu filloi t`i lexoj me padurim një nga një dhe pas leximit të parë, dalloi disa:

E para ishte e shkruar me çirilicë ku një informator i raportonte qendrës se,, detyra e dhënë për instalimin e përgjuesve në zyrën e caktuar shkonte mirë dhe të pranishmit janë në kurth të thellë dhe se raportin përfundimtar do ta japim atëherë kur të rrumbullakohet qëllimi''.
Informata e dytë kishte të bënte me instalimin e një mini-kamere në lokalin ,,X'', ndërsa e treta të cilën e kishin koduar me emrin ,,Stashinski'' fliste për mënyrën se si duhej të kryer detyra e caktuar ku vrasësin e kishin përgatitur me një armë speciale që peshonte lehtë, ndërsa ,,predhat'' e saj ishin ampula helmuese dhe kishin arritur që atentatorin ta fusnin në pikën e dëshiruar, por siç thonin ,,për habi , ai kishte kaluar në anën e terroristëve''.
Në një informatë tjetër përmendej emri i një personi të cilin e kishin paraqitur si delikat, por edhe rreth këtij thuhej se ,,puna po shkon mirë dhe kurthi do të jetë i pashmangshëm''.
Raporti tjetër fliste për situatën e përgjithshme në një zonë të caktuar ku thuhej se e kontrollojmë nga brenda dhe jashtë saj. Vërejti edhe një material tjetër me më shumë faqe i titulluar Bashkëpunëtori ,,Kobra". Lexoi edhe materiale se si pushtuesi, fshehurazi kishte rekrutuar polic lokal, fatkeqësisht shqiptarë, të cilët kishin shitur shpirtin në dëm të popullit dhe fëmijëve të tyre, ndërsa në një material tjetër lexoi për shumën e parave që kishin marrë në kundërvlerë të turpit.
Një informator tjetër raportonte për suksesin e partisë së pushtuesit që po shtrihej e sidomos shkruante për numrin e prostitutave në rritje dhe që gjithnjë e më shumë po i afroheshin shërbimit të tyre.

Në një raport tjetër shkruante se si forca të specializuara serbe, me uniforma të UÇK-së, me qëllim që të krijonin një konfuzitet brenda shqiptarë, vepronin në prapavijë të forcave çlirimtare dhe në një rast kishin depërtuar edhe brenda territorit të Shqipërisë për qëllime diversive.
Në një material tjetër shkruhej gjer e gjatë për armatosjen e shqiptarëve lojal ndaj pushtuesit, të cilët armë duhej të zbrazeshin në trupat e atdhedashësve, që qëllim kishin lirinë dhe çlirimin e Kosovës. Lexoi edhe shumë materiale se si shërbimi serb kishte përcjellë në çdo hap të burgosurit politik si dhe shumë figura kombëtare, profesor e doktor shkencash, madje edhe shkrimtarin shqiptar në Bullgari, Thoma Kacorin, me të vetmin qëllim, që t`ua ngushtonin frymëmarrjen atdhetare kudo ku shtriheshin shqiptarët.
- E çuditshme, e neveritshme - pëshpëriti Arkeologu dhe mori tufën tjetër të letrave e cila dallonte nga të parat pasiqë ishte shkruar me një shkrim të veçantë prej disa faqeve. Të vetmen fjalë që mundi ta lexoj në këtë shkrim, ishte titulli i saj:

,, DOSIE STAY BEHIND – KO ''.

Crna Ruka

Edhe pse mëngjes, dielli me rrezet e tij përcëlluese paralajmëronte një ditë me vapë të madhe. Kyçi transistorin që t`i dëgjoj emisionin e lajmeve të BBC ku gazetari i saj raportonte nga Kosova për shtëpitë e djegura, familjet që kthehesin me shpejtësi si dhe nevojën e tyre për ushqim e veshmbathje. Padyshim një vend qendror zinin lajmet për personat e zhdukur të cilët nuk ishin të paktë, por me mijëra. Dëgjoi edhe lajmin se si ekipe të tëra patologësh ndërkombëtarë hulumtonin varrezat masive kudo nëpër Kosovë.

- Ndoshta sot do ta zvogëlojmë numrin e të zhdukurve – foli Arkeologu dhe ç'kyçi tranzistorin.

- Siç shihet këtu do të jetë një varr i madh, plotësoi Timi dhe në dorë mbante një lopatë bisht shkurtë.

- Nënat tona presin t`i gjejnë bijtë, - vazhdoi Arkeologu,- dhe derisa nuk u gjenden eshtrat të zhdukurve, nuk mund t`i llogarisim të vrarë. Kohërat më të vjetra kanë dëshmuar se njeriun që e kanë shpallur të vdekur, por pas disa viteve është kthyer shëndosh e mirë në shtëpi, madje me një libër kam mësuar se kur i ,,zhdukuri'' ishte kthyer në shtëpi, nusen e kishte gjetur të martuar për dike tjetër. Andaj do të jemi të lumtur sikur sot të gjenim eshtra sepse edhe në këtë mënyrë do t`i gëzonim nënat. Madje këtë e di unë më mirë se kush do tjetër se sa u gëzova kur gjeta kafkën e babait tim. Vërtetë kafkë, por ishte e babait tim, ishte vet babai im.

- E tani ku gjendet kafka e babait tënd?-pyeti me kureshtje Timi.

- Kafkën e kisha në muzeun shtëpiak. Atë ditë kur shkova të vizitoj familjen dhe kur vërejta se ç`kishin vepruar kriminelët me muzeun, ndjeva dëshpërim të thellë. Kafkën

e babait e kishin vrarë për së dyti dhe për mua kjo ishte vrasja e vërtetë e tim at.
Pasi e ngushëlloi për vdekjen e vërtetë të babait,Timi nuk i shtroi pyetje tjetër pasi në fytyrën e Arkeologut vërejti një dobësim dhe i afroi një gotë ujë. -Të fillojmë nga puna, - tha Timi, sikur deshi ta kaloj rrëfimin e habitshëm të Arkeologut.
-Po, Tim, - u përgjigj Arkeologu, - nënat gëzohen edhe me eshtrat e bijve të tyre, fillojmë!
Meqë varri kishte një hapësirë jo të vogël, punuan tërë ditën. Rreth mbrëmjes filluan të nxjerrin eshtra. Ishin eshtra kafshësh.
-E habitshme! - pëshpëriti Arkeologu si nën dhëmbë, - me këto eshtra dëshirojnë t`i fshehin krimet e vërteta ndaj njerëzve, andaj hulumtimet duhet të mos i ndalim dhe pështyu furishëm në dheun e nxjerr përballë dhe në momentin kur po ndaheshin nga kjo punë e lodhshme, Arkeologu vërejti një pjesë të një fletoreje përkatësisht blloku dhe me shpejtësi zbriti në gropën me eshtra kuajsh për ta marrë trofeun e asaj dite.
- Tim, thirri Arkeologu!- mesa duket po shpaguhet dita jonë sot dhe futi dorën në dhe nga i cili nxori një bllok xhepi i stërmbushur me shënime në gjuhën serbe. Me të pastruar bllokun nga dheu dhe sapo kaloi në faqen e parë të brendshme të tij, Arkeologu lexoi me zë një kryetitull i shkruar me ngjyrë të zezë ,,Crna Ruka'', të cilën fjalë Timi fillimisht nuk e kuptoi.
- E ç`është ky libër?- pyeti Arkeologun, Timi.
- S`është libër Tim, por një bllok shënimesh nga krimet serbe dhe Arkeologu doli nga gropa duke ndezur cigaren dhe u ulë në grumbullin e dheut dhe filloi ta lexonte Ditarin

e një krimineli serb ku siç dukej, nga xhepi i kishte rënë atë ditë kur po i varrosnin kafshët e vrara.

Krahu i „ Voglushit ''

Vetëm kur deshi të shukte cigaren, vërejti se sa shumë duhan kishte pi. U ngrit nga krevati ku qëndronte shtrirë, mori shpuzoren që ta shkundte në shportën e mbeturinave, por një duq i ngjitur sikur nuk dëshironte të përfundonte në vendin e tij. Bora që binte pa ndërprerë, kishte zënë shumë shtigje, por edhe ajo natë kishte të mirat e saj, kishte rrymë elektrike. Ndoshta zyrtarët e KEK-ut kishin mbledhur forcë që qytetarët, Vitin e Ri ta pritnin hareshëm, së paku me dritë.

Linda u kthye sërish në ,,strofullin'' e saj, u mbulua me batanije që të bënte një sy gjumë, që të përgatitej për natën e nesërme të ndërrimit të motmoteve, por ai kishte ikur aq larg saqë as ninullat më të bukura të fëmijërisë nuk e sjellnin në sytë e saj. Pa e kuptuar se si, mendja i iku jashtë mureve të shtëpisë.

Fishkëllima e lokomotivës në stacion, i ra si çekan në kokën e saj. Vagonët mbusheshin me gra, pleq e fëmijë. Demonët e uniformuar i buzëqeshnin njëri tjetrit dhe nuk e fshihnin gëzimin e tyre që po mbeteshin pa fqinjët e tyre shqiptarë. Rrapëllimat e trenit nëpër binarë shponin si thikat zemrat e atyre njerëzve shpirtsfilitur që prapa shpinës linin atdheun e tyre të shtrenjtë e një pjesë e tyre, maleve të atdheut, linin bijtë e tyre që me pushkët krahut kishte kohë që kishin bashkuar stinët. Kur treni u fut në tunel dhe drita për një çast u zhduk, kuptoi se po i afrohej kufirit ku pastaj do t`i bashkëngjitej prindërve që javë më parë kishin shkuar në Shkup.

„ Duhet të zbritni të gjithë dhe rreshtohuni një nga një në platon e stacionit''!
Njerëzit filluan të zbresin me shpejtësi. Platoja u mbush, por edhe rreshti zgjatej. I nënshtroheshin një kontrolli policoro-ushtarak. Nga rreshti, Linda në largësi njohu njërin nga policët që kërkonte dokumentet e identifikimit, por ajo nuk e kishte ditur që ai ka ndërruar vendin e punës edhe pse kishte qenë fqinj me atë. Zemra filloi t`i rrahë shpejtë e më shpejtë për aq sa afrohej i njohuri i Lindës.
,,Më duket a po jeni Linda, fqinja ime''? -pyeti polici serb dhe sytë e tij përbindësh përshkruan trupin e saj nga koka te këmbët.
,,Po, Linda jam, u përgjigj ajo e cila nuk mundi ta ndrydhë ngatërrimin e zërit''.
,,Për ku jeni nisur''?
,,Për në Shkup, te prindërit''.
,,Deri tani vetëm keni qëndruar në shtëpi''?
,,Po , u përgjigj ajo''.
,,Duhet të qëndrosh ende''! - urdhëroi kërcënueshëm polici dhe Lindën e ndau nga kolona dhe e futi në automobilin policor. I futi në kokë, një thes të zi dhe u nis, për Lindën, në drejtim të panjohur.

Disa të trokitura në derë e zgjuan Lindën nga kllapia e mendimeve ku kishte rënë. Për një çast trupi iu mbulua mornica. Kush vallë mund të jetë në këtë natë të vonë? Mos vallë ata?
Të trokiturat u dëgjuan sërish, por kësaj radhe të shoqëruara edhe me zë:
- Lindë, oj Lindë, jam unë, Arkeologu.
Posa dëgjoi zërin e tij, me të shpejtë hapi derën dhe iu hodh në qafë sikur fëmija kur i hidhet babait kur vjen nga burgu.

- Urdhëroni dhe mirë se vjen Arkeolog!- uroi me gjithë shpirt Linda dhe pasi i ndihmoi të shkundte borën nga koka dhe supet e drejtoi në dhomën e saj.
- Ku i ke prindërit? - pyeti Arkeologu.
- Kanë shkuar te daja në fshat - u përgjigj ajo dhe vazhdoi - siç po bie borë sonte, nuk besoj se do të kthehen as nesër mbrëma. Kur u nisën të shkojnë më lutën t`i shoqëroja, por më dëshirë kisha të rrija vetëm.
- Atëherë të paskam prishur planin, ndërhyri Arkeologu.
- Jo, kurrsesi, jo. Ka kohë që s`të kam parë, madje kjo është një befasi e këndshme dhe u ngrit për të pjekur kafetë.
- Po nga vjen në këtë natë të vonë?- pyeti Linda.
- Nga spitali, -u përgjigj Arkeologu.
- Si nga spitali?!
- Ka gjashtë muaj që qëndroj atje.
- Pse?!
- As vetë nuk e di. Mjekët thonë se vuaj nga një sëmundje e paidentifikueshme…Për disa ditë kam qëndruar edhe në spitalin ushtarak të KFOR-it, por…
- Po si reflektohet sëmundja juaj?- pyeti me plot kureshtje Linda.
- Në fakt, unë nuk e di që kam ndonjë sëmundje së paku siç thonë mjekët. Ju e dini që unë merrem me hulumtimin e trashëgimisë sonë kulturore e nga pas lufta, jam marrë me zbulimin e eshtrave të shqiptarëve të zhdukur. Kam hulumtuar në vende të ndryshme, por së fundi isha në Grykë të Llapushnikut pasi kisha dëgjuar nga shokët se kur nga serbët u vra Komandant Vogëlushi, një pjesë e trupit të tij, më konkretisht krahu, mbet i pazbuluar. Përkundër, që shokët e tij kërkuan krahun e humbur gjithandej, atë nuk mundën ta gjejnë, e të varroset njeriu në varr pa gjymtyrët e tij trupore është keq, andaj shkova të kërkoj krahun. Sajova

një plan prej dhjetë rrathësh nga pika e rënies së dëshmorit, por nuk pata sukses përkundër përpjekjes që bëra. Në çastet e fundit mendova t`i shtoj edhe dy rrathë të tjerë. Në të dymbëdhjetin, arrita suksesin. Krahu i tij i shkëputur nga trupi kishte fluturuar shumë larg nga pika e rënies. E gjeta në maje të një lisi. Ishte shtrirë në dy degët e tij sikur shpata e Skënderbeut.
U ngjita dhe e mora. Përkundër që kishin kaluar vite e stinë nga vrasja e tij me ,,kaqushë'' krahu kishte mbetur po ai që kishte qenë sikur të ishte ndarë para pak çasteve nga trupi. Dhe derisa e rrotulloja me duart e mia, papritmas krahu i dëshmorit u kthye nga unë dhe tha:
,,Ku dëshiron të më dërgosh o njeri i mirë''?
,,Në varrin e trupit tënd''- iu përgjigja i trishtuar.
,,Mos u frikëso!-më dha kurajo ai,- por në varr nuk shkoj dot. Jo pse nuk dua të takoj trupin tim, se i tij jam, por dua të qëndroj maleve të atdheut. Madje, këtë qëndrim e kemi marrë të gjithë Gjymtyrët e Shkëputura të Trupit në një Kuvend që e mbajtëm ku edhe trajtuam gjerë e gjatë fatin tonë.'' Dhe derisa po i dëgjoja ato që mi thoshte, krahu i Vogëlushit, fluturoi si zog nga duart e mia dhe vetëm nga një dritë e vezulluar që e lëshoi prapa, kuptova se ia mësyni kaltërsive të qiellit. Këtë ngjarje, Lindë e dashur, ua tregova edhe njerëzve të tjerë. Ata jo vetëm që s`më besuan, por më shpallën të çmendur. Mjekët shkuan edhe më larg. Me një udhëzim urgjent mjekësor më përplasën në spitalin e kryeqytetit dhe ja, sonte pas gjashtë muajve, ika.
Linda kishte zgurdulluar sytë dhe e shikonte e habitur Arkeologun derisa në kokën e saj vraponin analizat për të zbuluar atë që shtjellonte ai dhe veprimin e mjekëve.
- Për këtë të shtrinë në spital? - pyet ajo vetëm sa për të thënë diçka.

- Vetëm për këtë, - u përgjigj plot siguri Arkeologu.
Bisedën me Lindën, Arkeologu e vazhdoi deri në agun e mëngjesit, ku ajo para atij, rrëfeu tërë ngjarjen e saj që i kishte ndodhur gjatë luftës prej momentit kur policët e kidnapuan në kufi në Han të Elezit dhe me thes në kokë e futën në një shtëpi të zbrazur shqiptare në afërsi të kryeqytetit.
Rrëfeu në tërësi qëndrimin e saj me majorin serb deri në përfundim të luftës. Shpjegoi edhe për impotencën e majorit dhe përpjekjet e tij që të shërohej me një vajzë shqiptare, ashtu siç ishte këshilluar nga psikologu i ushtrisë së tij. Në imtësi rrëfeu para Arkeologut, takimin me forcat armike ,,Stay Behind" që ia afroi majori dhe plani i atyre forcave që në Kosovë do të vepronin edhe pas tërheqjes së ushtrisë serbe. Shpjegoi edhe për mënyrën dhe rrethanat e pranimit të detyrës së papranueshme nga ana e sajë. Sqaroi edhe mënyrën e ikjes së saj nga kthetrat e tyre. Përmendi me mjaftë shqetësim edhe kërcënimet e padukshme të forcave ,,Stay Behind'' që ia bënin Lindës si dhe frikën për kidnapimin dhe dërgimin e saj dhunshëm në Serbi si dhe ngjarje tjera të rrënqethshme.

Njerëzit, që nga mëngjesi i asaj dite, filluan të përgatiteshin për përcjelljen e ditës së fundvitit. Lëvizjet e tyre nëpër borë në trotuaret e qytetit dhe buzëqeshjet e tyre, sikur dëshironin që hareshëm t`ia linin lamtumirën vitit që po kalonte. Babadimri me thesin mbi shpinë, kërkonte fëmijët për t`u shpërndarë dhurata. Arkeologu ecte pas tij mendueshëm dhe në vetveten e tij diçka pëshpëriste.
U nis në drejtim të Krushës, ndoshta për t`u takuar me profesor Ukshin Hotin, i zhdukur që nga 16 maji i vitit 1999 nga Burgu i Dubravës.

Nga ballkoni i një ndërtese, me një zë jo të vogël magnetofonik, dëgjohej kënga:

Kush ia kallin shpirtin barbarit,
I Prekazit Adem Jashari.
I Prekazit Adem shqiptari,
Me vëlla Hamzën e babë Shabanin...

Gryka

Gryka nëpër barkun e saj kishte nxjerrë mijëra njerëz shpirtsfilitur. Kush mund të dijë se sa e sa njerëz u ndanë nga familjet e tyre pikërisht në Grykë dhe për shumicën e tyre nuk dihet gjë sot e asaj dite. Kufomat e gjetura në lumin Lypenë dëshmojnë një gjë të tillë. Ndërresat e brendshme të femrave dhe gjaku virgjëror i tyre ishin gjurmët e vetme të femrave të zhdukura. Këto i vërejti edhe vet Arkeologu derisa kalonte nga një shtëpi në tjetrën në Lagjen afër Lumit. Edhe ato shtëpi që kishin mbetur të padjegura, muret e tyre ishin bërë të neveritshëm nga shkarravinat e kriminelëve.

- Flasin mjaft këto që po i sheh,- tha Arkeologu derisa kalonte nga njëra dhomë në tjetrën.
- Çdo kund të mbërthejnë kryqet,-plotësoi Timi.
- Ashtu është,-pohoi Arkeologu – serbët tërë politikën e tyre shtypëse e kanë mbështetur mbi kryq dhe kishat tona i sllavizuan, ndoshta edhe me fajin tonë.
- Pse të jetë faji ynë? - ndërhyri Timi.
- Populli ynë ka një histori të lashtë, Shpëtim. Kur Ilirinë e pushtuan romakët, krahas pushtimit përhapën edhe fenë, por kur Perandoria romake u zgjerua aq shumë saqë s`mundte ta barte vetveten, ajo u nda në Perandori të Lindjes dhe të Perëndimit. Pjesa më e madhe e trojeve tona

mbetën me Perandorinë e Lindjes gjegjësisht të Bizantit dhe kufiri ndërmjet këtyre dy Perandorive, fatkeqësisht përshkoi trupin tonë Arbëror. Ndërsa nga viti 1054, kur krishterimi u nda në dy fe, për shqiptarët kurrë nuk u ndal dhuna, kurtha dhe projektet shfarosëse. Shqiptarët që i mbuloi feja e Perandorisë së Lindjes, detyroheshin në forma nga më të ndryshme që t`i nënshtroheshin inkuizicionit konvertues ortodoks. Ky konvertim ishte masiv që para mbretit Millutin e deri te Car Dushani dhe ishte tejet i rëndë për qenien iliro – arbërore sepse nëpërmjet fesë, një pjesë e madhe e tyre u serbizuan dhe në vazhdim foli gjerë e gjatë për,,arnautët serb" siç u thoshte turku, për të cilit Timi dëgjonte për herë të parë. Arkeologu, në vazhdim, foli për pjesën e fundit të qenies sonë para se të ortodoksohej e një pjesë edhe të sllavizohej, duke e përmendur edhe një dokument të vjetër të vitit 1467-1468, dhe nga ky Defter osman, veçoi disa emra që kishin të bënin me trevën tonë, si: Bogdani i biri i Gjonit, Prodoni i Çerepit, Nikolla i biri i Micit, Dhimitri i biri i Milmanit, Miloshi i biri i Gjurashit, Gjon Arnauti, Bogdani i biri i Nikollës, Martini i biri i Cilashit, , Bogdani i biri i Gjonit, Nikolla i biri i Vasilit,Tanushi i biri i Kovaçit, Petku i biri i Gjergjit, Stanisha i biri i Gjinit, Stepani i biri i Martinit, Stepani i biri i Miles, Mile i biri i Gjinit, Stanishi i biri i Gjonit, Gjura i Radoshit, Gjurkë Arbanasi, Bogdani i Dhimitrit e emra të tjerë, të cilët në fakt janë reliktet e fundit katolike këtyre anëve. Pas ardhjes së osmanëve, dhe nën ndikimin e fuqishëm të kësaj perandorie, vazhdoi Arkeologu, shqiptarët e pranojnë edhe një fe tjetër, pranojnë islamin, kështu që brumi ynë kombëtar, në rrethana të caktuara shoqërore e historike u nda në tri fe; në atë katolike, ortodokse e myslimane. Faji ynë mbeti se pse nuk i ruajtëm

kishat që ishin tonat, pavarësisht nga kalimi në fenë tjetër. Kishat e braktisura i përvetësuan serbët dhe nëpërmjet tyre ata dëshirojnë edhe sot të im-ponojnë lashtësinë dhe si të çmendur, edhe sot, Kosovën e quajnë „ djep i tyre" e të ngjashme.

Përkundër pushtimit romak të Ilirisë, vazhdoi Arkeologu, ilirët nuk u romanizuan. Në IIlyricum Sacrum, ata pranuan krishterimin, por nuk u asimiluan. Por kështu nuk ndodhi me kishën artodokse. Ata me dhunë konvertuan pjesë jo të vogla të popullatës iliro-shqiptare, madje me grykën e pushkës dhe me tehun e bajonetës dhe Timit ia tregoi historinë e dhembshme të Atë Luigj Palajt, të cilin serbo-malazezët e copëtuan me bajoneta për të pranuar konvertimin me dhunë, nga një prift katolik që ishte Luigji, në ortodoks, përkatësisht në serb, sepse kisha serbe nuk pranonte brenda saj përkatësi tjetër kombëtare. Kjo ngjarje ka ndodhur në vitin 1913 dhe është e vonshme, por si kanë ndodhur konvertimet e dhunshme në dekadat dhe shekujt e mëparshëm, është e tmerrshme ta themi. Ndoshta, sot, luftojmë me një pjesë të gjakut tonë të asimiluar Tim, pështpëriti nëpër dhëmbë Arkeologu, dhe për të shpëtuar nga ky asimilim ortodoks, në rrethana të caktuara politiko-shoqërore, shqiptarët pranuan islamin, por jo asimilimin, andaj gjyshërit tanë, përkundër sundimit pesë shekullor otoman, nuk kanë ditur të flasin turqishten. Në anën tjetër, të gjithë ata shqiptarë ortodoks që nuk pranuan asimilimin kombëtarë dhe nuk hoqën dorë nga rrënja e tyre iliro-shqiptare, u vranë ose u helmuan nga serbo-grekët si Pandeli Sotiri, Petro Nini Luarasi, Papa Kristo Negovani, Dhaskal Todri, Veqilharxhi e shumë të tjerë duke e ilustruar edhe me fakte të tjera fatkeqësinë kombëtare të shqiptarëve

ortodoks të Rekës së Josip Bagerit, tanimë të asimiluar në sllavomaqedon.
Ndjekjet dhe planet shfarosëse ndaj nesh, s`kanë përfunduar kurrë, tha Arkeologu. Njihet ,, Neçartania" e Ilia Garashaninit e vitit 1844, plani shfarosës i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit i vitit 1877, pastaj projektet tjera si ai i Andriqit, Çubrilloviqit e i Rankoviqit për të vazhduar te kasapi Millosheviq. Nëpër këto projekte antishqiptare po zhdukej qenia dhe kultura shqiptare. Është fat i madh i yni, që kjo luftë e zhvilluar nga UÇK, kishte përkrahjen e botës euro-amerikane, andaj edhe politikat tona të strategjisë kombëtare, sot e më tej, duhet t`i fokusojmë në drejtim të bashkëpunimit më të madh në të gjitha fushat me botën euro-amerikane, veçmas me gjermanët dhe anglo-amerikanët, përndryshe kombit shqiptar, kurrë nga shpina s`kanë për t`iu larguar projektet shfarosëse sllavo-greko. Mbaje mend Tim, kurdoherë që brenda kombit shqiptar, paraqiten mosmarrëveshje të mëdha, e që populli u thotë ,,hashërneshë'' mosmarrëveshjet e tilla janë produkt i konspiracionit sllavo-grek. Kurdoherë që krijohet mosdurim ndërfetarë brenda nesh, dora tinëzare e sllavëve qëndron. Kurdoherë që vijnë të papriturat politike, e që populli u thotë ,, pa pritë e pa kujtue'' dije që mbrapa tyre qëndrojnë këta. Kurdoherë që ekonomikisht përjetojmë kolapsin ekonomik e si rrjedhojë, varfëria dhe zhgënjimi mbulon shtresat e gjëra popullore, në themel qëndrojnë projektet sabotatore sllavo-greke. Kurdo që ndodh anarkia, e që populli i thotë ,,qeni nuk e njeh të zotin'', planet sllavo-greke qëndrojnë prapa tyre. Kurdoherë që kombi mbetet pa trurin kombëtar, përkatësisht pa elitën e tij akademiko-shkencore, mbaje mend Tim se projektet armike thellë kanë depërtuar në trungun tonë.

- E si t`i luftojmë këto projekte?- pyeti përplotë kurreshtje Timi?
- Të veprojmë në anën e kundërt të tyre!- u përgjigj Arkeologu.
- Këtu paska edhe gazeta, - ndërhyri Timi.
- Mi afro! - tha Arkeologu dhe filloi t`i shfletoj faqe për faqe.
E para ishte një revistë fetare e Kishës Ortodokse Serbe, në të cilën shkruhej për gjendjen dhe rolin e kishës në paqe e në luftë, shkruante për bekimin që prijësi i tyre, iu jepte ushtarëve serb për djegien, pjekjen dhe zhdukjen e shqiptarëve. Gazetat tjera ishin disa ekzemplar të revistës ushtarake serbe, ku në ato shkruhej për luftën që ata e bënin. Kur e mori të dytën, në mes të revistës gjeti të shkruar një fletë me shifra ushtarake. - Ja Tim, vazhdoi Arkeologu, - kjo është tabelë shifrore, numrat e së cilës i kanë përdorur në luftë me ne dhe filloi t`i lexonte dhe njëkohësisht i përkthente në gjuhën shqipe një pjesë të tyre:
,,Fillim sulmi'' , shifra 715
,,Kam të lënduar'', shifra 901
,,Kam të vrarë'' ,shifra 900
,,Aeroplanët veprojnë'',shifra 852
,,Kam nevojë për municion'' ,shifra 77O,…
Dolën nga shtëpitë e Lagjes së Lumit pak para se të perëndonte dielli. Planifikuan të flinin nën tendë afër Gështenjës, pasiqë për të nesërmen do ta hapnin një gropë e cila dyshohej për një varrezë masive. Para se të hanë darkën, hapën një gropë dhe ,, varrosën'' të brendshmet e një vajze shqiptare që i gjetën në një shtëpi.
Disa të lehura qenësh disi rikthenin jetën dhe sikur ia bënin me dije dhelprës për rrezikun që e pret në rast sulmi në kotec, por e vërteta ishte se s`kishte as gjel e as pulë. Jeta fillonte për shumë gjëra nga e para.

Gurgdhendësi i historisë

Shetitë në gryka e male i kishte në qejf. Në bllokun e shënimeve ditore që mbante, shkruante për bukuritë e vendit ku jetonte. Jo rrallë shkruante edhe poezi. Sa të lashtë që janë këto shkëmbinj që shoh, ku ta dimë sa breza kanë parakaluar para ,,syve'' të tyre?! Ah, sikur në këto gurë e rrasa, t`i kishin gdhendur ngjarje që kanë ndodhur, do të kishim një histori e cila do të barte vet kohën.

Mendja i shkrepi të përmirësonte gabimin e të parëve të tij. Ditën tjetër mori vegla puna: një daltë, një kaçavidë, një çekan dhe një vegël tjetër që e farkoi enkas te farkatari. Në majën më të lartë të kodrës, në sipërfaqen e një guri të madh, gdhendi emrin Pal, nga buronte emri i fshatit të tij. E gdhendi thellë duke kaluar orë të tëra në gdhendje, pasiqë guri ishte i fortë dhe nuk gdhendej lehtë. Disa ditë më vonë, në luginën e fshatit, mbi një sipërfaqe më të madhe guri, duke u mbështetur në një hartë ilirike të shekullit IV të erës sonë, skaliti disa emra të qyteteve të Ilirikut si: Skodra, Dyrrah, Aulona, Skupi e Ulpiana. Kjo gdhendje ia mori një javë ditë. Një ditë tjetër gdhendi tri fjalë: Libri, Buka, Pushka të cilat ishin sinonime të arsimimit, zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes, sepse e dinte se pa këto tri shtylla, nuk bëhet shteti.

Para se të gdhendte gurin e radhës, fillimisht vizitonte punën që kishte bërë nëpër gurë ditëve paraprake dhe sikur bisedonte me brezat që do të vijnë shekujve më pas. Historinë shqiptare e njihte mirë, por edhe simbolikat ilirodardane, gjithashtu. Një ditë tjetër gdhendi spiralen koncentrike siç quhej nga arkeologët, apo spiralen e jetës siç e quanin ndryshe. Atë e gdhendi në disa gurë. Mbi sipërfaqen e një guri, shkroi emrin ARB, ndërsa mbi një guri tjetër që kishte formën si të plisit, gdhendi diellin, gjarprin

dhe hardhinë e rrushit për të cilët dinte se ishin simbolika të vjetra ilire. Mbi një sipërfaqe të përshtatshme guri, gdhendi emrin e priftit dardan të shekullit IV: Dakus Dardania, kurse mbi një tjetër gdhendi plisin me diell e hënë të Lekës së Madh, por nuk harroi të gdhend as përkrenaren ilire.
Nga gdhendja dhe të rënat e shpeshta me çekan, ndjente lodhje të krahut. Pasi fshiu djersët e ballit, nga xhepi nxori pakon e cigareve dhe e ndezi një. Tymnaja që sillej rreth e rrotull e bënë që të futej edhe më thellë në mendime. Mendja i iku në qelinë numër 4 të burgut të Prishtinës, në vitet e 80-ta, ku për pesë vite me radhë, kishte ndërprerë pirjen e tij. ,,Po ç`mu deshtë që ta ngjes përsëri këtë shkretësh?" -pyeti me ,,gjuhën'' e mendjes. Vitet e rënda të 90-tës sikur donin t`ia arsyetonin gabimin. Seç ju kujtua letra e printuar nga kompjuteri natën e mbrëmshme dhe tregimi i një shkrimtari me titull ,,Miku im shkollë''. Me të shpejtë e nxori nga xhepi dhe filloi ta rilexonte:

"Nëse ke bisht, ta heqin; nëse nuk ke bisht, ta vënë, thotë një fjalë e urtë popullore", rinisi bisedën miku im i tavolinës pas një picërimi sysh paksa të gjatë, duke e rrotulluar shikimin te një njeri, si të ishte akrepi i busollës.

"E...?", shpreha kërshërinë time.

"E sheh atë njeri?"

"Po, e shoh dhe e njoh, mik e kam", u shpreha pa hezitim.

"Është tejet interesant. Nuk ndalet, vetëm punon", rrëfeu për personazhin që e soditëm. "Është mësues, shkruan poezi, ka qenë i burgosur dhe përpak të vritej".

"E di", iu përgjigja shkurt. "Ke tjetër të thuash për të?"

"Jo, jo, vetëm fola, pa qëllim përgojimi", sikur shprehu pendimin që foli këto fjalë shoku i tavolinës.

"Ja, unë po të rrëfej tani për të. Dëshiron...?"

"Bëje, pra".

"Është njeri interesant, punëdashës dhe frytdhënës i pandalshëm. I ka kaluar të pesëdhjetat dhe ka energji si të ishte njëzetepesëvjeçar. Ka shkruar disa libra me tema interesante", nisa të rrëfej për të. "Vërtet nuk ka kulturë të madhe letrare, por ka dëshirë të madhe të gjurmojë dhe të sheshojë të vërtetën, e bën me gëzim fëmijëror kur bën një punë të këtillë. Është shembull se si duhet të mos ndalet njeriu kurrë, të bëjë ndonjë punë, qoftë edhe me lëshime të vogla përballë të mirave shumë më të mëdha. Ai bën luftë me kohën, do ta mposhtë atë dhe e bën, duke e shfrytëzuar çdo ditë e orë për të mirën e të vërtetën. Është shembull i të rinjve të sotëm se si me durim e pa zmbrapsje, me përkushtim të paepur duhet të ndihmohet populli e atdheu, e jo vetëm me politikë e demagogji. Miku ynë shërben si shembull i edukatës dhe arsimimit atdhetar, është shkollë në vete për të rinjtë", shpreha përshtypjen për personazhin e kësaj "përfoljeje".

"Dhe, përsëri e ironizojnë!"

"Po, e vërtetë është. Këtë e bëjnë ata që tërë ditën rrinë në hi e shkruajnë zi, pa bërë as edhe një punë si ai, si thotë populli. Sepse, puna e tij ua çjerr demagogjinë politikaneske te populli, pa e thënë as edhe një fjalë për ta. Por, njeriu i vendosur si miku ynë, nuk merret me ta, është humbje kohe ky ves. Janë përgojuesit e shpifësit që kanë vepruar njësoj edhe në regjimet e kaluara ndaj tij dhe punëdashësve e atdhetarëve të tjerë, ligësi që e kanë trashëguar deri më sot dhe kësisoj i kanë edukuar disa ithtarë të tyre", erdhëm në fund të bashkëbisedës, duke u ngritur nga trysnia e një ere të mprehtë të Grykës, e cila e "vizitoi" edhe kafenenë ku ishim, duke mos harruar se vënësit e heqësit e bishtave këtë shprehi e kishin mision jetësor.

Tregimin e lexoi deri në fund, pavarësisht se e kishte lexuar edhe natën e kaluar. Disi i përngjante jetës dhe personalitetit të tij. E kishin përbuzur në çdo kohë, por nuk ndalej me përbuzjen që ia bënin. Poshtrime e përpuzje nga më të ndryshme i përjetonte edhe sot. Nuk dinë, duhet t`i falë, thoshte me vetëveten e tij. Kështu ka thënë edhe Jezu Krishti.

Shqiptarët qe 2000 vjet janë rritur nëpër duar të huaja. Pushtuesit nuk kanë lënë që ata të rriten në natyrshmërinë e vet, andaj... Ne duhet ta rindërtojmë shqiptarin e bashkë me atë edhe Shqipërinë. Ne duhet t`u kthehemi rrënjëve tona; besës, nderit, mikpritjes, dashurisë ndaj vetvetes sonë. Po, po përfundimisht shqiptarët duhet t`i kthehen vetvetes së tyre.

Palosi letrën dhe sërish e futi në xhep. Kishte vendosur ta arkivonte brenda Dokumenteve Arkivore në bibliotekën e tij.

Në një gurë tjetër shkroi: 1878-LIDHJA, e afër tij UÇK, ndërsa një ditë tjetër, gdhendi me shumë vështirësi dorën e mbledhur grusht dhe me grushtin e gdhendur sikur donte t`i binte malit..., siç kishte shkruar Migjeni, dikur. Në një gur tjetër, gdhendi vitin 1981, të cilin kaherë që e kujtonte e ringjallte si feniksi…

Fushat, malet, luginat dhe kodrinat e vendit ku jetonte Gurgdhendësi, tanimë i ngjasonin një muzeu natyror, i ngjasonin një historie e gdhendur në gurë.

Në përvjetorin e 100-të të një masakre

Në 28 tetorin të atij viti, bëheshin rrafsh 100 vite kur orditë serbe të ardhura nga Serbia, ia vunë kujën fshatit, për t`mos u harruar edhe për 100 vite më pas. Serbët me bajonetat e tyre therrën si berra, kryefamiljarët e fshatit D.

Në shenjë përkujtimi e nderimi, 100 vite më vonë, ishin mbledhur pinjollët e tyre, farefisi dhe pothuajse i gjithë rrethi për t`ua bërë së paku një nderim eshtrave të bashkëfshatarëve të tyre, që u vranë mizorisht në tetorin e vitit 1912, një muaj para se në Vlonë të valonte i lirë flamuri.

Ishte hera e parë që po shënohej kjo datë, andaj organizatori i këtij manifestimi, në agjendën e tij, kishte paraparë që publicisti F. para të pranishmëve të shumë të, të mbante fjalën kryesore.

Pasi vendosi syzet dhe pasi u hodhi një vështrim përshëndetës të pranishmëve dhe njëkohësisht maleve për rreth tij, publicisti F. , tha:

Për këtë ngjarje kriminale që ndodhi në tetorin e vitit 1912, ne e dimë dhe e kemi në kujtesën tonë edhe nga më të vjetrit tanë bashkëvendës, por kësaj radhe do të shpalosim para jush se çka shkruanin gazetat e para e një shekullit për këto ngjarje dhe vazhdoi:

Gazeta ,, Daily Telegraph'' e Londrës në dhjetorin e vitit 1912 shkruan: Historia nuk njeh persekutime më të fëlliqura se sa ato të trupave të Gjeneral Jankoviqit. Gjithçka ishte shndërruar në kufoma, hi e pluhur. Kishte fshatra me nga 100-150-200 shtëpi, në të cilat nuk ngeli apsolutisht askush gjallë, askush gjallë... I mblidhnim tubë, 40 deri 50 njerëz, dhe ashtu si ishin, grumbull i thernin të gjithë me thika. Plaçkitja ordinere u bë kudo. Oficerët plaçkitën kope të tëra bagëtish dhe i shitën përmes ushtarëve në Prizren...

Ndërsa një ushtar i quajtur Vuksanoviq për masakrat e kryera, rrëfen si vijon: Shqiptarët në fillim i vritnim me pushkë dhe patllake, por së shpejti erdh urdhëri se nuk kishte levërdi të shpenzohet municioni, prandaj shqiptarët do të therren me thika. Dhe kështu ndaheshin në grupe grupe..., rreshtoheshin në rreshta me fytyra të kthyera kah njëri tjetri dhe atëherë oficerët dhe nënoficerët i thernin shqiptarët një nga një në qafë.

I dërguari i 'Daily Telegraph' në Budapest tregon detaje në lidhje me mizoritë që po ndodhin në Shqipëri dhe përreth, raporte këto të mbledhura për autoritetet e Austro-Hungarisë.

Korrespondenti thotë: Serbët jo vetëm që dinakërisht vranë dhe ekzekutuan shqiptarët e armatosur, por mizoria e tyre nuk u ndal as kur u takuan me njerëz të paarmatosur dhe të pambrojtur, gra e burra, fëmijë dhe foshnja në gji. Oficerët serbë, të dehur me fitoren e tyre, deklaruan se qetësimi më i efektshëm i Shqipërisë është zhdukja totale e shqiptarëve muhamedanë

Gazetari austriak Leo Frojdlih, me origjinë hebreje, autor i librit "Golgotha Shqiptare", i përshkruante masakrat e serbëve në vjeshtën e vitit 1912, deri në pranverën e 1913-s, në trojet shqiptare, Kosovë, Maqedoni me këtë gjuhë:

Me qindra e mijëra kufoma të masakruara notonin në rrjedhat e lumenjve. Ata që mundin t'u shpëtonin sëmundjeve, urisë, plumbave të pushkëve të këmbësorisë dhe gjyleve të artilerisë serbe, grumbulloheshin në vende të caktuara dhe u jepej nga një plumb kokës. Torturat më të mëdha i pësonin gratë shqiptare, të cilët përdhunoheshin, lidheshin, dhe pasi bëheshin kapicë, mbuloheshin me

kashtë dhe digjeshin të gjalla. Në rast se ato ishin shtatzëna, u çahej barku me bajonetë dhe pasi u nxirrej fëmija, vendosej në majë të bajonetës apo të hunjve. Pas masakrimit serbët pinin verë, këndonin dhe hidhnin valle. Afër Kratovës gjenerali Stefanoviç renditi qindra të burgosur në dy rende dhe urdhëroi të vriteshin me mitraloz.

Në mes të Kumanovës dhe Shkupit, rreth 3000 veta janë rrahur deri në vdekje. Afër Prishtinës, diku afër 5000 shqiptarë ranë në duar të serbëve, jo gjatë ndonjë lufte të ndershme, por gjatë vrasjeve të pa justifikueshme. Për t'i bërë këto krime, ushtarët e çmendur shpikën metoda të reja mizore për të kënaqur etjen e tyre për gjak. Në shumë fshatra, tërë shtëpitë ishin djegur dhe, derisa banorët fatkëqij iknin nga flaka, ata u pushkatuan si minj. Burrat u vranë para syve të grave dhe fëmijëve, e pastaj gratë e pashpresa u detyruan të shikojnë fëmijët e tyre duke u bërë copë e grimë me bajoneta. Ekzekutimet ishin përditshmëri për ushtarët serbë. Në secilën shtëpi ku gjendeshin armë, të gjithë banorët vriteshin, duke u varur ose pushkatuar.

Në rrethinat e Shkupit çdo ditë shkatërrohet nga një fshat. Fshatrave u vihet zjarri dhe njerëzit dalin nga shtëpitë e tyre për t'iu shmangur tymit të dendur dhe kur dalin qëllohen për vdekje si kafshë të egra, shkruan gazetari Fritz Magnussen i cili flet edhe për një pemë të madhe, ku ishin varur shumica e shqiptarëve.

Ish-sekretari i premierit Pashiq, Tomiatch thotë se gjatë një udhëtimi nga Prizreni në Pejë, ai nuk pa asgjë tjetër pos fshatra të shkrumbuara. Anash rrugës kishte trekëmbësha

për varje, ku vareshin trupat e shqiptarëve. Rruga për në Gjakovë ishte si "rrugë e varjeve." Por tregimet e ligësive, të cilat u bënë në Shqipëri nuk mbaruan me kaq. Veprimet e bëra në Prilep, Kosovë, Veshitcë, thuhet se kanë tejkaluar çdo gjë që shqiptarët kishin vuajtur nën okupimin turk.
Në Shkup shqiptarët e paarmatosur thjesht vriteshin në rrugë nga oficerët serbë dhe nëse vetëm një thikë e gjuetisë gjendej në shtëpi, pronari vritej pa mëshirë.
Një doktor i Kryqit të Kuq thotë: "Kudo që gjendeshin shqiptarët, ata vriteshin pa mëshirë. As gratë, fëmijët dhe pleqtë nuk u kursyen. Unë pashë fshatra që digjeshin për çdo ditë."
Në këto rrethana historike, të nderuar pjesëmarrës, ndodhi edhe masakra në fshatin D. më 28 tetor 1912 ku ne jemi tubuar që ta përkujtojmë atë. Po të njejtën ditë, një masakër e tillë ndodhi edhe në fshatin Ll. dhe Gj. derisa edhe viset tjera po laheshin në gjak, ndërsa në anën tjetër Ismail Qemali, Isa Boletini, Hasan Prishtina e Luigj Gurakuqi i bënin përpjekjet e fundit për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë e cila edhe ndodhi më 28 nëntor 1912, por pa gjysmën e atdheut.
Andaj sot e 100 vite më parë, viset tona shqiptare u gjetën në zjarrin e madhë serb. Fqinjët i kishim grabitqarë, shtypës dhe mizor dhe burim i fatkeqësisë së popullit tonë, për së paku 100 vjet ishin fqinjët tanë, të cilët nuk i civilizon asgjë tjetër përpos forcës dhe këtë ta ngulisim mirë në kokat tona edhe për 100 vite të tjera të ardhëshëm e kush e harron këtë që po e themi, fati do t`i përsëritet.

Kur folësi F. përfundoi fjalimin e tij, zmadhuesi i zërit, dhe akustika e tij, në malet përreth, krijoi një jehonë përsëritëse të fjalimit të publicistit F.
Këtëë taaaa nguuulisimmmm mirëëëë në kokatttt tonaaaa edheeee për 100 viteeee të tjeraaaaa të ardhëshmeeee eeee kushshsh e harronnn këtëëëë qëëëë pooo e themiiii, fatiiiii doooo t`i përsëritettttt,fatiiii dooo t`iiii përsëritettttt.
Të pranishmit zurën të lëviznin në karriget e tyre. Dikush nga xhepi nxori pakon e cigareve dhe njërës ia nxori tymin. Nga një tjetër u dëgjua një kollë e hollë, kurse disa nga mesi i turmës, diçka pëshpëritnin njëri me tjetrin.

Mësuesi
Ecte mendueshëm, thuajse prej tij varej gjetja e fijës së humbur të lëmshit politik. Në kthesën e parë të rrugës, degëzohej udha e cila e çonte në shkollën ku punonte qe katër dekada. Dita e parë e asaj jave, kishte tubuar nxënësit dhe me çanta në shpinë nuk ia varnin shumë as lëmshit e as fijës. Oborri i shkollës gumëzhinte nga zërat e tyre gazmorë. I përshëndeti si zakonisht dhe mendja i iku te lajmet e natës së kaluar. Si çekan në kokë i binin fjalët e të rinjëve që po iknin nga atdheu. Iknin dhe fyenin vendin që i kishte lindur, ushqyer e rritur! Iknin dhe kërkonin shpresën…
Para se të hapte derën e shkollës, ktheu edhe njëherë kokën nga oborri shkollor dhe nga zhurma e nxënësve sikur ndjeu gjallëri në shpirtin e tij. ‘’Sa të mirë që janë!’’ foli me zërin e mendjes dhe për një çast iu kujtua marsi i vitit 1999, kur nxënësit e kësaj shkolla dhe tërë banorët e fshatit u dëbuan me dhunë nga pushtuesi, ndërsa vet përfundoi nën prangat e armikut.
,, Në këtë vend nuk kthehem më kurrë…’’, sërish i kumboi në kokë, zëri i të riut nga lajmet e mbrëmshme që nisej në

drejtim të portave të hapura... Hapi derën e shkollës dhe u fut në sallën e arsimtarëve. Nxori nga xhepi celularin dhe i hodhi një shikim kryetitullit të një portali i cili mbante një titull që përkonte me situatën që zhvillohej: ,, Dikush lirinë e kultivon në burg, dikush lirinë e shndërron në burg'' dhe i nxitur nga kurreshtja e titullit, atë e lexoi pothuajse në tërësi:

Para më shumë se katër dekadash më rastisi të shoh një sekuencë filmi, që më vonë e kuptova se kishte qenë afër përfundimit. Ndonëse nuk më kujtohet as regjisori, as autori i skenarit, as vendi (shteti) ku ishte xhiruar, ajo skenë më ka mbetur gjatë gjithë jetës në kujtesë. ...Një çift burrë e grua, të cilët ishin të dënuar dhe ishin internuar diku që dukej të ishte shumë larg, ndoshta siç thuhet diku në skaj të botës,... në një burg që më shumë i ngjante një shpelle të madhe, thellë në tokë. ...Aty kishte shkëmbinj dhe pothuajse vetëm shkëmbinj, të cilëve i dënuari u kishte dhënë forma të ndryshme, ...u kishte dhënë jetë. Mbi ata shkëmbinj, i burgosuri kishte shkrirë tërë shpirtin prej artisti, tërë pasionin e tij krijues duke skalitur skulptura, me një dashuri dhe përkushtim të pafund. Ai i adhuronte, i dashuronte... ai ndoshta edhe bisedonte me to... Mbi ato trajta artistike, ... mbi ato forma të lëmuara të trupave të grave, apo... të perëndive që i kishte gdhendur, kishte rrëshqitur jeta, pasioni dhe dashuria e artistit shpirtlirë...

Në atë moment kur fillova me kërshëri të shikoj filmin, autoritetet e burgut i thanë se e kishte vuajtur dënimin dhe ai ishte i lirë të ikte nga aty! Artisti i shikoi me habi rojet, ...nuk pranonte të ikte... Më kot i lutej e i përgjërohej gruaja... Nuk donte të dëgjonte askë, as gruan, as rojet... Filloi të çirrej si i marrë, të bërtiste, të përplaste gjërat për rreth. Rojet e tërhiqnin me forcë kurse artisti nuk donte me

asnjë çmim të largohej nga burgu... Ai nuk mund t'i lente veprat që ishin bërë pjesë e shpirtit dhe e qenies së tij... Këtu edhe përfundoi filmi, shkruante autori i shkrimit në portalin e caktuar.

Mësuesi, leximin nuk e vazhdoi më tej, sikur i mjaftoi kjo që e lexoi. Dhe derisa po e mbyllte celularin, mendja i iku te një thënie e Pikasos, se:,, Dikush me mjeshtri dhe përkushtim të madh nga një njollë e verdhë krijon diellin, dikush nga dielli krijon një njollë të verdhë''. E këta të rinjët tanë, pse … Shtëpinë tonë vet duhet ta ndërtojmë, pavarësisht vështirësive, paknaqësive e katrahurave! Ne jemi të detyruar që nga njolla e verdhë, diellin ta krijojmë! Përndryshe...

Ashtu i kredhur në mendime, celularin e vendosi mbi tavolinë. Cingërima e ziles shkollore ftonte në beteja të reja mësimore. Mori ditarin shkollor dhe u fut në klasën ku e prisnin nxënësit e tij.

,,Mirëmëngjes!'' kumboi mësonjëtorja nga zërat si në kor të nxënësve, zëra të cilët sikur e sollën në vetvete, mësuesin.

Treni i vdekjes

Prilli i këtij viti, sikur i gjasonte atij të para njëzet viteve. Një mot ku dielli ishte fshehur prapa reve, një mot i vërenjtur e i ftohtë, por pa shi e dëborë. Dhe në këtë mot të ftohtë, në Qytezën buzë lumit po ndodhte një ngjarje, për të cilën anasit kishin dëgjuar nga mjetet elektronike... Po vinte i frikëshmi, po vinte Treni i Vdekjes. Po e sjellnin pas dy dekadave, tanimë si kujtim i gjenocidit. Po e sjellnin trenin me të cilin në vitin 1999 u dëbuan dhunshëm vetëm nga porta e Hanit, mbi 400 mijë shqiptarë jashtë atdheut të tyre. E njëzet vite më pas, ata që e menaxhonin këtë tren, nuk janë më në Kosovë, kanë thyer qafën andej nga kishin ardhur, por trenin s`kishin mundur ta merrnin me vete, ai kishte mbetur i shtrirë si gjarpër mbi binarët e Fushë Kosovës. Dhe ja tani, ky tren disa vagonësh po vinte aty, ku zbarkonte njerëzit shpirtsfilitur dikur, të cilët me mall po ndaheshin nga atdheu i tyre. Tani e shpallnin tren muze, aty te kufiri, mu aty ku njëzet vite më parë, ndahej jeta me vdekjen. E vendosën në kampin e Bllacës, ku në dhjetëditëshin e parë të këtij muaji do të vendosej edhe gurthemeli i një muzeu të gjenocidit mbi shqiptarët...

Ishte 5 prilli i atij viti

E mërkura e asaj dite, qytezën buzë lumit e kishte shndërruar në një nikoqire mysafirësh. Vinin njerzë anëve të ndryshme, vinin në këmbë, vinin me makina,... vinin me tren, por jo si para 20 viteve. Vinin të qeshur, por me vajin e eksodit në buzë.

Për te kampi i Bllacës, ishte hapur një rrugë e veçant e shtruara me zhavor dhe uniformat blu të policisë i shihje më shumë se herave të tjera. Ata i ndihmonin dhe orientonin mysafirët. Aty afër plepave, nën hekurudhë, ishte vendosur edhe një binë e madhe, ndërsa afër lumit ishte hapur një

ekspozitë me fotografi nga eksodi '99 ku vizitohej nga të pranishmit. Përkrah ekspozitës qëndronte një pikturë e cila tanimë njihet si gruaja simbol e refugjatëve me foshnjen gjashtëmuajshme në gji dhe në këtë vendosje themeli ishte e ftuar edhe vet Sherifja me të bijën Besianën e cila tanimë i kishte kaluar të njëzetat. Nga zmadhuesit e vendosur afër binës, dëgjohej një këngë, më mirë të themi dëgjohej një mallkim, që i kushtohej atij viti:

Kampi i Bllacës
Udhë kalvari
N`ty mos biftë
Asnjë fije bari!

Enkas për këtë ditë, nga qyteti i Mitrovicës ishte nisur një tren tjetër ku edhe ndalej në çdo stacion për të marrë vizitorë që dëshironin të vizitonin ,,Bllacën 99''. Pak para orës 14, ai u ndal aty afër binës së ngritur dhe filluan të zbritnin njerzë që para 20 viteve ishin hipur dhe zbritur dhunshëm. Në anën tjetër, në këtë ditë që dikush e quajti ditë gëzimi e përzier me një dhembje të madhe, erdhi edhe kryeministri i vendit, erdhën lider partish e drejtor Institutesh e udhëheqës shoqatash, ndërsa afër vendit ku po zhvillohej kjo ngjarje, Kryqi i Kuq kishte vendosur tendat, si simbolikë e para njëzet viteve.
Pas intonimit të himnit, fjalën e mori kryeministri i vendit i cili ndër të tjera tha se:

Sot, po vejmë gurthemelin e një shtëpie jo të zakonshme, që i zë kujtimet e gjithë shqiptarëve, me shpresë që ndjekjen nga toka e vet kurrë më nuk do ta përjetojë askush. Një shtëpi që do të jetë shtëpi e kujtesës kolektive, ku do të vijnë breza e breza për të mësuar leksionin e parë: Sa e shtrenjtë është liria dhe sa dhembje sjell rruga deri në liri!? Në respekt dhe përkujtim të vuajtjeve, por edhe rezistencës së

refugjatëve kosovarë, po e ngremë këtë Qendër Përkujtimore të gjenocidit serb në Kosovë, Bllaca '99, shtëpi që flet më zërin e ndërgjegjes, kundër harresës. Ky duhet të jetë një Muze Botëror, i gjithkohëshëm, që flet kundër mizorisë së njeriut ndaj njeriut!

Dhe sot, kur po e vendosim një shenj në kohë dhe në këtë tokë të ujitur me gjak e lot, e cila ka për të qëndruar shekujve dhe ka me shërbye si vërejtje, që bota e lirë mos të lejojë më spastrim etnik, vrasje në masë dhe ndjekje e trena të vdekjes, sepse kush nuk mëson nga historia ajo do t'i përsëritet.

Sot, kujtesa jonë duhet ta zgjojë vëmendjen e secilit njeri, edhe fqinjëve tanë serbë, që mos t'ua trazojnë plagët ende të freskëta shqiptarëve, por t'i respektojnë vuajtjet e tyre.

Liria e Kosovës në themelet e veta e ka emrin e secilit refugjat të Bllacës dhe të gjithë atyre që dhunshëm u përndoqën nga shtëpitë e tyre, ata u bënë zëri dhe imazhi i Kosovës që kërkonte të drejtën e vet,tha ai.

Ndërsa Kryetari i Komunës nikoqire tha se: Vendosja e gurthemelit të këtij memoriali, përpos qe e ka vlerën historike, natyrisht shumë të dhembshme, ky memorial në vetvete përmban një vlerë të rrallë të një trashëgimie të natyrës gjenocidale ku një pushtues, në ketë rast ai serb, deportoi dhunshëm rreth gjysmë milioni njerëz, ashtu siç ka bërë fashizmi gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Bllaca dhe eksodi i vitit 1999 duhet t`i mësoj gjeneratat e Ballkanit, më konkretisht fqinjët tanë, se këto ngjarje të natyrës etnocidale nuk bën të ndodhin sepse janë kundërvlera njerëzore dhe shkelje e rëndë e të drejtave dhe vet jetës së njeriut. Meqenëse ishin të tilla e tërë bota demokratike ishte në anën e luftës se drejtë të popullit

shqiptar.
Si zonë kufitare, si udhëheqës dhe përjetues i luftës, me sytë tanë e kemi parë tmerrin që forcat pushtuese serbe kanë bërë në këtë zonë.

Jo vetëm që kanë ndarë familjet mes vete, por shumë sosh edhe janë hedhur nga ky tren dhe si dëshmi kemi edhe kufomat e gjetura në lumin Lepenc pas përfundimit të luftës...

Ndërsa një gazetar, që në atë kohë nga afër kishte përcjellur fatin e refugjatëve, paralajmëronte se dy ditë më vonë do të përurohet një libër që i kushtohet kësaj ngjarje, ku ndër të tjera shkruante:

...Në shiritin e kujtesës më kanë ngelur shumë detaje, rrëfime, imazhe e mbi të gjitha shumë fytyra pleqsh të shqetësuar, shumë tronditje grash e fëmijësh të trishtuar dhe shumë të humbur e të hutuar në labirintin e ferrit të Bllacës, aty ku gjatë ditëve të ftohta të mars/prillit 1999 po vihej në skenë një prej tragjedive më makabre të njerëzimit. Atyre ditëve, njeriu i shkulur kosovar ndodhej në paanësinë e një fushe të mbuluar me krrokama sorrash e vaje fëmijësh dhe brenda një teli me gjemba, të cilin po e ruanin me fanatizëm disa policë... Në Bllacë takohej fryma e njeriut me asgjënë prej nga formohej një lëmsh absurdi, që i ngjante një topi të ftohtë bore, teksa rrokullisej në shpinën e kërrusur të të dëbuarve dhunshëm....
Pas këtyre fjalimeve, të cilat kohë pas kohe nga të pranishmit priteshin me duartrokitje, me poezitë e tyre deklamuan poetë të anëve të ndryshme, ku të pranishmit patën mundësinë të përcjellnin edhe këngë e valle nga Shoqëritë artistike të komunës nikoqire dhe nga Prishtina.

Shiu që binte kohë pas kohe, sikur donte të na e kujtonte motin e atij viti. Në kodrën që shtrihej andej lumit, pas përfundimit të luftës, ishin gjetur bunker serb, nga të cilët viza vi shihnin kampin e Bllacës. Brenda atyre bunkerëve ishin gjetur rrobe të ndryshme femrash të cilat ishin ndarë nga familjet e tyre në Grykë dhe fati i tyre kishte përfunduar në duartë e ushtrisë pushtuese. Krahas këtyre bunkerëve, në lumë ishin gjetur kufoma të dy gjinive që ishin hudhur nga Treni i Vdekjes, nga i frikshmi i cili tanimë ishte vendosur në Lëndinën e Lotëve dhe sikur dëshironte t`iu fliste gjeneratave për një ngjarje të madhe të cilën organizatorët e titulluan" Muzeu i gjenocidit serb „Bllaca `99''.

Ishte 10 prilli i atij viti